

CEZ Shpërndarje

Raporti Final i Studimit mbi Borxhin e Keq nga Eksperti Financiar i Pavarur

29 Korrik 2011

Rreptësisht konfidencial dhe privat

Ky Raport Final është përgatitur mbi bazën e kushtëzimeve të paraqitura në seksionin e fushës dhe kufizimeve të punës sonë në faqen 10 si dhe në çështjet e theksuara në letrën bashkëshoqëruese në faqen tjetër. Për lehtësinë tuaj ky dokument mund t'ju jetë dhënë në formë elektronike dhe në format të shtypur. Rrjedhimisht mund të ketë disa kopje dhe versione të këtij dokumenti, që egzistojnë në formate të ndryshme. Vetëm kopja finale e firmosur duhet të konsiderohet si përfundimtare. Ky dokument është një përkthim në gjuhën shqipe i raportit origjinal zyrtar që është dorëzuar në gjuhën angleze. Për çdo diferencë, mos-rakordim apo paqartësi versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

Mr. Josef Hejsek
Mr. Karel Král
CEZ Shpërndarje sh.a.
Tiranë, Blloku Vasil Shanto
Albania

29 Korrik 2011

Të Nderuar Zotërinj,

Studimi mbi Borxhin e Keq nga Eksperti Financiar i Pavarur

Bashkangjitur ju lutem gjeni raportin tonë (“Raporti Final”) i përgatitur në lidhje me Studimin mbi Borxhin e Keq nga Eksperti Financiar i Pavarur (‘Studimi mbi Borxhin e Keq’ ose “Studimi”) në përputhje me termat e kontratës (“Kontrata”).

Raporti Final është konfidencial dhe është përgatitur ekskluzivisht për Palën Marrëse (sipas përcaktimit në kontratë) dhe është subjekt i kufizimeve në përdorim të specifikuar në Kontratë. Ky Raport është përgatitur vetëm për ERE në lidhje me kërkesat e përcaktuara në Deklaratën Rregullatore. Asnjë palë tjetër nuk ka të drejtë të mbështetet në këtë Raport Final për çfarëdo arsyeje apo qëllimi dhe ne nuk pranojmë asnjë përgjegjësi ndaj asnjë pale përveçse Palës Marrëse në lidhje me përmbajtjen e Raportit Final.

Ju tërheqim vëmendjen ndaj seksionit të titulluar “Fusha dhe kufizimet e punës sonë” i përfshirë në Raportin Final. Në këtë seksion i jemi referuar fushës së punës sonë, burimeve të informacionit si dhe kufizimeve të punës së ndërmarrë.

Deloitte Albania
Rr. “Elbasani”
Pallati poshte Fakultetit Gjeologji- Miniera
Tirana Albania

Tel:+ 355 4 45 17 920
Fax : + 355 4 45 17 990
www.deloitte.com

Ne nuk pranojmë asnjë përgjegjësi në lidhje me besueshmërinë e informacionit nëse informacioni është i pasaktë, jo i plotë, apo keqinformues si dhe ne nuk mbajmë përgjegjësi për çështjet që nuk janë shtjelluar në këtë Raport Final apo që janë lënë jashtë këtij Raporti Final për shkak të natyrës së kufizuar të punës sonë.

Ne i dorëzuar një draft të këtij Raporti Final drejtuesve të CEZ Shpërndarje, nominalisht z. Karel Král dhe i kërkuam atyre të konfirmojnë me më të mirën e informacionit dhe njohurive të tyre që faktet, siç janë thënë, janë të sakta në të gjitha aspektet materiale, që çdo opinion që i atribuohet atyre është i drejtë dhe i arsyeshëm, që ato na kanë dhënë ne të gjithë informacionin e rëndësishëm që lidhet me Raportin Final për të cilën ato kanë njohuri dhe që ato nuk kanë dijeni për ndonjë çështje materiale që është relevante për termat tonë të referencës që është përjashtuar.

Me respekt.

Deloitte Albania Sh.p.k

Seksioni	Faqe
Përmbajtja	
Përmbledhja ekzekutive	4
Fjalorth i termave të përdorur	9
Fusha dhe kufizimet e punës tonë	10
Sfondi i Studimit mbi Borxhin e Keq	11
Informacioni i përdorur dhe analizat e bëra për cilësinë e informacionit	15
Metodologjia dhe kuadri teorik	35
Përgjigjet ndaj komenteve të ERE	50
Metodologjia e propozuar për llogaritjen e Borxhit të Keq	62
Analiza e moshës dhe trendi i pagesave	70
Llogaritja e nivelit aktual të borxheve të këqia	75
Shtojcat	88

Shtojcat	Nr.
Deklarata Rregullatore	1
Manuali i kontabilitetit	2
Vështrim i përgjithshëm mbi sistemet e faturimit, arkëtimit dhe kontabilitetit	3
Trendi i arkëtueshmërisë	4
Borxhi i Keq sipas tipit të klientit	5
Personeli kryesor i Deloitte	6

Përmbledhja Ekzekutive

Fakte Thelbësore	Vëzhgime
<p>Nevoja për përgatitjen e Studimit mbi Borxhin e Keq</p>	<ul style="list-style-type: none"> • CEZ u shpall nga METE si fituesi i tenderit për 76% të aksioneve të CEZ Shpërndarje (më parë njohur si OSSH) në tetor të 2008, vendim i cili u miratua dhe ratifikua më pas nga Parlamenti Shqiptar. Blerja e aksioneve u ekzekutua më 11 mars 2009 dhe menaxhimi i Kompanisë i kaloi CEZ në qershor të 2009. • CEZ Shpërndarje është kompania e vetme në Shqipëri për shpërndarjen dhe furnizimin me pakicë të energjisë elektrike, shumica e aksioneve të së cilës është në pronësi të CEZ, njërit prej grupeve më të mëdha të energjisë në Europën Qëndrore dhe Lindore. • Marrëveshja e blerjes së aksioneve e konkluduar ndërmjet METE dhe CEZ përmbante një aneks me Deklaratën Rregullatore ku shprehej se OSSH do të kryente një Studim të detajuar mbi Borxhin e Keq të përgatitur nga një ekspert financiar deri më 31 Korrik 2011. • Deloitte Albania Sh.p.k u përzgjedh të kryente Studimin mbi Borxhin e Keq
<p>Fusha dhe kufizimet e punës sonë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Fusha e shërbimeve të Deloitte, ashtu siç është përcaktuar nga Deklarata Rregullatore është përgatitja e Studimit mbi Borxhin e Keq, pra përcaktimi i 1) metodologjisë së përlllogaritjes së borxhit të keq dhe 2) përlllogaritja e nivelit aktual të borxhit të keq për vitin 2008, 2009 dhe 2010 sipas kuadrit teorik dhe atij rregullator. • Sipas përcaktimit më sipër të përkufizuar nga Deklarata Rregullatore ne vetëm do të përlllogarisim borxhin e keq dhe është jashtë fushës së shërbimeve tona të vlerësojmë masa (të mundshme apo që janë tashmë në fuqi) për uljen e borxhit të keq. Këto masa janë pjesë e strategjisë së biznesit dhe kompetencë ekskluzive e drejtuesve të CEZ Shpërndarje, ashtu siç edhe është parathënë nga Deklarata Rregullatore • Për kryerjen e Studimit mbi Borxhin e Keq ne kemi marrë llogaritë e arkëtueshme nga shitjet e energjisë elektrike ndaj konsumatorëve të cilat lindin si pasojë e kryerjes normale të biznesit dhe kemi përlllogaritur pjesën e llogarive të arkëtueshme që nuk do të mbliidhen, pra që do të përfundojnë si borxh i keq.

Përmbledhja Ekzekutive

Fakte Thelbësore	Vëzhgime
<p>Cilësia e të dhënave bazë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Për të vlerësuar cilësinë e të dhënave ne analizuam të dhënat e sistemit të faturimit dhe ndoqëm të gjithë ciklin e krijimit të llogarive të arkëtueshme deri në rakordimin me pasqyrat financiare të audituara – konsistenca e pasqyrave financiare të audituara me cilësinë e mjaftushme të databazave kryesore/të dhënave bazë japin baza të mjaftueshme për analiza mbështetëse, llogaritje të Borxhit të Keq dhe përgatitjen e Studimit mbi Borxhin e Keq. Vini re ju lutem që ne nuk kemi kryer asnjë lloj auditimi mbi të dhënat e marra. • Bazuar në vlerësimin tonë të cilësisë së të dhënave për të dhënat master dhe për të dhënat e transaksioneve në databazën e centralizuar të faturimit ne vumë re që gabimet e vëzhguara në databazën e faturimit nuk ndikojnë në mënyrë të rëndësishme saktësinë e përlllogaritjes së borxhit të keq dhe ne rakorduam të dhënat e faturimit dhe arkëtimit me pasqyrat financiare të audituara. • Në bazë të rezultateve të procedurave tona ne i konsiderojmë të dhënat bazë si të një saktësie të arësyeshme për kryerjen e Studimit mbi Borxhin e Keq
<p>Kuadri teorik</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ne i konsiderojmë manualët e SNK/SNRF si kuadrin teorik më relevant. • Kuadri teorik njih dy metoda për përcaktimin e provizioneve për shumat e pa-arkëtueshme (borxh i keq), që janë metoda e pasqyrit të bilancit (përqindja mbi llogaritë e arkëtueshme) dhe metoda e pasqyrës së të ardhurave (përqindja mbi shitjet). Në kohë, të dy metodat japin të njëjtin rezultat kumulativ, pra të njëjtën sasi të përlllogaritur të borxhit të keq. • SNK/SNRF nuk i kërkojnë në mënyrë strikte kompanive të përdorin një të një metodë apo tjetrën. Përzgjedhja e metodës respektive duhet të pasqyrojë situatën specifike në shtetin e dhënë, rajonin e dhënë, industrinë specifike apo edhe portofolin specifik të klientëve. • Bazuar në kuadrin teorik dhe duke patur parasysh biznesin e CEZ Shpërndarje i cili është i karakterizuar nga volume të mëdha të llogarive të arkëtueshme me vlera të vogla, ne e konsiderojmë mënyrën e provizionimit të përgjithshëm si më të përshtatshmen dhe të vetmen që mund të aplikohet praktikisht (aplikimi i provizionimit ndaj totalit të llogarive të arkëtueshme apo nëngrupeve të totalit më tepër sesa provizionimi i bazuar në llogaritë e arkëtueshme për konsumatorë specifikë). • Ne i bazuam përlllogaritjet tona në databazën e cila përmbante të dhëna të detajuara për çdo faturë të lëshuar.

Përmbledhja Ekzekutive

Fakte Thelbësore	Vëzhgime
<p>Kuadri rregullator</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ne studiuam dokumentet rregullatore të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri dhe konsiderojmë që Deklarata Rregullatore dhe Manuali i Kontabilitetit janë kuadri rregullator kryesor për përgatitjen e Studimit mbi Borxhin e Keq, meqë vetëm këto dy dokumente i referoheshin përlogaritjes së borxhit të keq. • Deklarata Rregullatore shprehet si më poshtë për borxhin e keq: <ul style="list-style-type: none"> • Një nivel i caktuar i borxhit të keq është një pjesë e pandashme e biznesit të furnizimit me pakicë dhe si e tillë duhet të reflektohet në tarifë • Borxhi i Keq i Lejuar do të llogaritet si një përqindje ndaj të ardhurave totale të OSSH në funksionin e saj si FPP • Manuali i Kontabilitetit shprehet si më poshtë në lidhje me përlogaritjen e borxhit të keq: • I referohet metodës së pasqyrës së të ardhurave (përqindja mbi shitjet) dhe metodës së pasqyrimin të bilancit (përqindja mbi llogaritë e arkëtueshme). Metoda e pasqyrimin të bilancit konsiderohet në këtë Manual si e përdorur gjerësisht dhe si metoda më e saktë • Thotë që kompania e licensuar duhet të tregojë qartë cilën metodë ka përdorur për të regjistruar borxhin e keq në llogaritë e veta. Rregullatori mund t'i kërkojë kompanisë të përdorë një metodë të ndryshme.
<p>Metodologjia e propozuar e përlogaritjes së borxhit të keq</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Bazuar në Manualin e Llogarive dhe SNK/SNRF, provizioni për Borxhin e Keq duhet të përfaqësojë diferencën ndërmjet faturave të lëshuara dhe vlerën aktuale neto të parave të mbledhura, pra ne e përkufizojmë Borxhin e Keq si më poshtë vijon: <ul style="list-style-type: none"> • Diferenca ndërmjet të ardhurave të faturuara dhe të arkëtuara (duke përfshirë arkëtimet e përlogaritura të mëvonshme) • Ne e llogarisim përqindjen për t'u përdorur për vendosjen e tarifës si: <ul style="list-style-type: none"> • Të ardhurat e paarkëtuara/të ardhurat totale për çdo vit • Të ardhurat totale përfaqësojnë sasinë totale të faturuar ndaj klientëve fundorë për energjinë elektrike • Për shkak të historikut të pagesave i cili është i ndryshëm për tipe të ndryshme konsumatorësh, ne e përlogaritëm provizionin për borxhin e keq veç për secilin tip konsumatori. Për rrjedhojë, përqindja e borxhit të keq është llogaritur për të gjithë popullatën duke përdorur mesataren e ponderuar. • Ne i aplikojmë të dyja metodat (pasqyrën e bilancit dhe pasqyrën e të ardhurave) për përlogaritjen e borxhit të keq.

Përmbledhja Ekzekutive



Fakte Thelbësore

Analiza e moshës dhe trendit i pagesave

Përlllogaritja e nivelit aktual të borxhit të keq

Vëzhgime

- Ne kryem një analizë të detajuar të moshës së llogarive të arkëtueshme dhe të trendit të pagesave për rajone të veçanta dhe për tipe konsumatorësh të veçantë dhe arritëm në përfundimin që përgjithësisht ka një nivel të lartë mospagese, nivel i cili ka arritur kryesisht në rritje gjatë periudhës së mbuluar (2008 – 2010).



- Ne kryem përlllogaritjen e nivelit të borxhit të keq sipas të dy metodave të përcaktuara në metodologjinë tonë, duke përfshirë aplikimin e axhustimeve të veçanta dhe llogaritëm nivelet finale aktuale të borxhit të keq.

ALL	FY 2008	FY 2009	FY 2010 (*trendi i 2009)	FY 2010 (*trendi i 2008)
Provizioni për borxhin e keq si % e shitjeve - Metoda e pasqyrës së të ardhurave	18.27%	20.39%	23.06%	24.19%
Provizioni për borxhin e keq si % e shitjeve - Metoda e pasqyrimit të bilancit	18.50%	21.03%	22.59%	23.25%
Provizioni mesatar për borxhin e keq	18.39%	20.71%	23.27%	

Shënim: * arkëtimet e ardhshme të përlllogaritura bazuar në trendin e 2008/2009

Përmbledhja Ekzekutive

Fakte Thelbësore


Llogaritja e nivelit aktual të borxhit të keq

- Prezantimi grafik i zhvillimit të nivelit të Borxhit të Keq në krahasim me normën e mos-arkëtimit (Norma e mos-arkëtimit bazohet në arkëtimet dhe faturimet e një periudhë të caktuar, p.sh arkëtimet e FY08 pjesëtuar ndaj faturimeve të FY08, ndryshe nga niveli i Borxhit të Keq që bazohet parimin e përputhjes së faturimeve dhe arkëtimeve në periudhat kontabël, p.sh arkëtimet në FY08, FY09, FY10 që bëhen për faturimin e FY08, pjesëtuar me faturimin e FY08).

Shënim: * 1 - (FYxx Arkëtime / FYxx Faturime)

Vëzhgime

Zhvillimi i Borxhit të Keq dhe Normës së Mos-arkëtimit



Skenari i kompensimit potencial mes CEZ Shpërndarje dhe KESH (Republika e Shqipërisë)

- Ne na u kërkua nga ERE të bënim një llogaritje skenari për Borxhin e Keq, duke konsideruar faktin që CEZ Shpërndarje ka detyrime të papaguara që i ka kaluar afati ndaj KESH. Skenari i kërkuar konsideron kompensimin potencial të llogarive të arkëtueshme nga buxhetorët, jo-buxhetorët dhe personat me aftësi të kufizuara kundrejt detyrimeve ndaj KESH që i ka kaluar afati, sidoqoftë ne kuptojmë që nuk as vendim detyruës ligjor për këtë, as një marrëveshje mes palëve. Nëse do të kishte një marrëdhënie të tillë niveli i Borxhit të Keq do të ishte si më poshtë:

ALL	FY 2008	FY 2009	FY 2010
Provizioni mesatar për Borxhin e Keq	18.39%	20.71%	23.27%
Provizioni mesatar për Borxhin e Keq - skenari i kompensimit	14.86%	16.85%	19.73%

Manuali i kontabilitetit	Manuali i kontabilitetit për qëllime të rregullit të kompanive të licensuara në sektorin e energjisë elektrike, aprovuar nga Bordi i Komisionerëve i ERE me vendimin nr.76, datë 26 qershor 2008	SNK / SNRF	Standartet Ndërkombtare të Kontabilitetit / Standartet Ndërkombtare të Raportimit Financiar
ALL	Monedha në Republikën e Shqipërisë (Lek)	ISA	Standartet Ndërkombtare të Auditimit (International Standards on Auditing)
LI.A	Llogaritë e arkëtueshme ose të arkëtueshmet	KESH	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
Studimi mbi Borxhin e Keq ose Studimi	Studimi mbi borxhin e keq i kryer nga nje ekspert financiar i pavarur në përputhje me Deklaratën Rregullatore	m	Milion
F&A	Faturim dhe Arkëtim	METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës
bln	Miliard	n/a	Të dhëna që nuk janë të aplikueshme ose jo disponibël
CEZ Shperndarje	CEZ Shperndarje sh.a.	TH	Teprica Hapëse
CEZ	ČEZ, a.s., grupi ČEZ ose kompanitë e tij	TM	Teprica Mbyllëse
Kontrata	Kontrata në lidhje me Studimin mbi Borxhin e Keq e konkluduar mes Deloitte dhe CEZ Shpërndarje	OSSH	Operatori i Sistemit te Shperndarjes Sh.a (emri i mëparshëm ligjor i CEZ Shperndarje)
Deloitte	Deloitte Albania Sh.p.k	Rakordim	Krahasimi i grupeve të të dhënave dhe dallimi i diferencave
EBIT	Fitimi para Interesit dhe Taksave (Earnings before interest and tax)	Deklarata Rregullatore	Deklarata Rregullatore që formon Aneksin 11 ndaj MBA e aprovuar nga vendimi nr. 12, datuar 3 mars 2009 të Bordit të Komisionerëve
EBITDA	Fitimi para interesit, taksave dhe amortizimit (Earnings before interest, tax, depreciation and amortisation)	FPP	Funksioni i licensuar i furnizuesit publik me pakicë për klientët tariforë
ERE	Enti Regullator i Energjise	MBA	Marrëveshje për Blerjen e Aksioneve konkluduar mes METE dhe CEZ
EUR	Monedha e Bashkimit Europian	Shuma e lejuar	Ne përkthimin zyrtar në shqip të SNK/SNRF referohet dhe si zbritja.
FY08 / 2008, FY09/ 2009, FY10/ 2010, FY11 / 2011	Viti që mbaron në 31 dhjetor 2008, 2009, 2010	PASH	Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve
		TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
		FPS	Furnizuesi Publik me Shumicë

Fusha dhe Kufizimi i Punës Tonë

Pjesë të zgjedhura nga Kontrata

(konkluduar mes Deloitte dhe CEZ Shpërndarje)

„ 1. Qëllimi Kryesor i Kontratës

1.1 Qëllimi kryesor i Kontratës është përgatitja dhe dorëzimi i shërbimeve të përcaktuara (më poshtë “Shërbimet”) në lidhje me përgatitjen e Studimit mbi Borxhin e Keq sipas kërkesave të Deklaratës Rregullatore për përcaktimin e (i) metodologjisë së llogaritjes të borxhit të keq dhe (ii) nivelet aktuale të borxhit të keq për vitet 2008, 2009 dhe 2010 (më poshtë “Studimi mbi Borxhin e Keq”). Studimi mbi Borxhin e Keq do të shërbejë si bazë për përcaktimin e provizionit të borxhit të keq siç përcaktohet nga Deklarata Rregullatore.

Shërbimet të cilat janë subjekt i kësaj Kontratë do të strukturohen si në vijim:

- a) Faza 1 –përgatitja e një dokumenti draft mbi metodologjinë për Studimin mbi Borxhin e Keq dhe diskutimi i tij me Klientin dhe ERE;
- b) Faza 2 – mbledhja e të dhënave nga Klienti dhe analiza e të dhënave në përputhje me metodologjinë e përcaktuar dhe rënë dakord me Klientin dhe ERE në Fazën 1;
- c) Faza 3 – llogaritja e borxhit të keq dhe draftimi i Studimit të Borxhit të Keq; diskutimi paraprak me Klientin dhe ERE dhe dorëzimi i mëposhtëm në versionin final i Studimit mbi Borxhin e Keq duke pasqyruar komentet e Klientit dhe ERE;

Për të menjanuar çdo dyshim, “borxhi i keq” sipas kësaj Kontrate i referohet borxhit të keq që lind vetëm nga llogaritë e arkëtueshme, të cilat lidhen me shitjen e energjisë elektrike tek konsumatorët. Studimi i Borxhit të Keq nuk do marrë parasysh ndonjë lloj tjetër llogarie të arkëtueshme të cilat mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në: llogari të arkëtueshme nga punonjësit, parapagime të kryera ndaj furnitorëve, etj.

1.2 Shërbimet e Deloitte subjekt të kësaj Kontrate nuk mbulojnë shërbime të tjera si auditim dhe/ose çdo lloj forme vërtetimi të dhënash, modelim biznesi, vlerësim ose konsulentë ligjore, teknike/inxhinierike, rregullatore dhe mjedisore. Shërbimet subjekt të kësaj Kontrate nuk përfshijnë as saktësimin e evidencave për zgjidhjen e ndonjë konflikti.

Nën-seksionet	Faqe
Prezantimi i CEZ Shpërndarje	12
Blerja e OSSH nga CEZ	13
Kërkesat mbi përgatitjen e Studimit mbi Borxhin të Keq	14

CEZ Shpërndarje është kompania e vetme për shpërndarjen dhe shitjen me pakicë të energjisë elektrike në Shqipëri, shumica e aksioneve të së cilës që nga 2009 zotërohen nga CEZ, një ndër grupet energjitike më të mëdha në Evropën Lindore dhe Qëndrore

- CEZ Shpërndarje është pasardhësi ligjor i OSSH, një kompani e angazhuar në biznesin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe aktivitetin e shitjes me pakicë të energjisë elektrike në Shqipëri nëpërmjet operimit të një rrjeti shpërndarjeje të tensionit të mesëm dhe të ulët.
- OSSH u themelua me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 862 i datës 20 dhjetor 2006. Vendimi lidhet me ndarjen nga KESH të divizionit të shpërndarjes së energjisë elektrike duke themeluar një kompani të re (OSSH), e zotëruar 100% nga KESH.
- Më anë të Vendimit të gjykatës të rrethit të Tiranës nr. 38587 i dates 19 qershor 2007, OSSH u regjistrua si një entitet juridik me një kapital aksionar fillestar prej Lek 2,000,000 i ndarë në 2,000 aksione me një vlerë nominale prej Lek 1,000 secili, i zotëruar 100% nga shteti dhe KESH si aksionar i vetëm.
- Qëlimi i aktivitetit të CEZ Shpërndarje është të sigurojë nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes të energjisë elektrike shërbimet që vijojnë më poshtë: (a) furnizimin dhe shitjen e energjisë elektrike tek konsumatorët tarifore dhe të tjerë të lidhur me rrjetin e shpërndarjes të energjisë elektrike; (b) operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes të energjisë elektrike; (c) manaxhimin e rrjetit të shpërndarjes të energjisë elektrike; (d) zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes të energjisë elektrike.
- CEZ Shpërndarje ka në zotërim dy licensa të lëshuara për territorin e Shqipërisë, si në vijim:
 - Licensën e Shpërndarjes– lëshuar më 25 janar 2008 për një periudhë 20 vjeçare. Sipas termave të licensës të Shpërndarjes OSSH është përgjegjese për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në të gjithë Shqipërinë dhe për blerjen e energjisë elektrike në tregun e hapur për të mbuluar humbjet në sistemin e shpërndarjes.
 - Licensën për Furnizimin Publik me Pakicë – lëshuar më 25 janar 2008 për një periudhë 4 vjeçare. Sipas termave të licensës FPP, OSSH është përgjegjëse edhe për blerjen e energjisë elektrike nga Furnizuesi Publik me Shumicë dhe për rishitjen tek konsumatorët tarifore.

Përmbledhje e pasqyrës së audituar të të ardhurave për CEZ Shpërndarje

ALLm	FY08	FY09	FY10
Të ardhurat	33,331	36,568	41,808
Të ardhura të tjera	891	354	381
EBITDA	(4,215)	(13,369)	1,221
Amortizimi	(2,517)	(2,956)	(3,168)
EBIT	(6,731)	(16,325)	(1,946)
Fitimi/(humbja) neto	(9,134)	(18,333)	(5,352)

Përmbledhje e Bilancit të audituar të CEZ Shpërndarje

ALLm	Dec 08	Dec 09	Dec 10
Aktive afatgjata	29,450	27,877	28,924
Aktivet afatshkurtra	17,415	7,791	10,480
Totali i aktiveve	46,865	35,668	39,403
Kapitali	26,380	8,047	2,694
Detyrimet afat-gjata	11,602	11,135	12,577
Nga te cilat kredi	11,602	10,400	12,565
Detyrimet afatshkurtra	8,883	16,487	24,132
Nga te cilat kredi	1,142	7,503	8,436
Totali i kapitaleve dhe detyrimeve	46,865	35,668	39,403

Burimi: Pasqyrat Financiare të CEZ Shpërndarje


Vendimi për privatizimin nga ana e Qeverisë Shqiptare mban datën qershor 2008, ndërsa OSSH filloi të manaxhohet nga CEZ që nga qershori i vitit 2009

Blerja e OSSH nga CEZ

Panoramë e procesit të privatizimit

- Si pjesë e procesit të transformimit dhe liberalizimit të sektorit elektro-energjetik në Shqipëri, Qeveria Shqiptare vendosi të implementojë reforma me anë të krijimit të nje tregu konkurrues të energjisë elektrike në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian, duke përfshirë ristrukturimin e KESH dhe privatizimin e pjesëve të caktuara të sektorit elektro-energjetik.
- Vendimi zyrtar për privatizimin e 76% të kapitalit të OSSH nëpërmjet një tenderi ndërkombëtar mban datën 11 qershor 2008.
- Më 17 qershor 2008, ofertuesit e para-kualifikuar u ftuan të paraqesin ofertat e tyre për qëllimet e transaksionit dhe pasi ishin shqyrtuar dokumentat e paraqitura dhe pikët e marra, CEZ u deklarua nga METE si ofertuesi fitues për t'u bërë investitori strategjik për OSSH në tetor 2008.
- Transaksioni u confirmua më pas dhe u miratua nga Parlamenti Shqiptar.
- Qeveria Shqiptare dhe Grupi CEZ nënshkruan kontratën për shitjen e 76% të OSSH më 11 Mars 2009.
- OSSH nisi të drejtohet nga CEZ që nga qershori 2009.
- OSSH ndryshoi emrin në CEZ Shpërndarje më 1 tetor 2010.

Struktura aksionare



Studim mbi Borxhin e Keq do të kryhet nga një Ekspert Financiar i Pavarur gjer më 31 korrik 2011 në përputhje me Deklaratën Rregullatore që është pjesë përbërëse thelbësore e dokumentacionit të transaksionit.

Kërkesat mbi përgatitjen e Studimit të Borxhit të Keq

Përkufizime të përzgjedhura të Deklarates Rregullatore


- Marrëveshja e datës 11 mars 2009 (“MBA”) mbi blerjen e aksioneve ndërmjet METE dhe CEZ për shitjen e 76% të OSSH përmban dhe Deklaratën Rregullatore e cila është pjesë e Shtojcës 11 të MBA.
- Formulimi i Deklaratës Rregullatore u miratua me vendimin nr.12 të Bordit të Komisionerëve të datës 3 mars 2009.
- Deklarata Rregullatore në nenin 5.2 përmban:
 - *Deri më 31 korrik 2011, OSSH, në funksion të veprimtarisë së shitjes me pakicë që ajo kryen, do të kryejë një studim të detajuar për Borxhin e Keq (“Studimi mbi Borxhin e Keq”) për të përcaktuar (i) metodologjinë e llogaritjes së Borxhit të Keq dhe (ii) Nivelet Aktuale të Borxhit të Keq për vitet 2008, 2009 dhe 2010 („Nivelet Aktuale të Borxhit të keq për vitet 2008, 2009 dhe 2010”). Studimi mbi Borxhin e Keq do të përgatitet nga një ekspert financiar i pavarur i zgjedhur nga lista e mëposhtme: Deloitte, Ernst&Young, KPMG, PricewaterhouseCoopers.*
 - *Studimi mbi Borxhin e Keq do të miratohet nga ERE brenda 2 muajve nga paraqitja e tij.*
- Në vijim të procesit të tenderimit për përcaktimin e ekspertit financiar të pavarur në përputhje me Deklaratën Rregullatore, Deloitte Albania Sh.p.k u zgjodh të kryejë Studimin mbi Borxhin e Keq.

Nën-seksionet	Faqe
Metodologjia për vlerësimin e cilësisë së të dhënave themelore	16
Analiza e sistemit të faturimit	17
Rakordimi i të dhënave	21
Konkluzionet mbi cilësinë e të dhënave	34

Për të vlerësuar cilësinë e të dhënave të përdorura, ne kemi analizuar të dhënat nga sistemi i faturimit dhe kemi ndjekur të gjithë ciklin e jetës së llogarive të arkëtueshme duke i rakorduar me pasqyrat financiare të audituara

Ne kryem hapat e mëposhtëm:

- 1) Kuptimin e ciklit të jetës të llogarive të arkëtueshme duke filluar nga matja deri në raportimin në pasqyrat financiare (kuptimi i parimeve kryesore, marrëdhënia dhe proceset në varësi të sistemeve të veçanta si përsëmbull faturimi dhe kontabiliteti, kushtet kryesore të faturimit dhe pagesave, shpërndarja e faturave dhe metodat e përgjithshme të pagesave;
 - 2) Rakordimi i të dhënave të sistemit të faturimit me tabelën e Rakordimit (për më shumë detaje shih më në vijim të faqeve) ;
 - 3) Rakordimi i tabelës së Rakordimit me bilancin vërtetues për shitjet dhe llogaritë e arkëtueshme;
 - 4) Rakordimi i llogarive të rëndësishme të bilancit vërtetues me pasqyrat financiare të audituara .
- Pajtueshmëria ndërmjet pasqyrave financiare të audituara dhe të dhenave mbështetëse të detajuara së bashku me cilësinë e mjaftueshme të databazave/ të dhenave respektive duhet të japin siguri të mjaftueshme për të mbështetur analizat, përllogaritjen e Borxhit të Keq dhe përgatitjen e Studimit të Borxhit të Keq.
 - Për të shmangur çdo dyshim ne specifikojmë, se ne nuk kemi ndërmarre asnjë auditim mbi të dhënat e marra.
 - Informacione të hollësishme për procedurat e kryera janë paraqitur në faqet në vijim të këtij dokumenti.




Ne kemi kryer një seri takimesh dhe intervistash në mënyrë që të përfitonim një njohje sa më të thellë të procesit të faturimit në tërësi.

Pasqyra e takimeve dhe seminareve kryesore::

- Ne kemi kryer një seri takimesh dhe intervistash në mënyrë që të përfitonim një njohje sa më të thellë të procesit të faturimit. Takimet dhe intervistat u kryen me:
 - Menaxhimin e CEZ Shpërndarje
 - Departamentin e Teknologjisë së Informacionit të CEZ Shpërndarje
 - Departamentin e Faturimit të CEZ Shpërndarje
 - Departamentin e Humbjeve Jo-teknike të CEZ Shpërndarje
 - Departamenti e Financës të CEZ Shpërndarje
 - Dabis – Firmë zhvilluese në fushen e Teknologjisë së Informacionit, pjesëmarrëse në ristrukturimin e sistemit të faturimit.

Rezultatet kryesore të takimeve:

- Gjatë këtyre intervistave, ne kemi identifikuar faktet e mëposhtme:
 - Sistemi i faturimit aktualisht është i decentralizuar në 10 vende, të sinkronizuara me një databazë në Tiranë.
 - Aktualisht leximi i konsumit të energjise elektrike kryhet një herë në muaj duke përdorur sistemin e leximit elektronik myAvis.
 - Të dhënat nga sistemi myAvis ngarkohen në databazën e decentralizuar të sistemit të faturimit.
 - Bazat e të dhënave të decentralizuara të sistemit të faturimit, shërbejnë si platforma lokale për hedhjen e pagesave të klientëve.
- Duke u bazuar në përshkrimet si më sipër, ne kemi kryer analizën tonë lidhur me të dhënat e faturimit të gjëndura në bazën e të dhënave qendrore me 18 maj 2011.




Duke u bazuar në databazën e centralizuar deri më 18 maj 2011 ne krijuam nje mjedis tonin virtual per yë analizuar strukturën dhe integriteti ne të dhënave

Pasqyrë e informacioneve kyçe të marra dhe analizave të kryera:

- Ne morëm një kopje të databazës të centralizuar të sistemit të faturimit. Kopja ishte përgatitur me të dhëna deri më shkurt 2011 dhe ishte në formatin MS-SQL.
- Për të ruajtur strukturën dhe integritetin e të dhënave, ne krijuam një mjedis tonin virtual për të vendosur kopjen e databazës në formatin MS-SQL.
- Si hap të parë për të kuptuar strukturën e databazës të sistemit të faturimit, ne analizuan vlerat e tabelave, reshtave dhe kolonave, çelësat kryesorë, çelësat dytësorë, integritetin e të dhënave dhe indeksimin e elementëve të bazës të të dhënave. Ne morëm fjalorin e të dhënave nga analizat e kryera nga CEZ Shpërndarje dhe konfirmuam vlefshmërinë e tij në lidhje me kopjen e bazës së të dhënave.
- Tabelat kryesore të përdorura për operacionet e faturimit janë ilustruar në modelin e të dhënave (në të djathtë) dhe janë listuar si më poshtë:
 - Kontrata – Tabela e të dhënave të klientëve;
 - Konsumi i konsumatorëve – tabela për regjistrimin e leximit të matësive, faturimeve dhe arkëtimeve, e lidhur nëpërmjet çelësive dytësore me tabelat e zonave, kabinave, linjave dhe pikave të arkëtitimit.
 - Code_rates 1 - Detajet teknike të konsumit të kabinave ruhen në tabelën “Konsumi i kabinave” e cila është e lidhur me tabelen e të dhënave të konsumit të linjës, kabinës nënstationit dhe transaksioneve.

Tabelat kryesore të përdorura për aktivitetin e faturimit të bazuar në bazën qendrore të të dhënave të faturimit në shkurt 2011 (kjo tabelë është vetëm për qëllime ilustruese)



Bazuar në analiza e kryera, ne konstatojmë se të dhënat e sistemit të faturimit kanë një saktësi të pranueshme dhe se mund të bëhen kërkime SQL (queries) direkte mbi informacionin në bazën e të dhënave.

- Analiza e të dhënave në vetvete u krye në kopjen virtuale të databazës së centralizuar të faturimeve. Analiza e të dhënave u plotësua nga një sërë mjetesh specifike dhe masash teknike:
 - Query direkte në strukturën e bazës së të dhënave pa mundësi ndryshimi, fshirjeje, përditësimi, në mënyrë që të ruhet konsistenca e bazës së të dhënave gjatë gjithë procesit të analizimit të të dhënave.
 - Pamje në bazë të kohës nga statistikat, grumbullim i të dhënave, përmbledhëset, ndarjet e informacionit, dhe analizave kumulative duke përdorur MS-Excel.


```

use BILL_00

select instcode, ref_contract,
convert (varchar, month(nr_month))+'-'+convert (varchar, year (Nr_month)) issued,
convert (varchar, month(payment))+'-'+convert (varchar, year (payment)) paid,
DATEDIFF (month, nr_month, payment) due,
SUM(total) total, SUM(supplement_value) supplement

from Subscribers_consumption
where table BILL_00.dbo.Subscribers_consumption type_index = 'C' and payment is null
group by INSTCODE, ref_contract,
convert (varchar, month(nr_month))+'-'+convert (varchar, year (Nr_month)),
convert (varchar, month(payment))+'-'+convert (varchar, year (payment)),
DATEDIFF (month, nr_month, payment)

```



Shëmbull analizimi:

Month of payment												
Month of invoice	2010/01	2010/02	2010/03	2010/04	2010/05	2010/06	2010/07	2010/08	2010/09	2010/10	2010/11	2010/12
1	793 630	1 972 868 441	927 399 494	403 611 129	124 033 752	68 729 579	47 306 528	155 077 696	22 835 966	34 926 657	12 738 045	7 533 811
2		1 900 461	2 250 707 706	722 778 297	157 176 642	105 522 019	57 709 002	156 644 462	30 982 768	37 659 740	15 072 876	8 420 946
3			1 375 429	2 198 387 910	630 865 234	147 362 311	65 293 628	187 460 419	32 328 842	35 525 511	28 568 604	14 269 057
4				1 318 887	1 782 808 775	701 978 017	170 839 707	193 947 255	40 271 597	31 876 440	19 836 171	9 173 443
5					6 125 735	1 653 576 835	723 452 727	254 485 851	46 233 225	42 448 922	20 462 252	9 831 588
6						3 528 801	1 928 615 483	631 769 651	162 114 904	60 409 053	31 165 520	14 533 564
7							3 754 656	1 974 679 663	694 751 999	136 331 177	94 995 622	23 827 253
8								7 044 375	2 107 192 349	590 318 224	107 828 511	86 075 777
9									7 024 065	1 838 161 553	675 263 344	105 087 240
10										6 974 933	1 732 309 485	587 925 357
11											8 646 725	1 865 811 586
12												2 720 121
Grand Tot	793 630	1 974 768 902	3 179 482 629	3 326 096 223	2 701 010 138	2 680 697 561	2 996 971 731	3 561 109 373	3 143 735 715	2 814 632 210	2 746 887 153	2 735 209 745

Bazuar në analizat tona, dolëm në përfundimin që të dhënat nga sistemi i faturimit kanë një saktësi të arsyeshme, dhe si të tilla, ne vendosëm të kryejmë një filtrim (query) direkt SQL mbi këto të dhëna.

- Si pjesë e fazës së analizimit të të dhënave, Deloitte kreu një vlerësim të cilësisë të të dhënave në bazën e centralizuar të të dhënave të faturimit.
- Rezultatet e vlerësimit të cilësisë të të dhënave janë paraqitur në formë statistikore në të djathtë.
- Çështjet më madhore vijnë si pasojë e gabimeve njerëzore të kryera nga operatorët në pikat e arkëtimit.
- Nga perspektiva e të dhënave, çështja më madhore është në kollonën e datës së faturimit në tabelën e transaksioneve “Konsumi i pajtimtareve”, e cila është materializuar në afërsisht 10 000 transaksione me datë pagese të faturës më të hershme se data e lëshimit të faturës.

Tabela e Konsumit të Klienteve

Totali i numrit të regjistrimeve	90.1
Shuma totale e faturave (milion)	349,846
Data më e vogël e faturës	30.12.1899
Data më e madhe e fatures	26.10.2026

Gabime në të dhëna	Numri i regjistrimeve
Faturat e krijuara përpara 1.1.2008 (milion)	46.34
Fatura të paguara përpara krijimit	9,777
Fatura pa kontrate egzistuese	160
Fatura për fushën e leximit të energjisë	14
Fatura pa shume	461
Fatura pa datën e krijimit	1,748
Fatura pa taksë	52

Tabela e Kontratave

Totali i numrit të regjistrimeve	1,180,540
-----------------------------------------	------------------

Gabime në të dhëna	Numri i regjistrimeve
Kontrata pa fushë egzistuese të leximit të energjisë	88
Kontrata pa tarifë egzistuese	0
Kontrata pa emrin apo adresën e klientit	0

Tabela e konsumit të kabinës

Totali i numrit të regjistrimeve	1,617,268
-----------------------------------------	------------------

Gabime në të dhëna	Numri i regjistrimeve
Regjistrime pa kabinën egzistuese	3,715

Ne vlerësuam përputhshmërinë midis të dhënave të detajuara të përdorura në analizë dhe pasqyrave financiare të audituara duke kryer një rakordim mes tyre në mënyrë që të saktësojmë besueshmërinë e të dhënave.

Rakordimi i të dhënave me pasqyrat financiare të audituara

Gjatë procesit të rakordimit, ne rakorduam të dhënat e sistemit të faturimit dhe të arkëtimit me paqyrat financiare të audituara. Për të paraqitur një informacion në lidhje me auditimin, ne kemi listuar disa përkufizime sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) për të ndihmuar në kuptimin se çfarë do të thotë auditim financiar.

Auditimi i përkufizuar sipas ISA (ISA 200)

- „Qëllimi një auditimi është për të rritur shkallën e besimit të përdoruesve qëllimorë ndaj pasqyrave financiare. Kjo arrihet nga shprehja e një opinionit nga ana e auditorit nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, **në të gjitha aspektet materiale**, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar. Në rastin e shumicës së kuadreve të përgjithshme, ky opinion shprehet mbi faktin nëse pasqyrat financiare janë paraqitur në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, apo japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me kuadrin. Një auditim i kryer në bazë të SNA-ve dhe kërkesave përkatëse etike i mundësojnë auditorit formimin e këtij opinionit.”
- „Si bazë e opinionit të auditorit, ISA-të i kërkojnë auditorit të marri një **siguri të arsyeshme** nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve. Siguri e arsyeshme përbën një nivel të lartë të sigurisë. Ajo merret kur auditori ka marrë dëshmi audituese të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zvogëlimin e rrezikut të auditimit (që përbën, rrezikun që audituesi të shprehë një opinion të papërshtatshëm kur pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale) në një nivel të ulët të pranueshëm. Megjithatë, siguri e arsyeshme nuk është një nivel i sigurisë absolute, për shkak se ka kufizime të qënësishme të një auditimi të cilat kanë të bëjnë më shumë me evidencat e marra gjatë një auditimi në bazë të të cilave audituesi nxjerr përfundime dhe bazat e opinionit të auditimit të cilat janë më shumë bindëse sesa përfundimtare. “

- „Koncepti i materialitetit aplikohet nga audituesi gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit, dhe në vlerësimin e efektit të deklarimeve të gabuara të identifikuar në auditim dhe të gabimeve të pakorrigjuara, nëse ka, në pasqyrat financiare. Në përgjithësi deklarimet e gabuara, duke përfshirë pasaktësitë, konsiderohen si materiale kur, në mënyrë individuale ose kolektive, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit në bazë të pasqyrave financiare. Gjykimi mbi materialitetin kryhet nën dritën e rrethanave përreth, dhe ndikojnë në perceptimin e audituesit mbi nevojën e informacionit financiar të përdoruesve të pasqyrave financiare, si dhe nga madhësia ose natyra e deklarimit të gabuar, ose kombinimi i të dyjave. Opinioni i audituesit ka të bëjë me pasqyrat financiare në tërësi dhe si pasojë audituesi nuk ka përgjegjësi për identifikimin e deklarimeve të gabuara të cilat nuk janë materiale për pasqyrat financiare në tërësi.“
- Gjatë punës tonë, ne fillimisht kemi rakorduar të dhënat të cilat do të përdoren në përlogaritjen e Borxhit të Keq në pasqyrat financiare të auditura për arsye se ato janë testuar nga auditorët e Kompanisë.

Pasqyrat financiare të CEZ Shpërndarje janë audituar nga Ernst&Young në 2010, ndërsa në 2008 dhe 2009 nga Teit Gjini.

Gjatë katër viteve të fundit, kompanitë e mëposhtme të auditimit kanë audituar CEZ Shpërndarje dhe kanë lëshuar raportet në vijim:

Viti financiar 2010

Auditor: Ernst & Young Certified Auditors Sh.p.k. Skopje – Dega Tiranë

Opinion i auditorit mbi pasqyrat financiare të vitit financiar 2010:

- Opinion i kualifikuar
 - (nuk është verifikuar balanca e hapjes të audituara nga Teit Gjini)
- Tërheqje vëmendje
 - Pronësia mbi tokën dhe ndërtesat

Viti financiar 2009

Auditor: Teit GJINI (GJINI Consulting)

Opinion i auditorit mbi pasqyrat financiare të vitit financiar 2009:

- Opinion i pa kualifikuar me tërheqje vëmendje:
 - Njohja e të ardhurave
 - Llogari të arkëtueshme
 - Të arkëtueshme me KESH-in
 - Interesat e kredisë afatgjatë me KESH-in
 - Llogaritja e tatimit të shtyrë

Viti financiar 2008

Auditor: Teit GJINI (GJINI Consulting)

Opinion i auditorit mbi pasqyrat financiare të vitit financiar 2008:

- Opinion i kualifikuar :
 - Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike
 - Saktësia dhe plotësia e llogarive të arkëtueshme
 - Zhvlerësimi llogarive të arkëtueshme
 - Regjistrimi i pasurive të paluajtshme
 - Amortizimi i aktiveve fikse

Viti financiar 2007

Auditor: KPMG Albania Sh.p.k.

Opinion i auditorit mbi pasqyrat financiare të vitit financiar 2007:

- Refuzim i dhënies së opinionit për shkak të pamundësisë për të marrë deshmi të mjaftueshme gjatë auditimit për të ofruar një bazë për një opinion (auditori nuk ishte në gjëndje të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare).

Ne kemi identifikuar disa axhustime rakorduese që janë përfshirë në një tabelë rakordimi për të krijuar një urë lidhëse midis të dhënave të sistemit të faturimit dhe pasqyrave financiare të audituara.

- Gjatë punës me të dhënat e faturimeve dhe arkëtimeve dhe gjatë rakordimeve të kryera me pasqyrat financiare të audituara, disa elementë specifikë janë regjistruar jashtë sistemit të faturimit. Disa nga këto të fundit kanë një ndikim të rëndësishëm mbi vlerën e Borxhit të Keq dhe duhen marrë parasysh në përllogaritje.
- Axhustimet e mëposhtme janë identifikuar në urën lidhëse mes faturimeve dhe vlerës së audituar të të ardhurave si dhe mes arkëtimeve dhe parave të arketuara.

Të dhënat nga sistemi i faturimit

Shënime:

“+” tregon se të dhënat nuk janë përfshirë në bazën e të dhënave. Si të tilla, duhen t'i shtohen faturimeve dhe/ose arkëtimeve në mënyrë që të rakordohet mes shitjeve/mjeteve monetare/llogarive të arketueshme.

“-” tregon se të dhënat janë përfshirë dy here në bazën e të dhënave ose nuk janë të përshtatshme për t'u përfshirë. Si të tilla, duhen t'i zbriten faturimeve dhe/ose arkëtimeve në mënyrë që të rakordohet mes shitjeve/mjeteve monetare/llogarive të arketueshme.

“po” tregon se të dhënat janë të përshtatshme për t'u përfshirë në përllogaritjen e Borxhit të Keq

“jo” tregon se të dhënat nuk janë të përshtatshme për t'u përfshirë në përllogaritje por vetëm për qëlime rakordimi.

AXHUSTIME	Faturime	Arkëtime	Të aplikueshme për përllogaritjen e borxhit të keq
1. Persona me aftësi të kufizuar 80%	+	n/a	po
2A. Rezultatet e grupit NTL	-	n/a	jo
2B. Ngjarje pas datës së bilancit (fatura të anuluar)	-	n/a	po
3. Shitje të brendshme	-	-	po
4. Fatura të anuluar	-	-	po
5. Policia elektrike	+	+	po
6. Energjia reaktive	+	+	po
7. Klientë pa kontratë	+	+	po
8. Shitjet midis zonave	-	n/a	po
9. KESH	n/a	-	jo
10. PAGESA TË PJESSHME	n/a	+	po
11. Arkëtime nga viti i kaluar	n/a	+/-	po
12. Diferenca mes bazës të të dhënave F&A dhe raporteve nga sistemi i faturimit të CEZ	+/-	+/-	po
13. Tarifa e lidhjes	+	+	jo
14. Tarifa e shpërndarjes	+	+	jo
15. Te dhena nga Gjirokastra	+	+	po
16. Energjia e pafaturuar	+	+	po
17. PAGESA TE PAPERPUTHURA	n/a	+	po
18. Axhustime te tjera te vogla	+/-	+/-	jo
19. Diferenca te tjera	+/-	+/-	po

Pasqyrat financiare të audituara

2008, 2009 – Teit GJINI
2010 – E&Y

Ne kemi identifikuar disa axhustime rakorduese që janë përfshirë në një tabelë rakordimi për të krijuar një urë lidhëse midis të dhënave të sistemit të faturimit dhe pasqyrave financiare të audituara.

Axhustimi	Përshkrimi	Faturimet	Arkëtimet	E aplikueshme për Borxhin e Keq
1. Persona me aftësi të kufizuar 80%	<ul style="list-style-type: none"> Buxheti i shtetit subvencionon 80% të shumës së faturuar për një familje që ka të paktën një anëtar me aftësi të kufizuara. Sistemi njihet si të ardhur vetëm pjesën e mbetur të shumës së faturuar, prej 20%, që duhet paguar nga klienti. Prandaj, 80% duhet shtuar në rakordim. Kjo shumë nuk merret si para nga CEZ Shperndarje, por kompensohet (netohet) kundrejt pagesave për tatim fitimin. Sidoqoftë, kjo shumë ngelet akoma e pashlyer, dhe nuk është e qartë se si do paguhet. Detyrimi i pashlyer klasifikohet në bilancin verifikues si llogari e arkëtueshme nga zyra e tatimeve. Sidoqofte, duke qenë se CEZ Shperndarje nuk ka marrë asnjëherë ndonjë pagesë për këto të ardhura, si të tilla ato janë pjesë e Borxhit të Keq. 	+	n/a	po
2. Dëmi ekonomik/ Ngjarje pas bilancit (fatura të anuluar)	<ul style="list-style-type: none"> Gjatë viti 2010, Kompani ka lëshuar ndaj disa klientëve fatura për “Dëm Ekonomik”. Këto fatura janë lëshuar në rastin e lidhjeve të paligjshme me rrjetin. Për shkak të pasigurisë në lidhje me arkëtimin, të ardhurat provizionohen në pasqyrat financiare. Konsiderohet si pjesa A e axhustimit. 	-	n/a	jo
	<ul style="list-style-type: none"> ERE ka shqyrtuar këtë situatë dhe në 11 janar 2011 i ka dërguar një letër CEZ Shperndarje në të cilën i kërkon CEZ Shperndarje të anulojë disa nga këto fatura. Lista e faturave të anuluar i është dorëzuar ERE si dhe është publikuar. Prandaj këto fatura të anuluar nuk janë përfshirë në llogaritjen e borxhit të keq. Konsiderohet si pjesa B e axhustimit. 	-	n/a	po
3. Shitjet e brendshme	<ul style="list-style-type: none"> Konsumi i energjisë elektrike për përdorim të brendshëm regjistrohet në sistem si çdo klient tjetër. Kjo nuk përfshihet në llogaritje sepse nuk paraqet as të ardhur as llogari të arkëtueshme. Sidoqoftë, konsumi i brendshëm, nuk është trajtuar në mënyrë konsistente në çdo zonë. Vetëm disa prej zonave e kreditorin faturën e konsumit të brendshëm. Prandaj këto shuma janë hequr nga tabela e rakordimit. 	-	-	po

Ne kemi identifikuar disa axhustime rakorduese që janë përfshirë në një tabelë rakordimi për të krijuar një urë lidhëse midis të dhënave të sistemit të faturimit dhe pasqyrave financiare të audituara.

Axhustimi	Përshkrimi	Faturimet	Arkëtimet	E aplikueshme për Borxhin e Keq
4. dhe 10. Fatura të anuluar, pagesa të pjeshme	<ul style="list-style-type: none"> Sistemi i Faturimit nuk lejon futjen e pagesave të pjeshme për faturat si dhe anulimin e nje fature të lëshuar më parë. Sistemi nuk parashikon funksionin e kreditimit te pageses por vetem regjistrimin e shumës së faturës pranë shumës së faturuar. Si rrjedhojë, duke qenë së fatura nuk mund të kreditohet, ajo duhet shënuar si e paguar në sistemin e Faturimit dhe pastaj mund të lëshohet një fature e re. Në këtë mënyrë pagesat e pjeshme mbahen jashtë sistemit derisa pagesa e plotë të kreditohet me faturën. Të dhënat mbi faturimin dhe arkëtimin janë axhustuar të pasqyruarsiq duhet situatën : 			
	<ul style="list-style-type: none"> Fatura të anuluar Pagesa pjesore 	-	-	po
		n/a	+	po
5. Policia elektrike	<ul style="list-style-type: none"> Energjia elektrike e faturuar në 2008 ndaj individëve apo kompanive që ishin lidhur ilegalisht me rrjetin. Kjo është regjistruar jashtë sistemit të faturimit dhe regjistrohet kur arkëtohet. I është shtuar faturimit si dhe arkëtimit. 	+	+	po
6. Energjia reaktive	<ul style="list-style-type: none"> Përfaqson transaksione që janë faturuar jashtë sistemit të faturimit në 2008 dhe 2009 në lidhje me disa kushte të furnizimit. I është shtuar faturimit si dhe arkëtimit. Në 2010 kjo ishte e përfshirë tashmë në sistemin e Faturimit. 	+	+	po

Ne kemi identifikuar disa axhustime rakorduese që janë përfshirë në një tabelë rakordimi për të krijuar një urë lidhëse midis të dhënave të sistemit të faturimit dhe pasqyrave financiare të audituara.

Axhustimi	Përshkrimi	Faturimet	Arkëtimet	E aplikueshme për Borxhin e Keq
7. dhe 15. Klientë pa kontrat, të dhëna nga Gjyrokastër	<ul style="list-style-type: none"> Përfaqson transaksione që janë faturuar jashtë sistemit të Faturimit, p.sh klientë që nuk kanë kontratë dhe nuk janë përfshirë në sistemin e Faturimit ose sepse sistemi është implementuar në disa zona pas janarit 2008 (në Gjyrokastër në 2008 dhe një pjesë të 2009). Si të tilla, këto faturime dhe arkëtime i janë shtuar të ardhurave. 	+	+	po
		+	+	po
8. Shitjet midis zonave	<ul style="list-style-type: none"> Përfaqson furnizimin mes zonave, në rastet kur një zonë nuk ka energji elektrike të mjaftueshme për klientin fundor. Vetëm të ardhurat regjistrohen në sistem, prandaj këto shuma i zbriten të ardhurave. 	-	n/a	po
9. KESH	<ul style="list-style-type: none"> Pagesa që janë marrë për fatura të lëshuara deri në fundin e vitit financiar 2006. Kjo para është arkëtuar nga CEZ Shperndarje por i është dhënë pastaj KESH. Trajtohet si një zbritje nga arkëtimi. 	n/a	-	jo









Ne kemi identifikuar disa axhustime rakorduese që janë përfshirë në një tabelë rakordimi për të krijuar një urë lidhëse midis të dhënave të sistemit të faturimit dhe pasqyrave financiare të audituara.

Axhustimi	Përshkrimi	Faturimet	Arkëtimet	E aplikueshme për Borxhin e Keq
11. Arkëtime nga viti i kaluar	<ul style="list-style-type: none"> Ky axhustim ka të bëjë kryesisht me pagesat që i përkasin periudhës së kaluar ose periudhës që vjen. Zakonisht, një pagesë merret në fund të një periudhe dhe për shkak të mungesës së kohës, kjo pagesë alokohet dhe kreditohet me faturën korresponduese vetëm vitin tjetër. Prandaj këto pagesa janë përjashtuar nga viti aktual dhe i shtohen arkëtimit të vitit të mëparshëm, kur marret faktikisht dhe pagesa. 	n/a	⊕ / ⊖	po
12. Diferenca mes databazës F&A dhe raporteve të CEZ nga sistemi i faturimit	<ul style="list-style-type: none"> Ka disa diferenca midis të dhënave të faturimit dhe arkëtimit që na u paraqitën dhe të dhënave që CEZ Shperndarje përdor në rakordimet e tij, diferenca të cilat nuk na u shpjeguan. 	⊕ / ⊖	⊕ / ⊖	po
13. Tarifa e lidhjes	<ul style="list-style-type: none"> Përfaqson tarifën për lidhjet e reja. Duke qenë se nuk futet në llogaritjen e tarifës, ne e kemi përjashtuar nga llogaritja e borxhit të keq. 	⊕	⊕	jo

Ne kemi identifikuar disa axhustime rakorduese që janë përfshirë në një tabelë rakordimi për të krijuar një urë lidhëse midis të dhënave të sistemit të faturimit dhe pasqyrave financiare të audituara.

Axhustimi	Përshkrimi	Faturimet	Arkëtimet	E aplikueshme për Borxhin e Keq
14. Tarifa e shpërndarjes	<ul style="list-style-type: none"> Përfaqson faturimin për aksesimin dhe përdorimin e rrjetit nga palë të treta. Duke qene se këto fatura lëshohen jashtë sistemit të Faturimit, ne ia shtuam faturimit për qëllim rakordimi. Duke qenë se nuk përfshihet në llogaritjen e tarifës, ne e përjashtojme nga llogaritja e borxhit të keq. 	+	+	jo
16. Energjia e pafaturuar	<ul style="list-style-type: none"> Përfaqson energji elektrike që i është dhënë klientëve por nuk është faturuar akoma. Ka të bëjë me ndryshime në sistemin e faturimit të implementuara në 2010. Llogaritet mbi faturat e lëshuara në janar 2011, që pjesërisht mbulojnë periudhën e 2010. Këto i shtohen të ardhurave. Në llogaritje, arkëtimi i energjisë së pafaturuar trajtohet me të njëjtën strukturë moshë siç është realizuar për llogaritë e arkëtueshme si trendin e pagesës nga periudhat e mëparshme. Prandaj nuk ndikon në nivelin e arkëtitimit. 	+	+	po
<p>The diagram illustrates the timing of energy consumption, billing, and bill issuance. A horizontal timeline starts at 7 dhjetor 2010 and ends at 7 janar 2011. A vertical line marks 'Fatura lëshohet' (Bill issued) on January 7, 2011. A double-headed arrow labeled 'Periudha e konsumimit (periudha e faturimit)' spans from 7 dhjetor 2010 to 7 janar 2011. Another double-headed arrow labeled 'Energjia e pafaturuar (Shitjet 2010)' spans from 7 dhjetor 2010 to 31 dhjetor 2010. A third double-headed arrow labeled '(Shitjet 2011)' spans from 31 dhjetor 2010 to 7 janar 2011.</p>				
17. Pagesa që nuk janë identifikuar	<ul style="list-style-type: none"> Përfaqson pagesa që janë marrë dhe për të cilat nuk është identifikuar fatura korrespondente, por që janë identifikuar në periudhat e mëvonshme. Mund t'i referohet edhe zërave që janë brenda sistemit të faturimit apo jashtë sistemit të faturimit. 	n/a	+	po

Ne kemi identifikuar disa axhustime rakorduese që janë përfshirë në një tabelë rakordimi për të krijuar një urë lidhëse midis të dhënave të sistemit të faturimit dhe pasqyrave financiare të audituara.

Axhustimi	Përshkrimi	Faturimet	Arkëtimet	E aplikueshme për Borxhin e Keq
18. Axhustime të tjera të vogla	<ul style="list-style-type: none"> Disa axhustime të tjera të vogla që përfshijnë shlyerjen jo me para të llogarive të arkëtueshme, vjedhjet e parasë së mbledhur përpara momentit të depozitimit në bankë, diferenca në çmimin e aplikuar që janë mbajtur jashtë databazës. 	 / 	 / 	jo
19. Diferenca të tjera	<ul style="list-style-type: none"> Departamenti i shitjeve dhe ai i kontabilitetit nuk mundën të na jepnin shpjegime të mjaftueshme për diferencat e vogla të mbetura mes sistemit të faturimit dhe të dhënave të kontabilitetit. Këto diferenca shkojnë nga 0.81% në 2008, +1.01% në 2009 deri në 0.17% në 2010, si përqindje e faturimeve të axhustuara. Ndikimi kumulativ për të tre vitet (2008-2010) është vetëm 0.05% mbi të gjithë faturimet e axhustuara. Këto diferenca kanë të bëjnë kryesisht me arkëtime që janë përputhur në mënyrë të vazhdueshme me fatura në vite të ndryshme. Si të tilla, në 2008 dhe 2009 është e dukshme që ato kompensojnë (netojnë) njëra tjetrën dhe prandaj nuk i konsiderojmë në llogaritjet për këto vite. Sidoqofte ndikimi për të tre vitet është vetëm 0.06% i totalit të faturimeve të axhustuara. 	 / 	 / 	po

Zëra të tjerë që nuk janë përfshirë:

- Interesi penalitet**

- Interesi penalitet nuk futet në sistemin e faturimit dhe regjistrohet kur arkëtohet. Për këtë ai nuk ndikon në rakordimin e kryer. Interesi penalitet nuk konsiderohet si një pjesë e FPP.

- TVSH**

- TVSH nuk ka impakt mbi metodologjinë dhe llogaritjet. Të gjitha të dhënave relevante (shitjet dhe arkëtimet) i është axhustuar TVSH ku ishte e nevojshme.

Ne kemi identifikuar disa axhustime rakorduese që janë përfshirë në një tabelë rakordimi për të krijuar një urë lidhëse midis të dhënave të sistemit të faturimit dhe pasqyrave financiare të audituara.

Shënime për trajtimet Specifike për axhustimet në llogaritje

Axh. 11 - Arkëtimet e viti të kaluar

Ky axhustim përfaqson vetëm një diferencë kohore mes marrjes reale të parasë dhe regjistrimit të tyre në sistemin e Faturimit për një vit të caktuar. Në llogaritjet tona bazuar mbi metodën e të Ardhurave, ne po përdorim si arkëtim informacionin për të gjithë arkëtimet gjatë periudhës 1 janar 2008 – 18 maj 2011 në lidhje me një grup specifik faturash (faturat e 2008, 2009 ose 2010), informacioni për këto pagesa është i futur tashmë në llogaritje. Në Metodën e pasqyrimit të bilancit, marrja e këtyre arkëtimeve shtesë është reflektuar në përqindjet e trendit të arkëtimit, të cilat konvertohen në përqindje arkëtimi për metodën e pasqyrimit të Bilancit, prandaj nuk ka nevojë për ndonjë axhustim në provizione. Për këtë shkak ne duhet ta konsiderojmë vetëm për qëllime rakordimi.

Axh. 15 - Të dhëna nga Gjirokastra

Në 2008 dhe në tre muajt e parë të 2009, për Gjirokastrën ne kemi informacion për arkëtimet e ndodhura, por nuk kemi mundësi të bëjme lidhjen me faturat dhe të përcaktojmë nëse arkëtimet kanë të bëjnë me faturime të 2007, 2008 apo 2009, si dhe nuk mund të vlerësojmë arkëtimet e ardhshme për vitet që vijnë. Prandaj për llogaritjen e arkëtimeve me metodën e të Ardhurave ne llogarisim përqindjen mesatare të arkëtimit duke u bazuar në të dhënat e marra për të dy vitet 2008 dhe 2009, dhe e aplikojmë këtë % mbi pjesën e faturimit që është faturuar jashtë sistemit të Faturimit në Gjirokastër. Pastaj, sipas metodës së Bilancit, diferenca mes faturimit dhe arkëtimeve të pritshme merret si provizion dhe konsiderohet i pa-arkëtuar.

Axh. 3,4,8 – Shitjet e brendshme, Faturat e anuluar dhe Shitjet mes zonave

Për shkak të kufizimeve të sistemit dhe gabimeve njerëzore, këto axhustime mund të mos netojnë (kompensojnë) njëra-tjetrën në faturim dhe arkëtim. Prandaj diferenca do t'i rriste ose zvogëlonte llogaritë e arkëtueshme. Si në metodën e pasqyrimit të bilancit, ne i bëmë llogaritjet tona mbi të dhënat primare, pa konsideruar këto axhustime. Si rrjedhojë provizioni i llogaritur si një bazë për llogaritjen është ose më i lartë ose më i vogël. Prandaj ne aplikuar normën mesatare të provizionit mbi llogaritë e arkëtueshme sipas kompanisë në çdo vit mbi këto diferenca duke axhustuar perkatesisht provizionin e llogaritur. Në metodën e Pasqyrës së të Ardhurave ne përdorim shifrat egzistuese prandaj nuk ka nevojë për konsiderata të tjera.

Axh.16 – Energjia e pafaturuar

Kjo ka të bëjë vetëm me vitin financiar 2010. Për të llogaritur arkëtimet për metodën e Pasqyrës së të Ardhurave ne aplikojmë norma mestare arkëtimi për të gjithë kompaninë. Në metodën e Bilancit, diferenca mes faturimit dhe arkëtimeve të pritshme merret si shtesë ndaj provizionit meqë konsiderohet e pa-arkëtuar.

Rakordimi i të dhënave të përdorura në metodën e pasqyrës së të ardhurave – faturimet

ALL						
Rakordimi i faturimeve	FY 2008	% mbi shitjet	FY 2009	% mbi shitjet	FY 2010	% mbi shitjet
as per B&C database (ALL)	36,958,486,302	92.40%	42,195,256,355	96.16%	51,515,009,186	102.68%
Axh 1 - Persona me aftësi të kufizuar 80% Netuar në pasqyrat financiare të 2010	505,453,554	1.26%	635,367,598	1.45%	742,752,851	1.48%
Axh 2A - Rezultatet e grupit NTL					-742,752,851	-1.48%
Axh 2B - Ngjarje pas datës së bilancit (fatura të anuluar)					-4,008,487,200	-7.99%
Axh 3 - Shitje të brendshme	-150,470,235	-0.38%	-183,463,088	-0.42%	-98,223,254	-0.20%
Axh 4 - Fatura të anuluar	-74,504,885	-0.19%	-14,803,779	-0.03%	-7,542,302	-0.02%
Axh 5 - Policia elektrike	16,216,520	0.04%				
Axh 6 - Energjia reaktive	10,971,847	0.03%	22,159,864	0.05%	0	0.00%
Axh 7 - Klientë pa kontratë	118,522,680	0.30%	0	0.00%	0	0.00%
Axh 8 - Shitjet midis zonave	-16,759,470	-0.04%	-5,827,869	-0.01%	0	0.00%
Axh 9 - KESH						
Axh 10 - Pagesa të pjeshme						
Axh 11 - Arkëtime nga viti i kaluar						
Axh 12 - Diferenca mes databazës B&C dhe raporteve nga sistemi I billingut të CEZ	-9,297	0.00%	-20,071,086	-0.05%	-369,558	0.00%
Axh 13 - Tarifa e lidhjes	774,217,200	1.94%	672,362,400	1.53%	648,543,600	1.29%
Axh 14 - Tarifa e shpërndarjes	116,635,200	0.29%	131,335,200	0.30%	150,501,600	0.30%
Axh 15 - Të dhëna nga Gjyroskastra	1,725,584,215	4.31%	447,743,840	1.02%		
Axh 16 - Energjia e pafaturuar (2010)					1,966,776,000	3.92%
Axh 17 - Pagesa që nuk janë identifikuar akoma						
Axh 18 - Axhsutime të tjera të vogla	9,856,466	0.02%		0.00%		0.00%
Axh 19 - Diferenca të tjera	3,074,665	0.01%	1,571,628	0.00%	2,285,098	0.00%
Totali i axhustimeve (duke përfshirë TVSH)	3,038,788,460	7.60%	1,686,374,708	3.84%	-1,346,516,016	-2.68%
Faturimi i AXHUSTUAR sipas kontabilitetit (përfshirë TVSH)	39,997,274,762		43,881,631,063		50,168,493,169	
minus TVSH 20%	-6,666,212,460		-7,313,605,177		-8,361,415,528	
Faturimi sipas databazës (pa TVSH)	33,331,062,301		36,568,025,886		41,807,077,641	
Sipas pasyrave financiare të audituara (pa TVSH)	33,331,062,000		36,568,026,000		41,808,400,000	
Diferenca	-301	0.00%	114	0.00%	1,322,359	0.00%

Rakordimi i të dhënave të përdorura në metodën e pasqyrës së të ardhurave – arkëtimet

ALL Rakordimi i arkëtimeve	FY 2008	% mbi shitjet	FY 2009	% mbi shitjet	FY 2010	% mbi shitjet
as per B&C database	29,754,178,698	-74.39%	31,895,007,716	-72.68%	38,981,735,730	-77.70%
Axh 1 - Persona me aftësi të kufizuar 80% Netuar në pasqyrat financiare të 2010	505,453,554	-1.55%	635,367,598	-1.45%	742,752,851	-1.48%
Axh 2A - Rezultatet e grupit NTL					0	0.00%
Axh 2B - Ngjarje pas datës së bilancit (fatura të anuluar)	-97,464,874	0.24%	-89,723,239	0.27%	-81,956,092	0.16%
Axh 3 - Shitje të brendshme	-74,504,885	0.19%	-64,452,917	0.19%	-52,153,109	0.10%
Axh 4 - Fatura të anuluar	16,216,520	-0.04%				
Axh 5 - Policia elektrike	10,971,847	-0.03%	3,054,675	-0.01%	0	0.00%
Axh 6 - Energjia reaktive	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%
Axh 7 - Klientë pa kontratë						
Axh 8 - Shitjet midis zonave	-213,427,893	0.53%	-27,259,093	0.08%	-54,785,671	0.11%
Axh 9 - KESH	4,509,767	-0.01%	17,705,737	-0.05%	328,240,842	-0.65%
Axh 10 - Pagesa të pjesshme	-50,000,000	0.13%	88,951,495	-0.26%	-71,778,719	0.14%
Axh 11 - Arkëtime nga viti i kaluar	-17,592,002	0.04%	-1,646,925	0.00%	-3,999,337	0.01%
Axh 12 - Diferenca mes databazës B&C dhe raporteve nga sistemi i billingut të CEZ	774,217,200	-1.94%	672,362,400	-2.00%	648,543,600	-1.29%
Axh 13 - Tarifa e lidhjes	116,635,200	-0.29%	131,335,200	-0.39%	150,501,600	-0.30%
Axh 14 - Tarifa e shpërndarjes	1,626,387,195	-4.07%	534,658,984	-1.59%		
Axh 15 - Të dhëna nga Gjyroskastra					0	0.00%
Axh 16 - Energjia e pafaturuar (2010)	6,940,655	-0.02%	120,347,704	-0.36%	437,542,566	-0.87%
Axh 17 - Pagesa që nuk janë identifikuar akoma	-554,071	0.00%	0	0.00%	-14,805,824	0.03%
Axh 18 - Axhsutime të tjera të vogla	323,373,199	-0.81%	-338,415,983	1.01%	87,405,982	-0.17%
Axh 19 - Diferenca të tjera						
total adjustments	2,931,161,412	-7.33%	1,682,285,636	-5.01%	2,115,508,689	-4.22%
Arkëtimet e AXHUSTUARA sipas kontabilitetit (përfshirë TVSH)	32,685,340,110		33,577,293,352		41,097,244,419	
Shuma sipas të dhënave bankare / Kontabiliteti	32,685,340,110		33,577,293,352		41,097,244,419	
diferenca	0		0		0	
minus TVSH 20%	-5,447,556,685		-5,596,215,559		-6,849,540,737	
Arkëtimet pa TVSH	27,237,783,425		27,981,077,793		34,247,703,683	

Rakordimi i të dhënave të përdorura në metodën e Bilancit – Ilogaritë e arkëtueshme

Rakordimi i llogarive të arkëtueshme përfshirë TVSH (në 000' ALL)	Faturimi & Arkëtimi i Axhustuar	Të dhëna nga databaza F&A sipas Deloitte	Axh. 9 - Kesh	LLA e pritshme D=(OB A+B+C)	LLA nga databaza F&A E	Diferenca e parakorduar (D-E)	% diferencës së parakorduar mbi LLA*	
	Teprica hapëse A	B	C					
T.H 01.01.2007	0							
Faturuar 2007	30,457,050	28,860,967						
Arkëtim 2007	(21,641,258)	(24,751,045)	5,428,272					
Teprica hapëse 2008	Totali i llogarive të arkëtueshme 01.01.2008 sipas PF/BV	4,109,922	5,428,272		9,538,194	9,873,545	(335,351)	-3.8%
	Diferenca	0						
	Faturuar 2008	39,997,274	36,958,486					
	Arkëtimet 2008	(32,685,340)	(29,754,179)	213,428				
Teprica mbyllëse 2008	Totali i llogarive të arkëtueshme 31.12.2008	16,127,726	7,204,307	213,428	17,291,280	17,370,568	(79,288)	-0.5%
	Të arkëtueshme të tjera Jo-energji	9,909						
	Totali i llogarive të arkëtueshme 31.12.2008 sipas PF	16,137,635						
	Diferenca	0						
Faturuar 2009	43,881,631	42,195,256						
Arkëtuar 2009	(33,577,293)							
Të dhënat Gjirokastra		(31,895,008)	27,259					
Teprica mbyllëse 2009	Totali i llogarive të Arkëtueshme 31.12.2009	10,300,248	27,259		27,698,076	27,663,295	34,781	0.1%
	Arkëtimet pa adresë 2009	(103,293)						
	Lidhje të reja + Të tjera	55,645						
	Totali i llogarive të Arkëtueshme 31.12.2009 sipas PF	26,394,225						
	Diferenca	100						
Faturuar 2010	50,168,493	51,515,009						
Arkëtuar 2010	(41,097,244)	(38,981,735)	(54,786)					
Të ardhurat të netuara me TVSH								
Teprica mbyllëse 2010	Totali i llogarive të Arkëtueshme 31.12.2010	12,533,273	54,786		40,251,354	40,225,966	25,388	0.1%
	Arkëtimet pa adresë 2010	(130,880)						
	TVSH nga të ardhurat e netuara	(527,184)						
	Totali i llogarive të Arkëtueshme 31.12.2010 sipas PF	34,807,294						
	Diferenca	116						

Shënim: * rezultatet të çështjeve të identifikuar nga të dhënat nga databaza, për detaje shih seksionin „Analiza e sistemit të faturimit“.

Ne i vlerësojmë të dhënat e faturimit dhe arkëtimit si të një saktësie të arsyeshme dhe të rakordueshme me pasqyrat financiare dhe si të tilla ne i gjykojmë ato si një bazë e arsyeshme për kryerjen e Studimit

Konkluzioni ynë në lidhje me të dhënat bazë

- Bazuar mbi vlerësimin e cilësisë së të dhënave master dhe të dhënave të transaksioneve në databazën e centralizuar të faturimit që na u paraqit (faturimi dhe arkëtimi për periudhën 1 janar 2008 deri në 18 maj 2011) ne vumë re që:
 - Volumi i të dhënave me gabime (në fushat e vlerësuara) ishte poshtë 0.01% të totalit të popullatës së të dhënave, në maksimum , në tabelat respektive me të dhëna.
 - Duke konsideruar numrin e regjistrimeve për transaksione dhe volumin financiar të këtyre transaksioneve të gabuara arritëm në përfundimin që ky gabim nuk ndikon në mënyrë të qenësishme në saktësinë e llogaritjes së borxhit të keq për qëllim të Studimit të Borxhit të Keq;
- Ne rakorduar të dhënat e faturimit dhe arkëtimit me pasqyrat financiare të audituara dhe rezultatet kryesor të analizës tonë ishin si më poshtë:
 - Ne identifikuar disa zëra axhustues që na u qartësuan nga CEZ Shperndarje (p.sh energjia e pafaturua në 2010, faturat për njerëzit me aftësi të kufizuara, dëmi ekonomik);
 - Bazuar mbi analizën tonë diferencat e mbetura mes të dhënave në sistemin e faturimit dhe të dhënave të kontabilitetit për të cilat CEZ Shperndarje nuk mund të jepte shpjegim nuk ishin thelbësore. Impakti kumulativ për të tre vitet (2008-2010) është vetëm 0.05% mbi totalin e faturimeve të axhustuara.
- **Si rezultat i procedurave tona, ne i konsiderojmë të dhënat bazë si të arsyeshme për kryerjen e Studimit të Borxhit të Keq.**

Nën-seksionet	Faqe
Paraqitje teorike	36
Panoramë e kuadrit rregullator	44
Deklarata Rregullatore	45
Manuali i Kontabilitetit i ERE	46

Shpjegim teorik për llogaritë e arkëtueshme dhe qasjes për mbledhjen e tyre

Në këtë seksion ne paraqesim teorinë që lidhet me kontabilizimin e të ardhurave të njohura, shitjeve dhe fillimit të faturimit dhe arkëtimit të parasë dhe trajtimi i tij kontabël plotësuar me shembuj:


Njohja e llogarive të arkëtueshme bazuar në parimin e të drejtave të konstatuara

- Parimi i të drejtave të konstatuara ndan njohjen e të ardhurave nga arkëtimi. Si rezultat, shitësi i njehtë ardhurat para arkëtimit dhe shitësi i njehtë ardhurat e tilla si llogari të arkëtueshme (e njëjta sasi është një llogari e pagueshme në bilancin e blesit.) Fakti që disa konsumatorë nuk do të paguajnë detyrimet e tyre do të thotë se bilanci kontabël i vlerës së llogarive të arkëtueshme duhet të tregojë, jo shumën bruto që i detyrohen, por shumën e zvogëluar me vlerën që shitesit vlerëson si të pa arkëtueshme. Më tej, ne përshkruajmë procedurën e kontabilitetit të quajtur metoda e shumës së lejuar (zbritja), për këto shuma të cilat vlerësohen si të pa arkëtueshme.
- Llogaritë e arkëtueshme (ose të arkëtueshmet tregtare) është shuma që i detyrohen një shitësi nga konsumatorët që kanë blerë mallra dhe shërbime me pagesa të mëvonshme. Në menyrë tipike, shitesit pret për të mbledhur paratë brenda një kohe të arsyeshme të shkurter, të tilla si 30 ditë, kështu që një llogari e arkëtueshme është zakonisht aktiv qarkullues.

Shënim: Megjënese nganjëherë terminologjia përshkruan të njëjtët elementë në mënyra të ndryshme, më poshtë janë përmbledhur shprehjet që përdoren në mënyrë ekuivalente.

- Metoda e pasqyimit të Bilancit = Procedurat e Moshës së Llogarive të Arkëtueshme = Metoda e Shumës së lejuar (metoda e zbritjes) = Përqindja e llogarive të paarkëtuara*
- Metoda e Pasqyrës të të Ardhurave = Procedurat e Përqindjes së Shitjeve*
- Shpenzimi për borxhin e keq = Ngarkesa për Borxhin e Keq = Provizioni për shpenzimin e borxhit të keq*
- Zbritja për të pa-arkëtueshmet = Zbritja për Llogaritë e Arkëtueshme = Zbritja për shumën e Pa-arkëtueshme = Provizion për Llogaritë e Arkëtueshme*

Shënim: Borxhi i Keq është pjesë e llogarive të arkëtueshme që konsiderohet si i pa-arkëtueshëm.



Shpjegim teorik i metodës së shumës së lejuar për llogaritë që konsiderohen të pa-arkëtueshme

Vlerësimi i llogarive të arkëtueshme

- Dy çeshtjet e kontabilitetit për llogaritë e arkëtueshme janë:
 - 1) matja e shumës në bilanc dhe
 - 2) koha e njohjes së reduktimit të të ardhurave të shkaktuara nga mos arkëtimi i disa llogarive.
- Në lidhje me matjen, të dyja standardet, GAAP të SHBA dhe të SNRF kërkojnë që shitësi të raportojë llogaritë e arkëtueshme neto nga shumat e vlerësuara si të pa arkëtueshme; që është, shuma që firma pret që të arkëtoje nga klientët, e cila do të jetë më pak se shuma që të gjithë konsumatorët kanë rënë dakord për të paguar.
- Në lidhje me kohën, të dyja standardet, GAAP të SHBA dhe të SNRF kërkojnë që një shitës të njohë një shpenzim si llogari të pa arkëtueshme në te njejtën periudhë kur nje të ardhurat të lidhura me to.
- Shembulli në vijim ilustron këto kërkesa të kontabilitetit

Shembull teorik

- Në fund të 30 ditëve, një firmë nuk ka mbledhur të gjitha llogaritë e arkëtueshme.
- Firma merr masa për të mbledhur, të tilla si dergimin e një fature tjetër dhe duke e lajmeruar klientin.
- Të dy veprimet do të sjellin disa pagesa nga konsumatorët, por disa llogari të klientëve do të vazhdojnë të mbeten të pa arkëtuara.
- Si politikë e biznesit, firma i trajton llogaritë e pa arkëtuara brënda gjashtë muajve nga faturimi si të pa arkëtueshme

Burimi: Materiale trajnimi nga Deloitte

Shpjegim teorik i metodës së shumës së lejuar për llogaritë që nuk kanë shpresë të arkëtohen

Provizionimi specifik / i përgjithshëm, deklarimi

- Njohja e të ardhurave para se shitësi të mbledhë paratë kërkon vlerësimin e shumës së llogarive të pa-arkëtueshme me një saktësi të arsyeshme. Të dyja standardet GAAP i ShBA dhe SNRF kërkojnë përdorimin e metodës së shumës së lejuar (zbritjes) për llogaritë e pa-arkëtueshme, e cila përfshin vlerësimin e shumës së pa arkëtueshme të llogarive të arkëtueshme e lidhur kjo me çdo periudhë kontabël të shitjes me pagesa të vonuara. Firma njih këtë shumë të vlerësuar si një shpenzim të periudhës së shitjes, duke përputhur shpenzimet me të ardhura që lidhen me to. Kundërpartia e kredituar është një llogari e kundërt e aktivitetit, Zbritje për Mosarkëtim, e cila zbritet totalin e llogarisë së arkëtueshme (Llogari të Arkëtueshme, Bruto), në një vlerë të parasë për të cilën firma pret t'i mbledhë nga klientët (Llogari të Arkëtueshme, Neto).
- Shpenzim për Borxhin e Keq është quajtur gjithashtu Provizionimi i Borxhit të Keq dhe Provizionimi i Llogarive të Pa-arkëtueshme. Firma duke bërë një regjistrim nuk kryen çregjistrim të llogarive të klientëve specifikë si të pa-arkëtueshme; por, firma po bën përlllogaritjen e llogarisë së arkëtueshme në shumën e pritur për tu mbledhur. Ajo akoma se di se cila llogari duhet të çregjistrohet për arsye se ata nuk kanë vërtetuar ende mos arkëtimin e tyre.
- Provizionimi mund të jetë i përgjithshëm ose specifik:
 - Specifik – i dhënë ndaj një klienti të veçantë
 - I përgjithshëm – përqindje e aplikuar mbi totalin e llogarive të arkëtueshme
- Provizionimi specifik përdoret në kompanitë me një numër të vogël të klientëve të mëdhenj. Në këtë rast, çdo klienti i përcaktohet një probabilitet i mos arkëtimit. Totali i parashikuar si i pa arkëtueshem rezulton si provizion për borxhin e keq.
- Ne nuk do të japim më shumë detaje ose shembuj për këtë metodë për arsye se, llogaritë e arkëtueshme të CEZ Shpërndarje përbehen nga një numër i madh i të arkëtueshmeve të vogla, prandaj kjo metodë nuk do të ishte e përshtatshme.

Shembull teorik

Në njohjen fillestare, llogaritë e arkëtueshme shprehen me vlerën e drejtë të shumës që merret ose do të merret. Zhvlerësimi regjistrohet kur vlera e rikuperueshme, bazuar mbi mundësinë e rikuperimit të vlerësuar sipas tipit të llogarisë së arkëtueshme, është më e vogël se vlera historike. Në varësi të natyrës së llogarisë së arkëtueshme, rreziku që lidhet me llogaritë e arkëtueshme të dyshimta vlerësohet individualisht ose me metoda statistikore që bazohen mbi përvojën. Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë gjithashtu të ardhura që bazohen mbi vlerësime të energjisë elektrike që është furnizuar por nuk është matur ose faturuar. Për të mbuluar rrezikun potencial që këto të ardhura nuk do të mblidhen më pas, kontabilizohet një zhvlerësim.

Burimi: Pasqyrat Financiare të konsoliduara më 31 dhjetor 2010 të EDF

Shpjegim teorik i metodës së shumës së lejuar për llogaritë që nuk kanë shpresë të arkëtohen

Paraqitja e borxhit të keq – si shpenzim ose ulje e të ardhurave

- Paraqitja e provizionit të borxhit të keq brenda pasqyrës së të ardhurave mund të ndryshojë.
- Praktika ndryshon nëse debitimi në këtë veprim kontabël është në një llogari shpenzimesh ose në një llogari të ardhurash.
- Disa kompani e debitojnë Shpenzimin për Borxhin e Keq dhe përfshijnë vlerën e tij në Shpenzime të Shitjes, të Përgjithshme dhe Administrative bazuar në pikëpamjen se shitja me pagesa të mëvonshme përfshin domosdoshmerisht një sasi të borxhit të keq.
- Kontabilizimi i debisë në një llogari të ardhurash mat shitjet neto në nivelin e parasë që kompania parashikon të mbledhë. .
- **Ndonëse ne e gjejmë si të bindshëm argumentin për përdorimin e llogarisë së të ardhurave, ne debitojmë Shpenzime për Borxhin e Keq për arsye se është një praktikë e zakonshme. P.sh., CEZ Shperndarje përdor këtë metodë në pasqyrat e saja financiare.**

Shembull teorik

Të ardhurat bruto	100
Minus: provizioni për borxhin e keq	(5)
Të ardhurat neto	95

kundrejt

Të ardhurat bruto	100
Kosto e shitjes	
Provizioni për borxhin e keq	(5)

Burimi: Materiale trajnimi nga Deloitte

Shpjegim teorik i metodës së shumës së lejuar për llogaritë që nuk kanë shpresë të arkëtohen

Çregjistrimi i llogarive të arkëtueshme

- Kompania nuk e di, në momentin e ofrimit të shërbimit dhe lëshimit të faturës, se cili klient nuk do të paguajë. Firma duhet, gjithsesi, të kontabilizojë shpenzimin e parashikuar të lidhur me portofolin e saj për llogari të arkëtueshme të veçanta. Për të bërë këtë, kompania krijon një llogari të veçantë, Provizionimi i të pa arkëtueshmeve, e cila është një kundër llogari e Llogarisë së Arkëtueshme, Bruto. Vlera Bruto minus provizionin jep Llogarinë e Arkëtueshme, Neto, e cila reflekton vlerën e parasë të cilën ajo parashikon të mbledhë.
- Kur një kompani vendos që një llogari e veçantë klienti është e pa arkëtueshme, ajo e heq këtë llogari duke debituar Provizionin e të Pa-arkëtueshmeve dhe duke kredituar Llogarinë e Arkëtueshme, Bruto. Ky proces është quajtur çregjistrim i llogarisë. p.sh., kompania e konsideron si të pa arkëtueshme çdo llogari klienti të pa paguar pas gjashtë muajve. Kjo do të thotë se në çdo periudhë kontabël, kompania konstaton se cila llogari ka mbetur e pa arkëtuar për gjashtë muaj, dhe i trajton këto llogari klientesh si të pambledhshme duke i çregjistruar ato.
- Çregjistrimi i llogarive të klientëve të veçantë duke përdorur metodën e shumës së lejuar nuk ndikon në pasqyren e të ardhurave. Efekti i të ardhurave ndodh në periudhën e shitjeve, atëherë kur firma regjistron Shpenzime për Borxhin e Keq. Çregjistrimi i llogarive të klientëve të veçantë nuk ndikon në Llogarinë e Arkëtueshme, Neto, sepse vlera e çregjistruar zbritet Llogarinë e Arkëtueshme, Bruto, dhe kundër llogarinë Provizionimi i të pa Arkëtueshmeve, ekzaktesisht me të njëjtën vlerë.
- Rezultati i Metodës së vlerës së lejuar raportohet në Llogarinë e Arkëtueshme, Neto, në bilancin kontabël me shumën të cilën firma pret të mbledhë paratë në periudhat e ardhshme.

Vlerësimi i shumës së Llogarisë së Pa-arkëtuar

Ne pershkruajmë më tej se si kompanitë bëjnë këtë vlerësim, dhe ilustruam dy metoda: metoda e përqindjes mbi shitjet dhe metodën e moshës së llogarisë së arkëtueshme. Me kalimin e kohës, përdorimi i saktë i të dyja metodave, do të japin të njëjtin rezultat të të ardhurave kumulative dhe totalit të aktiveve. Të dy standardet, GAAP i ShBA dhe SNRF, nuk u kërkojnë kompanive përdorimin e njëjës ose tjetrës prej metodave, nderkohë që disa firma përdorin të dyja metodat.

Shembull teorik

Politikat kontabël

- Provizionimi yne për llogaritë e dyshimta paraqet vlerësimin tonë më të mirë të humbjeve të trashëguara në llogarinë tonë të arkëtueshme sipas datës së bilancit kontabël.
- Ne vlerësojmë mbledhshmërinë e llogarive tona të arkëtueshme bazuar në disa faktorë, duke përfshirë trendin historik të moshës së llogarive, çregjistrimin e shpenzimeve dhe parashikimin e performancës në të ardhmen.
- Ne njohim pagesat financiare për llogaritë e pa shlyera deri në momentin e çregjistrimit të këtyre llogarive
- Llogaritë e pa shlyera çregjistrohen kur përcaktohet se ato janë të pa arkëtueshme, zakonisht pas kalimit të 180 ditëve pa marrë një pagesë të plotë sipas planifikimeve mujore. Çregjistrimi i llogarive kryhet më shpejt në rastet kur klienti falimenton ose situata të tjera të cilat e bëjnë të pa mundur në të ardhmen arkëtimin.

Burimi: Materiale trajnimi nga Deloitte

Shpjegim teorik i metodës së shumës së lejuar për llogaritë që nuk kanë shpresë të arkëtohen

Metoda e pasqyimit të Bilancit dhe Pasqyrës së të Ardhurave

- Janë dy metoda për përcaktimin e provizionit për vlerat e pa arkëtuara. Ato janë metoda e pasqyimit të Bilancit dhe Pasqyrës së të Ardhurave, të cilat janë shpjeguar në vijim.
- Ne shpjegojmë të dyja metodat për vlerësimin e shumës së pa arkëtuar; përlllogaritjet e veçanta dhe procedurat që variojnë ndërmjet firmave dhe modeleve të biznesit.

Procedura përqindja e shitjeve

Procedura e përqindjes mbi shitjet vjen si rrjedhojë e idesë se, vlerat e pa arkëtuara do të ndryshojnë me volumin e kreditimit të biznesit. Firma vlerëson përqindjen e përshtatshme duke studiuar eksperiencën e saj ose duke u bazuar në eksperiencën e firmave të ngjashme. Në ekonomite e zhvilluara norma e mospagimit luhet në nivelin e 1% deri 2% të shitjeve me pagesa të vonuara. Pasi firma kryen vlerësimin e vlerës së llogarive të pa arkëtuara të lidhur me shitjet me pagesa të vonuara për çdo periudhë, bën një regjistrim rregullues duke debituar Shpenzimet për Borxhin e Keq dhe duke kredituar Provizionin për llogaritë e pa arkëtueshme.

Procedura e moshës së Llogarive të Arkëtueshme

Procedura e moshës së llogarive të arkëtueshme përfshin dy hapa:

- Vlerësimi i vlerës të cilën firma nuk pret t'a mbledhi nga llogaritë e arkëtueshme, dhe
 - Rregullimi i gjëndjes së llogarisë Provizionit i të pa arkëtueshme në mënyrë që gjëndja në këtë llogari, pasi të netohet kundrejt llogarisë të të Arkëtueshmeve, bruto, të reflektojë vlerën në para që firma pret të mbledhi.
- Vlerësimi i shumës që klientët i detyrohen firmës dhe parashikohet si e pa arkëtueshme varet nga informacioni mbi moshën e llogarive të arkëtueshme (numri i ditëve për të cilat nuk janë arkëtuara).
 - Në teori, të dyja metodat do të japin të njejtin rezultat përlllogaritjeje të borxhit të keq

Shembull teorik

26 Llogaritë e arkëtueshme

Detajet e llogarive të arkëtueshme neto janë si me poshtë:

(ne milion EUR)	12.31.2010	12.31.2009
Llogaritë e arkëtueshme, bruto - duke përfshirë EDF Trading	17,786	17,918
Llogaritë e arkëtueshme, bruto - EDF Trading	2,375	2,401
Zhvlerësimi	(637)	(686)
Llogaritë e arkëtueshme, neto	19,524	19,633

Shumica e llogarive të arkëtueshme matura brenda një viti.

Konsolidimi i llogarive të arkëtueshme ndërmerr në mënyrë periodike, kryesisht nga Edison. Pjesa e EDF është rreth EUR 2,122 milion me 31 Dhjetor, 2010 (EUR 1,385 milion me 31 Dhjetor 2009). Meqë pjesa me më shumë e këtyre bashkimeve janë pa të drejtë rikursi, llogaritë e arkëtueshme respektive nuk mbarten në bilancin e konsoliduar të Grupit.

Risku i kreditit në lidhje me llogaritë e arkëtueshme tregohet me poshtë:

(ne milion EUR)	12.31.2010			12.31.2009		
	Vlerat bruto	Provizionet	Vlerat neto	Vlerat bruto	Provizionet	Vlerat neto
Llogaritë e Arkëtueshme	20,161	(637)	19,524	20,319	(686)	19,633
- me vonesë deri në 6 muaj	1,690	(182)	1,508	1,940	(225)	1,715
- me vonesë nga 6 në 12 muaj	365	(120)	245	319	(135)	184
- me vonesë me shumë se 12 muaj	584	(272)	312	428	(199)	229
Llogaritë e arkëtueshme me vonesë	2,639	(574)	2,065	2,687	(559)	2,128
Llogaritë e arkëtueshme brenda afatit	17,522	(63)	17,459	17,632	(127)	17,505

Burimi: Pasqyrat Financiare të konsoliduara më 31 dhjetor 2010 të EDF


Shpjegim teorik i metodës së shumës së lejuar për llogaritë që nuk kanë shpresë të arkëtohen

Krahasimi i metodës së Përqindjes mbi Shitjet dhe metodës së Moshës së llogarive të arkëtueshmeve

- Nën metodën e përqindjes mbi shitjet, firma vlerëson dhe njeh shpenzimin e borxhit e saj të keq; dhe nga ana tjetër kreditimi rrit gjendjen e Provizionit të të pa arkëtueshmeve.
- Nën metodën e moshës së të arkëtueshmeve, firma vlerëson balancën përfundimtare në llogarinë e Provizionit të të pa arkëtueshmeve, dhe kryen një regjistrim kreditues në menyre që të sjelli balancen në atë vlerë; dhe nga ana tjetër debiton Shpenzimet për Borxhin e Keq.
- Nëse përqindja e përdorur nën metodën e përqindjes mbi shitjet paraqet në mënyre të pranueshme ekperiencën e arkëtimit, në fund të periudhës balanca në llogarinë e provizionimit duhet të jetë e përafërt pas përdorimit të të dyja metodave.

Shembull teorik- Metoda e Përqindjes mbi Shitjet

$$\frac{\text{Vlerat e pa arkëtuara}}{\text{Shitjet}} = \text{p.sh. } 14\%$$



Arkëtimi total	172
Shitjet totale	200
Të pa arkëtuara	28 (14%)

Shëmbull teorik- Metoda e Moshës së të arkëtueshmeve

Metoda e bilancit

Klasifikimi i llogarive	LI.A bruto	%	Vlerësimi për shumën e pa-arkëtuar
Brenda afatit	40,000	8%	3,200
1-30 ditë	21,000	20%	4,200
31-60 ditë	19,000	40%	7,600
61-180 ditë	12,000	60%	7,200
më shumë se 180 ditë	11,000	100%	11,000
	103,000		33,200

Çregjistrimet në periudhën aktuale	500
Shitjet në periudhën aktuale	100,000

Teprica hapëse provigjionit	19,500
Minus: çregjistrimet	-500
Minus: arkëtimi i LI.A të provizionuara	-100
Plus: provizione të reja	14,300
Teprica mbyllëse e provizionit	33,200

Periudha e mëparshme

Klasifikimi i llogarive	LI.A bruto	%	Vlerësimi për shumën e pa-arkëtuar
Brenda afatit	40,000	8%	3,200
1-30 ditë	15,000	20%	3,000
31-60 ditë	12,000	40%	4,800
61-180 ditë	10,000	60%	6,000
më shumë se 180 ditë	2,500	100%	2,500
	79,500		19,500

Shpenzimi për vitin	13,700
% mbi shitjet	14%


Burimi: Materiale trajnimi nga Deloitte

Shpjegim teorik i metodës së shumës së lejuar për llogaritë që nuk kanë shpresë të arkëtohen

Sjellja ndaj ndryshimeve të vlerës së llogarive të pa arketuara

- Ndryshimet në kushtet ekonomike, ndryshimet në politikat e dhënies së kredisë, ndryshimet në përpjekjet për mbledhjen e arkëtimit, dhe faktorë të tjerë të ngjashëm sjellin ndryshime ndërmjet parashikimeve dhe gjendjes aktuale të shumave të pa arkëtuara. Këto diferencat kërkojnë rishikimin e parashikimeve gjatë çdo periudhe kontabël për të reflektuar azhurnimin e informacionit. Te dyja standardet GAAP i ShBA dhe SNRF, kërkojnë që firmat të reflektojnë çdo ndryshim të parashikimeve në mënyrë progresive. Kjo do të thotë, që firmat nuk bëjnë rregullime prapavepruese në pasqyrat e të ardhurave dhe bilancin e periudhave të mëparshme për të reflektuar diferencat ndërmjet parashikimeve dhe gjendjes aktuale të llogarive të arkëtueshme. Përkundrazi, firma rregullon balancën në Provizionin e të pa arkëtueshme duke shkuar përpara. Rregullimi për ndryshimet në parashikime kryhet normalisht nën metodën e moshës së të arkëtueshmeve, kjo për shkak se kjo metodë parashikon në fillim gjendjen përfundimtare në llogarinë e Provizionimit të të pa arkëtueshmeve dhe më pas bazuar mbi këtë shumë për llogarit vlerën e Shpenzimit të Borxhit të Keq.
- Aplikimi i ndryshimeve të mundshme në rezultatet e parashikuara nga pikëpamja e parashikimeve janë një përbërës i rëndësishëm i kontabilitetit sipas metodës së të drejtës së konstatuar. Nëse firma kryen rregullime të njëpasnjëshme të parashikimeve për diferencat ndërmjet të dhënave të parashikuara dhe atyre aktuale, ato do të jenë periodike dhe të vogla, kjo në mungesë të ndryshimeve të papritura dhe të rëndësishme të kushteve ekonomike. Rregullimet prapavepruese të vlerave të raportuara në periudhat e mëparshme, për shkak të diferencave ndërmjet vlerave të parashikuara dhe atyre aktuale do të çojnë në një ndryshim të vazhdueshëm të pasqyrave financiare të periudhave të mëparshme, duke sjellë në ngatërrimin e përdoruesve të këtyre pasqyrave financiare dhe ulur besueshmerinë e tyre..
- Shumat e parashikuara si të pa arkëtueshme ka shumë mundësi të ndryshojnë nga vlerat aktuale. Firmat kryejnë korrigjimin e parashikimeve të tyre në çdo periudhë nën ndikimin e informacioneve të reja dhe rregullimeve të mundshme të pasqyrave financiare. Parashikimet e korrigjuara mund të rrisin ose ulin vlerën e Shpenzimit të Borxhit të Keq, dhe në disa raste firmat mund të kreditojnë Shpenzimet e Borxhit të Keq i cili anulon shpenzimet e njohura më parë

Zhvillimi në kohë i arkëtimit të parasë



Burimi: Materiale trajnimi nga Deloitte

Deklarata Rregullatore dhe Manuali i Kontabilitetit formojnë kuadrin kryesor rregullator në lidhje me Studimin e Borxhit të Keq

Panoramë e dokumentave rregullatore dhe dokumentave të tjerë të përshtatshme

Ne cilësuam dokumentat e mëposhtëm si më të rëndësishmit për përgatitjen e Studimit të Borxhit të Keq :

- Marrëveshja e Blerjes së Aksioneve arritur mes METE dhe CEZ;
- Deklarata Rregullatore;
- Manuali i Kontabilitetit;
- Metodologjia e llogaritjes së tarifave për operatorin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike;
- Metodologjia e llogaritjes së tarifave të shitjes me pakicë për klientet tariforë (për Furnizuesin Publik me Pakicë);
- Ligji mbi sektorin e energjisë elektrike;
- Modeli Shqiptar i Tregut;
- Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike;
- Kodi i funksionimit të shpërndarjes;
- Marrëveshja për Pjesëmarrje në Treg;
- Kodi i matjes;
- Licenca për shpërndarjen e energjisë elektrike;
- Marrëdhëniet kontraktuale për furnizimin me energji elektrike;
- Kontratat e furnizimit me energji për klientët tariforë familjarë dhe jo-familjarë;

Në lidhje me këtë ne konsultuam kornizën rregullatore me CEZ Shpërndarje dhe ndoqëm udhëzimin e ERE siç është përcaktuar në letrën nga Bordi i Komisionerëve me subjekt “ Prezantimi i 13 prill mbi Borxhin e Keq nga CEZ Shpërndarje / Deloitte“, letër qe daton 22 prill 2011, pika 4.

- Borxhi i keq ishte përmendur në menyre specifike në dokumentat e mëposhtëm:
 - Deklarata Rregullatore
 - Manuali i Kontabilitetit

Deklarata Rregullatore dhe Manuali i Kontabilitetit formojnë kuadrin kryesor rregullator në lidhje me Studimin e Borxhit të Keq

Citime të përgjithshme nga Deklarata Rregullatore

Qëllimi i përgjithshëm i Deklaratës Rregullatore (Neni 1.1)

- „Miratimi i kësaj deklarate rregullatore synon të mundësojë llogaritjen e tarifave të prodhimit publik të zotëruar nga shteti, të furnizimit me shumicë, të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike në përputhje me metodologjitë përkatëse të miratuara nga ERE.“

Periudhat e Rregullimit (Neni 1.2)

- „ERE ka vendosur që periudha 1 janar 2009 - 31 dhjetor 2009 të jetë një periudhë tranzitore gjatë së cilës nuk do të ketë ndryshim në tarifën ekzistuese, të përcaktuara me Vendimin e saj Nr.21, datë 14 shkurt 2008. Në këtë mënyrë do t'i jepet mundësia investitorit të vlerësojë situatën brenda OSSH dhe të përgatisë aplikimin për rishikimin e këtyre tarifave të reja jo më vonë se 30 shtator 2009. Tarifat e reja do të jenë efektive duke filluar nga data 01 janar 2010.
 - Periudha e parë e rregullimit do të jetë 1 janar – 31 dhjetor 2010;
 - Periudha e dytë e rregullimit do të jetë 1 janar - 31 dhjetor 2011;
 - Periudha e tretë e rregullimit do të jetë 1 janar 2012 – 31 dhjetor 2014..

Periudhat vijuese të rregullimit do të jenë nga 3 deri në 5 vjet.“

Miratimi i Deklaratave Rregullatore vijuese (Neni 1.4)

- „Jo më vonë se 30 qershor 2014, ERE do të miratojë një Deklaratë Rregullatore për periudhat e rregullimit që vijnë pas vitit 2014, e cila nuk do të ndryshojë ndjeshëm në metodologji nga kjo Deklaratë Rregullatore. Për të menjanuar çdo dyshim, Deklarata Rregullatore e re do të vazhdojë të përmbajë Mekanizmin e Kompensimit,“ ashtu si përshkruhet në Nenin 6 të Deklaratës Rregullatore“

Citime nga Deklarata Rregullatore në lidhje me Borxhin e Keq

- „ERE është e vetëdijshme se një nivel i caktuar i borxhit të keq është pjesë e pandarë e biznesit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike dhe si e tillë duhet reflektuar në tarifa.“
- Deklarata Rregullatore thotë që: „Borxhi i Keq i Lejuar do të llogaritet si një përqindje mbi shumën e të ardhurave totale të OSSH në funksionin e saj si FPP përfshirë të gjithë përberësit e tarifave të FPSH (përfshirë atë të prodhimit), të OST, DSO, PSO, FPP dhe pagesa të tjera sipas rastit duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar („Te Ardhurat e FPP“).“
- Objektivat për nivelin e Borxhit të Keq
 - „Për vendosjen e objektivave për uljen e Borxhit të Keq përgjatë periudhave të rregullimit, do të pranohet për vitin 2008 një nivel i Borxhit të Keq prej 14 % mbi të Ardhurat e FPP“.
 - „Për 2009 pranohet i njëjti nivel i Borxhit të Keq me atë të vitit 2008 (si % ndaj të Ardhurave të FPP). Në 2010, niveli i Borxhit të Keq (si % ndaj të Ardhurave të FPP) do të ulet me 1 pikë përqindje krahasuar me nivelin e vitit 2009.“
 - „Gjithashtu, niveli aktual i Borxhit të Keq për vitin 2010 do të shërbejë si një nivel fillestar për programin në vazhdim të uljes së tij sipas përshkrimit më poshtë në rast se ai nuk është më i lartë se niveli aktual i borxhit të keq të vitit 2009, përndryshe do të përdoret borxhi i keq aktual i vitit 2009, 1% (pikë përqindje) ulje për vitin 2011; 1% (pikë përqindje) ulje për vitin 2012; 1% (pikë përqindje) ulje për vitin 2013; 1% (pikë përqindje) ulje për vitin 2014“
 - „Në rast se Niveli Aktual i Borxhit të Keq për 2009 dhe/apo 2010 dhe/apo 2014 është përkatësisht më i lartë se 14 % dhe /apo 13% dhe/apo 12%, diferenca do të shtohet në shumën e të ardhurave për t'u kompensuar sipas Nenit 6.“
 - Në rast se Niveli Aktual i Borxhit të Keq për 2009 dhe/apo 2010 dhe/apo 2011 është përkatësisht më i ulët se 14 % dhe /apo 13% dhe/apo 12%, diferenca do t'i zbritet shumës së të ardhurave për t'u kompensuar sipas Nenit 6.

Deklarata Rregullore dhe Manuali i Kontabilitetit formojnë kuadrin kryesor rregullator në lidhje me Studimin e Borxhit të Keq

Citime të përgjithshme të përzgjedhura nga Manuali i Kontabilitetit

- “Sistemi Uniform i Llogarive” për Kompanitë e e licensuara është hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 21 ,23 të Ligjit Nr.9072, datë 23.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, si dhe kërkesave të Standarteve Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit.”
- “Sistemi Uniform i Llogarive i zhvilluar nga ERE do të ofrojë rregullat për mbajtjen e llogarive të ndara nga kompanitë e licensuara në sektorin e energjisë elektrike, përfshirë llogaritë e aktiveve, kapitalit, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, për qëllim të llogaritjes së çmimeve dhe tarifave, sipas metodologjive përkatëse, si dhe për qëllime të monitorimit të veprimtarisë së tyre”.
- „Sistemi i kontabilitetit i specifikuar në Sistemin Uniform të Llogarive do të jetë i zbatueshëm për të gjitha Shoqëritë e licensuara të sektorit të energjisë elektrike, të cilat janë të detyruara të plotësojnë kërkesat rregullore për mbajtjen e llogarive në përputhje me Ligjin e sipërcituar të Sektorit të Energjisë Elektrike.“.

Citime nga Manuali i Kontabilitetit në lidhje me Borxhin e Keq

Kategoritë dhe struktura e Kërkesave për Arkëtim

- Kërkesat për arkëtim ndaj klientëve do të raportohen me vlerën e faturës, nga e cila është zbritur një provizion për zhvlerësim. Provizioni për zhvlerësim do të llogaritet nëse ka një farë sigurie që kompania nuk do të jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë sasinë sipas kushteve fillestare në lidhje me vlerësimin respektiv. Humbja nga zhvlerësimi është shuma me të cilën vlera e mbartur tejkalon vlerën e rikuperueshme që perfaqëson vlerën aktuale të flukseve të parasë, e skontuar me një normë interesi tregu e aplikueshme për klientë të ngjashëm.

Llogaritë e pambledhshme “Borxhi i keq”(Neni 8.1)

- „ Përkufizimi i llogarive të pambledhshme: „Llogaritë e pambledhshme do të trajtohen si shpenzime të shitjes me kredi. Arsyeja për këtë është se dhënia e kredive konsiderohet një ngjarje që rrit shitjet dhe të ardhurat. Kompanitë janë shpesh të gatshme të pësojnë humbje nga debitorët e këqinj që do të rezultojë i pa-arkëtueshem nëse efekti neto për biznesin është rritja e shitjeve dhe fitimeve. Nga ana tjetër të licensuarit në përgjithësi “detyrohen” të shesin me kredi për shkak të karakterit teknik të operacionit, prandaj ato i konsiderojnë “Llogaritë e pambledhshme” si kosto të nevojshme.“
- „ Regjistrimi i shpenzimeve për borxhin e keq kërkon që shpenzimet për borxhin e keq të raportohen për periudhën kontabël në të cilën është realizuar shitja me pagesa të vonuara..“
- „ Metoda e përdorur për të regjistruar shpenzime nga “Borxhi i keq” quhet “metoda e shumës së lejuar” për kontabilizimin e borxhit të keq”. Përveç se kënaq kërkesat e parimit të së drejtës së konstatuar, kjo metodë, e cila përfshin një vlerësim të borxhit të keq, siguron gjithashtu që kërkesat për arkëtim të raportohen në pasqyrën e bilancit me vlerën e tyre neto të realizueshme. Pra regjistrimi dhe raportimi i borxhit të keq mund të konsiderohet si një llogari e kundërt rregulluese e llogarive të arkëtueshme. .“

Deklarata Rregullatore dhe Manuali i Kontabilitetit formojnë kuadrin kryesor rregullator në lidhje me Studimin e Borxhit të Keq

Citime nga Manuali i Kontabilitetit në lidhje me Borxhin e Keq (vazhdim)

Regjistrimi/kontabilizimi i “borxhit të keq”(Neni 8.2)

- *Provizionimi i llogarive të arkëtueshme sipas “metodës së shumës së lejuar” përfshin një llogari të kundërt rregulluese në aktive të quajtur “Zbritje nga llogaria e arkëtueshme (Shitje)”. Regjistrimi kryhet me një debitim të llogarisë “Shpenzime Borxhi i Keq” dhe me kreditim të llogarisë “Zbritje nga llogari të arkëtueshme (Shitje)” Duhet shënuar që llogaria e kundërt rregulluese “Zbritje nga llogari të arkëtueshme(Shitje)” përdoret jo vetëm sepse është gjithnjë mirë të evidentohet shuma neto e llogarive të arkëtueshme, por gjithashtu edhe se në kohën e regjistrimit të rregullimit nuk specifikohen llogaritë dhe sasinë e papaguara të klientëve të veçantë Si rezultat, llogaritë e klientëve të veçantë nuk mund të hiqen nga llogaritë e arkëtueshme në librin e llogarive të arkëtueshme, dhe llogaria kontrolluese për llogaritë e arkëtueshme në librin e përgjithshëm të llogarive(balanca e së cilës tregon shumën totale të llogarive të arkëtueshme në librin e llogarive të arkëtueshme) nuk mund të kreditohet me totalin e borxhit të keq. Në vend të saj kreditohet llogaria “Zbritje nga Llogari të Arkëtueshme(Shitje)”. Balanca kreditore e kësaj llogarie ka efektin e zvogëlimit të llogarisë “Llogari të Arkëtueshme(Shitje)” në vlerën e përlllogaritur neto të realizueshme të tyre.*

Identifikimi dhe çregjistrimi i një llogarie të veçantë nga Llogaritë e Arkëtueshme nga Shitjet (Neni 8.3)

- *„Kur llogaria e arkëtueshme (shitje) e një klienti të veçantë identifikohet si e pa-arkëtueshme ajo kreditohet përkundrajt debitimit të llogarisë “Zbritje nga llogari të arkëtueshme(shitje)”. Kreditimi i llogarisë “Llogari të arkëtueshme(shitje)” të klientit të veçantë, menjanon sasinë e borxhit të keq (çregjistron llogarinë) nga Libri i Llogarive të Arkëtueshme (Ditari i Shitjes), e si pasojë e çregjistron atë nga llogaritë kontrolluese të Librit të Madh. Fazat e këtyre regjistrimeve janë: Së pari, megjithëse çregjistrimi i llogarisë së një klienti të caktuar trajtohet si një shpenzim, është “zbritje nga llogari të arkëtueshme (shitje)” që debitohet. Kjo për arsye se shpenzimi i llogaritur i borxhit të keq ishte regjistruar fillimisht si një shpenzim nga rregullimi i llogarive të arkëtueshme në fund të periudhës në të cilën ato ndodhen. Se dyti, megjithëse çregjistrimi eliminon sasinë e llogarive të arkëtueshme nga Librat e Llogarive, ai nuk ndryshon sasinë e vlerës neto të realizueshme nga Llogaritë e Arkëtueshme (sepse “Zbritje nga Llogari të Arkëtueshme(shitje)” reduktohet për të njëjtën shumë) “*
- *„Zbritja nga Llogari të Arkëtueshme(shitje)” reduktohet me të njëjtën shumë). Në rastet kur kompania e licensuar mbledh një shumë që më përpara ishte çregjistruar, ajo duhet të bëjë dy hyrje kontabël. E para do të jetë e kundërt me çregjistrimin e shpjeguar më lart dhe që rikthen në pozitën e mëparshme llogarinë e klientit. E dyta do të regjistrojë arkëtimin në llogarinë e rikthyer. “*

Deklarata Rregullatore dhe Manuali i Kontabilitetit formojnë kuadrin kryesor rregullator në lidhje me Studimin e Borxhit të Keq

Citime nga Manuali i Kontabilitetit në lidhje me Borxhin e Keq (vazhdim)

Përlllogaritja e Borxhit të Keq (Neni 8.4)

- „Metoda e Pasqyrës së të Ardhurave (Përqindja e shitjeve)
 - Metoda pranon si të vërtetë faktin që ka një marrëdhënie të rregullt midis shitjeve të periudhave të mëparshme dhe sasisë së borxhit të keq. Kjo marrëdhënie konvertohet në një përqindje dhe përdoret për të përcaktuar shpenzimet për borxhin e keq të vitit.”
- **Metoda e pasqyrimit të Bilancit (Përqindja mbi llogaritë e arkëtueshme**
 - „ Kjo metodë pranon si të vërtetë faktin që ka një marrëdhënie të qëndrueshme midis vjetërsisë së llogarive të arkëtueshme të jashtëzakonshme dhe borxhit të keq. Kjo marrëdhënie konvertohet në një seri përqindjesh për grupe të ndryshme vjetërsie (30, 60, 90 dhe 180-ditë), dhe përdoret për të përcaktuar shpenzimin për borxhin e keq të periudhës si shumë e shumave të pa-arkëtuara, që llogariten duke përdorur këto përqindje. Përqindja për secilin grup do të bazohet mbi informacionin statistikor. Në përgjithësi përqindja e shumave të kërkesave të pa-arkëtuara rritet me vjetërsinë e kërkesave për arkëtim
 - Kjo metodë përdoret gjerësisht dhe konsiderohet si më e saktë. Duhet të vihet në dukje, megjithatë, se ajo cënon parimin e të ardhurave të konstatuara, prandaj nuk rekomandohet për raportime/pasqyra mujore dhe tremujore. “
- „ Kompania e licensuar duhet të tregojë në menyrë të qartë se çfarë metode ka përdorur për regjistrimin e borxhit të keq në llogari. ERE mund t'i kërkojë kompanisë që të përdorë metodë tjetër të ndryshme për llogaritjen e borxhit të keq.“

Manuali i Kontabilitetit dhe SNK/SNRF

Ekstrakte nga SNK/SNRF

Brenda SNK/SNRF, të cilave u referohet manuali i kontabilitetit, ka dy pjesë që mund të konsiderohen për përcaktimin e përkufizimit të Borxhit të Keq. SNRF përdor këto terma:

- Zvogëlim në përfitimet ekonomike – shiko citimin nga “Kuadri për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare.”
- “vlera e rikuperueshme” – shiko citimin nga SNK 36.

Kuadri për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare

„(85) Koncepti i mundësisë përdoret në kriteret e njohjes për t’ju referuar shkallës së pasigurisë që përfitimet ekonomike në të ardhmen që shoqërojnë elementin do të rrjedhin tek ose nga njësia ekonomike. Koncepti i përmbahet pasigurisë që karakterizon mjedisin në të cilin vepron një njësi ekonomike. Vlerësimet e shkallës së pasigurisë që i bashkëngjiten rrjedhjes së përfitimeve ekonomike në të ardhmen bëhen mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën kur përgatiten pasqyrat financiare. Për shembull, kur është e mundur që një llogari e arkëtueshme e zotëruar nga njësia ekonomike do të paguhet, atëherë është e justifikuar, në mungesë të ndonjë evidence kundërshtuese, të njihet llogaria e arkëtueshme si aktiv. Megjithatë, për një popullatë të madhe llogarish të arkëtueshme, një farë shkalle për mos-pagesë normalisht konsiderohet e mundur; kështu që njihet një shpenzim që paraqet uljen e pritshme të përfitimeve ekonomike.“

SNK 36

„(9) Një njësi ekonomike duhet të vlerësojë në çdo datë raportimi nëse ka apo jo ndonjë indikacion që ndonjë aktiv të jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston një indikacion i tillë, atëherë njësia ekonomike duhet të çmojë shumën e rikuperueshme të aktivit.“

Nën-seksionet	Faqe
Komentet ndaj prezantimit Deloitte të mbajtur më 13 prill 2011	51
Komentet ndaj prezantimit Deloitte të mbajtur më 6 maj 2011	53
Komentet ndaj prezantimit Deloitte të mbajtur më 23 qershor 2011	57

Përgjigje ndaj komenteve të ERE në lidhje me prezantimin për Studimin mbi Borxhin e Keq, mbajtur më 13 prill 2011

Komentet e dhëna nga ERE në letrën me datë 22 prill:

1. „Në vlerësimin e ERE ende nuk është arritur në një përkufizim të qartë dhe të pranueshëm për Borxhin e Keq i cili është parësor në strukturimin dhe kryerjen e të gjithë studimit. ERE pret që Metodologjia të ketë një trajtim të detajuar teorik të fenomenit dhe mënyrat e trajtimit të tij për rrethanat specifike.“

Deloitte: Për më shumë informacion shihni seksionin „Metodologjia dhe korniza teorike“

2. „ERE gjen gjithashtu si shumë të rëndësishëm vlerësimin e nivelit të saktësisë së të dhënave bazë (input data) dhe të sistemit IT që është aktualisht në funksionim mbi të cilat do të ndërtohet analiza dhe që do të kushtëzojë saktësinë dhe besueshmërinë e rezultateve përfundimtare të studimit.“

Deloitte: Për më shumë informacion shihni seksionin „Informacioni i përdorur dhe analizat e bëra për cilësinë e të dhënave “

3. „Referuar progresit të deritanishëm (slide 3/Action steps performed) kompania Deloitte ka kryer tashme “analizën e sistemit të faturimit” dhe “analizën e dokumentave rregullatorë e dokumentave të tjera ligjore dhe lidhjen e tyre me Borxhin e Keq” (të përfunduara në javën e parë të Prillit). Në bazë të sa më sipër ERE do të ishte e interesuar të njihet me konkluzionet paraprake që janë arritur prej çështjeve të trajtuara.“

4. „Për sa lidhet me pikën 3 të grafikut të Aktiviteteve të Kryera të Slide nr 3 dhe shpjegimeve shtese të dhëna në slide nr 5 do të sillnim në vëmendjen tuaj që në lidhje me Borxhin e Keq nuk duhet të përqendroheni vetëm në Deklaratën Rregullatore dhe Manualin e llogarive rregullatore , por është shumë e rëndësishme që përveç tyre të analizohen në thellësi dhe aktet e tjera rregullatore që janë në fuqi (p.sh kontratat e furnizimit me energji për klientët tariforë familjare dhe jo familjare të cilat përcaktojnë obligime për Palët Kontraktuale në lidhje me furnizimin, arkëtimin, zgjatjet kohore deri në ndërprerjen në rast mospagese, etj.) dhe kanë impakt të drejtpërdrejtë në vlerësimin e Borxhit të Keq.“

Deloitte: Për më shumë informacion shihni seksionin „Metodologjia dhe korniza teorike“

5. „Për sa lidhet me takimet e parashikuara për tu kryer prej Deloitte me të gjitha hallkat operative (slide 3) dhe analizën paraqitur prej diagramës së “Procesit të Faturimit dhe Arkëtimit” (slide4/komponentja “Monitorimi dhe menaxhimi i Arkëtimit për Vonesa”) gjejmë shumë të rëndësishme që në këtë proces të përfshihet dhe pasqyrohet analiza e të gjitha procedurave dhe hapave konkrete për të verifikuar nëse Kompania ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme (administrative, ligjore, etj) për arkëtimin e debitorëve të energjisë.“

Deloitte: Për më shumë informacion shihni seksionin Shtojca 3 „Panoramikë e sistemit të faturimit, arkëtimit dhe kontabilitetit“

Përgjigje ndaj komenteve të ERE në lidhje me prezantimin për Studimin mbi Borxhin e Keq, mbajtur më 13 prill 2011

6. „Gjejmë të nevojshme që nën “ çështjet sqaruese” (slide 8) të shpjegohet më konkretisht marrëdhënia e secilit element të listuar me Borxhin e Keq, dhe në rast se një marrëdhënie e tillë vërtetohet, atëherë cila është mënyra me të cilën do të llogaritet ndikimi i elementit përkatës në Borxhin e Keq (qoftë kjo edhe paraprahe).“

Deloitte: Për më shumë informacion shihni seksionin „Informacioni I përdorur dhe analizat e bëra për cilësinë e të dhënave “

7. „ERE gjen të nevojshme një shpjegim të detajuar të të dyja metodave të propozuara; asaj të Pasqyrës së të Ardhurave dhe metodës së Pasqyrës së Bilancit.“

Deloitte: Për më shumë informacion shihni seksionet „ Metodologjia dhe korniza teorike“ dhe „Metodologjia e Propozuar e llogaritjes së borxhit të keq “

8. „Në Slide nr 11 (Qasja paraprahe e propozuar 3/3) për vitin 2009 përmendet “Kombinimi i metodës së Pasqyrës së të Ardhurave dhe Pasqyrës së Bilancit” A nënkupton kjo kryerjen e të dyja metodave apo ndonjë kombinacion tjetër? Po në Slide 11 për vitin 2010 propozohet vetëm Metoda e Pasqyrës së Bilancit. Perse nuk është përmendur edhe Metoda e Pasqyrës së të Ardhurave?“

Deloitte: Për më shumë informacion shihni seksionin „Llogaritja e nivelit aktual të borxheve të këqia“

9. Në slide 12 në lidhje me takimin e radhës ju keni listuar si qëllim të tij përpilimin e metodologjisë. A nënkupton kjo diskutime apo do të kemi një dokument të parë dhe të shtjelluar të metodologjisë që Deloitte ka konturuar tashmë për trajtimin e Borxhit të Keq të cilin do të luteshim ta kishim në dispozicion paraprahe?„

Deloitte: Dokumentet për diskutime / prezantime në takimet me ERE iu dorëzuan ERE paraprahe

Përgjigje ndaj komenteve të ERE në lidhje me prezantimin për Studimin mbi Borxhin e Keq, mbajtur më 6 maj 2011

Siç është përmendur në letrën tuaj:

“ERE e gjen të arsyeshme dhe të domosdoshme marrjen në konsideratë edhe të Standartit ISA 250 “Marrja në Konsideratë e Ligjeve dhe Rregullave në një Audit të Pasqyrave Financiare”

Ne kuptojmë që ju i referoheni ISA 200 që i kërkon auditorit të konsiderojë ISA 250 që thotë:

“Efektet e ligjeve dhe rregulloreve – 2. Efekti mbi pasqyrat financiare të ligjeve dhe rregulloreve ndryshon në mënyrë të konsiderueshme. Këto ligje dhe rregullore ndaj të cilave entiteti është subjekt përbëjnë kuadrin ligjor dhe rregullator. Kërkesat e disa ligjeve apo rregulloreve kanë një efekt direkt mbi pasqyrat financiare sepse përcaktojnë shumën e raportuara si dhe paraqitjet në pasqyrat financiare të entitetit. Ligje apo rregullore të tjera duhet të ndiqen nga drejtuesit ose përcaktojnë kërkesat nën të cilat biznesi do kryejë aktivitetin e tij, por nuk kanë një efekt direkt në pasqyrat financiare të entitetit. Disa entitete operojnë në industri shumë të rregulluara (si bankat apo kompanitë kimike). Të tjera janë subjekt të shume ligjeve apo rregulloreve që i referohen në mënyrë të përgjithshme aspekteve operative të një biznesi (si ato që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe mundësitë e barabarta të punësimit). Mos-përmbushja e këtyre ligjeve apo rregulloreve mund të rezultojë në gjopa, procedime ligjore ose pasoja të tjera për entitetin që mund të kenë një efekt material në pasqyrat financiare.

Megjithëse ne nuk po bëjmë një auditim ne i respektojmë plotësisht nenet e ISA 250. Siç është kërkuar nga ERE, ne kemi konsideruar kuadrin rregullator në fuqi (shih faqen 13 të prezantimit për ERE datë 6 Maj, 2011). Ne lexuam të gjithë dokumentat rregullatorë relevantë që vendosin detyrime mbi CEZ Shperndarje dhe/ose i referohen përkufizimit të borxhit të keq. Gjatë kryerjes së detyrës tonë ne nuk detektuam ndonjë mos-respektim të CEZ Shperndarje me kërkesat e ISA 200, 250.

Përgjigje ndaj komenteve të ERE në lidhje me prezantimin për Studimin mbi Borxhin e Keq, mbajtur më 6 maj 2011

Siç është përmendur në letrën tuaj :

“Për sa me sipër, do te sillnim në vëmendjen tuaj, që në lidhje me Borxhin e Keq krahas Deklaratës Rregullatore dhe Manualit te Llogarive Rregullatore , (i cili nuk ka ende përkufizim për Borxhin e Keq) është shume e rëndësishme qe te merren në konsiderate dhe analizohen në thellësi dhe aktet e tjera rregullatore qe janë ne fuqi, ne veçanti Kontrata e Furnizimit me energji elektrike për Klientët Tarifore, e cila vendos detyrime për të dyja palët kontraktuale ne lidhje me furnizimin, faturimin, arkëtimin, penalitetet si dhe masa te tjera deri ne ndërprerjen e furnizimit.”

Ne konsideruam të gjithë detyrimet dhe të drejtat që CEZ Shperndarje ka, të cilat janë përmendur në letrën tuaj, si ndërprerja e furnizimit me energji elektrike (të cilën ne e konsiderojmë një të drejtë, jo një detyrim) dhe penalitetet e mundshme.

Në llogaritjen e propozuar të borxhit të keq, ne konsiderojmë të gjitha detyrimet e CEZ Shperndarje. Ne gjithashtu vlerësojmë që CEZ Shperndarje ka dhe disa të drejta. Sipas fushës së studimit mbi borxhin e keq që do kryhet nga një ekspert financiar i pavarur, siç është përkufizuar nga Deklarata Rregullatore ne bëjmë vetëm llogaritjen e borxhit të keq, prandaj është jashtë fushës së procedurave tona që të vlerësojmë masat që drejtuesit e CEZ Shperndarje vendosën të ndjekin për të evituar borxhin e keq potencial. Kjo reflektohet dhe ne deklaratën rregullatore që parashikon përgjegjësinë e CEZ Shperndarje për të përmirësuar gjatë kohës proceset që identifikojnë dhe parandalojnë mundësinë e krijimit të borxhit të keq (shih më poshtë ekstraktin nga Deklarata Rregullatore). Prandaj, ne konsiderojmë llogari të arkëtueshme që janë krijuar gjatë kryerjes normale të aktivitetit të CEZ shperndarje dhe llogarisim se çfarë pjese e tyre nuk do arkëtohet, që do të thotë, do të përfundojë si borxh i keq.

Deri me 31 Korrik 2011, OSSH, ne funksion te veprimtarise se shitjes me pakice qe ajo kryen, do te kryejë nje studim te detajuar per Borxhin e Keq ("Studimi mbi Borxhin e Keq") per te percaktuar (i) metodologjine e llogaritjes se Borxhit te Keq dhe (ii) Nivelet Aktuale te Borxhit te Keq per 2008, 2009 dhe 2010 („Nivelet Aktuale

te Borxhit te keq per vitet 2008, 2009 dhe 2010"). Studimi mbi Borxhin e Keq do te pergatitet nga nje ekspert financiar i pavarur i zgjedhur nga lista e meposhtme:

- Deloitte
- Ernst & Young
- KPMG
- PricewaterhouseCoopers

Studimi mbi Borxhin e Keq do te miratohet nga ERE Brenda 2 muajve nga paraqitja e tij.

Gjithashtu, niveli aktual i Borxhit te Keq per vitin 2010 do te shërbeje si nje nivel fillestar per programin ne vazhdim te uljes se tij sipas pershkrimit me poshte ne rast se ai nuk eshte me i larte se niveli aktual i borxhit te keq te vitit 2009, perndryshe do te perdoret borxhi i keq aktual i vitit 2009.

1% (pike perqindje) ulje per vitin 2011;

1% (pike perqindje) ulje per vitin 2012;

1% (pike perqindje) ulje per vitin 2013.

1% (pike perqindje) ulje per vitin 2014.

Përgjigje ndaj komenteve të ERE në lidhje me prezantimin për Studimin mbi Borxhin e Keq, mbajtur më 6 maj 2011

Siç është përmendur në letrën tuaj :

“Referuar këtij Manuali, pika 8.1, sikurse përmendur edhe ne faqen 32 të studimit, përcaktohet se: Llogaritë e Pambledhshme do të trajtohen si shpenzime te shitjes me kredi. Arsyeja për këtë është se dhënia e kredive konsiderohet një ngjarje që rrit shitjet dhe te ardhurat. Kompanitë janë shpesh te gatshme te pësojnë humbje nga debitorët e keqinjtë që do të rezultojnë te pa-arketueshem nëse efekti neto për biznesin është rritja e shitjeve dhe fitimeve.

Sidoqoftë ne do të donim të theksonim që paragrafi në Manualin e Llogarive vazhdon:

“Nga ana tjetër te licensuarit ne pergjithesi “detyrohen” të shesin me kredi për shkak të karakterit teknik të operacionit, prandaj ato i konsiderojnë “Llogaritë e pambledhshme” si kosto te nevojshme.”

Manuali i kontabilitetit parashikon që kompania është e detyruar të shesë me kredi për shkak të karakterit teknik të operacioneve dhe llogaritë e pambledhshme janë një shpenzim i nevojshëm. Ne i konsiderojmë shitjet me kredi si një praktikë e zakonshme në shpërndarjen e energjisë, që është ndjekur dhe po ndiqet nga Kompania. Sidoqoftë, siç është përmendur më sipër, politika e kredisë është vetëm vendim i manaxhimit që është jashtë fushës së studimit mbi borxhin e keq siç është përkufizuar nga Deklarata Rregullatore dhe jashtë fushës së punës tonë në përcaktimin e nivelit të borxhit të keq. Në lidhje me këtë ne besojmë që vlerësimi i çfarëdo efekti potencial ose llogaritje skenarësh nuk përbën pjesë të fushës dhe nuk është relevant për studimin mbi borxhin e keq që do kryhet nga një ekspert financiar i pavarur.

Përgjigje ndaj komenteve të ERE në lidhje me prezantimin për Studimin mbi Borxhin e Keq, mbajtur më 6 maj 2011

Siç është përmendur në letrën tuaj :

“Sa me sipër, do të ishte e nevojshme që dhe ne zbatim të ISA (540) paragrafi 14, të dhënat në lidhje me debitorët e keqinjtë duhet të jenë të pasqyruara dhe analizuar sipas vjetërsisë së debitorëve dhe numrit të muajve të mbuluar me furnizim.”

Ky paragraf merret me qasjen ndaj auditimit të vlerësimeve të drejtuesve. Ne nuk po auditojmë vlerësime të drejtuesve por po llogarisim në mënyrë direkte nivelin e borxhit të keq bazuar mbi të dhënat e rakorduara mes të dhënave nga sistemet e arkëtimit, shitjeve, llogarive të arkëtueshme dhe parasë dhe në fund pasqyrave financiare të audituara. Prandaj ne nuk besojmë së kjo referencë është e aplikueshme për punën tonë.

Më tej referenca vazhdon me: *“provizioni i Borxhit të Keq për të gjithë klientët të behet me mënyrën specifike, i mbështetur mbi të dhëna analitike për çdo klient përfshi evidentimin e të gjitha përpjekjeve të bëra nga kompania (ligjore dhe administrative) për arkëtimin e këtyre debitorëve .”*

Ne biznesin e shpërndarjes së energjisë (në mënyrë të ngjashme me utilitete të tjera si shpërndarja e gazit, ujit apo ngrohjes) për shkak të madhësisë dhe numrit të klientëve nuk është e mundur të llogaritet provizioni për borxhin e keq në mënyrë specifike klient për klient. Është një praktikë e zakonshme që provizioni bazohet mbi përvojën e arkëtimit historik nga kategoritë e klientëve si familjarë, privat e.t.j. Këtu ne i referohemi dhe njëherë thënies që procesi i arkëtimit është vetëm vendim i drejtuesve që është jashtë fushës së studimit mbi borxhin e keq siç është përkufizuar nga Deklarata Rregullatore, pra jashtë punës sonë në përcaktimin e nivelit të borxhit të keq. Sidoqoftë, për të evituar dyshimet, ne nuk mbështetemi në asnjë provizion të përgatitur nga drejtuesit por ne llogarisim nivelin e Borxhit të Keq duke analizuar klientët një për një duke përfshirë të dhënat egzistuese (fatura, pagesa), por jo provizione të drejtuesve.

Përgjigje ndaj komenteve të ERE në lidhje me Studimin mbi Borxhin e Keq siç është dorëzuar më 25 korrik 2011

1. “Ju lutem na jepni të gjitha fletët e punës që janë përdorur për të përgatitur Studimin mbi Borxhin e Keq. Nëse janë përdorur dokumenta në Excel ju lutem na i jepni këto dokumenta bashkë me formulat e pandryshuara.”

Deloitte: Dokumentat në Excel me llogaritjet e detajuara do t'i jepen ERE.

2. “Ju lutem na jepni një listë të gjithë stafit që përgatiti studimin dhe rolet e tyre në përgatitjen e studimit.”

Deloitte: Lista e personelit kryesor të projektit është prezantuar në tavolinën më poshtë, CV e shkurtra të grupit të punës formojnë Shtojcën 6 të Raportit.

Personeli	Roli në projekt
Maksim Caslli	Partneri drejtues i projektit, përgjegjës për marrëdhëniet me klientin dhe manaxhimin kryesor të projektit
Josef Kotrba	Partneri drejtues i projektit në Çeki, supervisor i grupit të punës nga Çekia dhe komunikimi me CEZ
Michal Brandejs	Partneri përgjegjës për përkufizimin e metodologjisë dhe llogaritjen e Borxhit të Keq
Martin Tesar	Partneri për sigurimin e cilësisë së projektit
Pavel Dedek	Drejtor i projektit, përgjegjës për mbikëqyrjen e projektit në bazë ditore
Kreshnik Robo	Manaxheri grupit të punës në Shqipëri
Miloslav Lukes	Manaxheri grupit të punës në Çeki
Iva Secova	Përpilimi i metodologjisë dhe llogaritja e Borxhit të Keq
Jana Zajickova	Përpilimi i metodologjisë dhe llogaritja e Borxhit të Keq
Jan Balatka	Mbledhja e të dhënave, zhvillimi i sistemeve dhe instrumentave të analizës së të dhënave, analiza e të dhënave
Karel Mazanek	Analiza mbështetëse dhe përpilimi i raportit
Matiel Hoxha	Analiza mbështetëse dhe përpilimi i raportit

Përgjigje ndaj komenteve të ERE në lidhje me Studimin mbi Borxhin e Keq siç është dorëzuar më 25 korrik 2011

3. “Niveli i Borxhit të Keq u rrit shumë që nga momenti i marrjes në drejtim të operacioneve të kompanisë nga CEZ (18.39% në 23.27%). “

a. “ A ka Deloitte një shpjegim se pse u rrit niveli i Borxhit të Keq në këtë periudhë?”

Deloitte: Analiza e arsyeve për zhvillimin specifik të Borxhit të Keq është jashtë fushës së shërbimeve tona, siç është përcaktuar sipas Deklaratës rregullatore. Ju lutem kini parasysh që ka një diferencë konceptuale midis Borxhit të Keq që është një llogaritje që bazohet mbi krahasimin e një faturimi të veçantë me arkëtimin respektiv që kryhet në disa periudha kontabël, me normën e mos-arkëtitimit që llogaritet si një raport mes faturimit dhe arkëtitimit në të njëjtin vit (pra pa përputhur arkëtimet me faturimet respektive). Ne kuptojmë që pavarësisht rritjes së Borxheve të Këqia ka një përmirësim në normën e mos-arkëtitimit meqë faturat e kaluara (borxhet e vjetra) shlyhen të parat. Gjithashtu ne kuptojmë që CEZ ka përmirësuar faturimin duke u faturuar klientëve shumë e saktë të konsumuar, dhe jo shumë afrofe. Këto mund të jenë arsyet përse borxhi i keq është rritur.

4. “A ka ndonjë sasi të përfshirë në “Borxhin e Keq” që nuk paguhet nga CEZ për shkak të mosmarrëveshjeve për faturimin me Qeverinë e Shqipërisë?”

Deloitte: Ne na u kërkua nga ERE të bënim një llogaritje skenari për Borxhin e Keq, duke konsideruar faktin që CEZ Shpërndarje ka detyrime të papaguara që i ka kaluar afati ndaj KESH. Skenari i kërkuar konsideron kompensimin potencial të llogarive të arkëtueshme nga buxhetorët, jo-buxhetorët dhe personat me aftësi të kufizuara kundrejt detyrimeve ndaj KESH, sidoqoftë ne kuptojmë që nuk as vendim detyruës ligjor për këtë, as një marrëveshje mes palëve. Nëse do të kishte një marrëdhënie të tillë niveli i Borxhit të Keq do të ishte si vijon: 14.86 % në 2008, 16.85% në 2009 dhe 19.73% në 2010.

5. “Në kërkesën e bërë në 2011 CEZ rishprehu konsumin historik të energjisë elektrike për shkak të egzistencës së “Klientëve Fiktivë”.

a. A ka marrë parasysh Studimi mbi Borxhin e Keq identifikimin e Klientëve Fiktivë?

Deloitte: Për qëllime të analizës tonë ne përdorim të dhëna nga databaza e faturimit dhe arkëtitimit dhe nga pasqyrat financiare për analizuar “klientët fiktivë”. Ne kuptojmë që “klientët fiktivë” janë klientë që kanë egzistuar në një moment të caktuar kohor, por nuk janë më për shkak të vdekjes, zhvendosjes apo ndonjë arsye tjetër. Në qoftë se një faturë është lëshuar ne e trajtojmë si të rregullt dhe përfshijmë shumë respektive në llogaritjen e Borxhit të Keq. Në mënyrë që të evitojmë dublimin për efekt tarife ne jemi informuar nga CEZ Shpërndarje që kjo shumë e energjisë elektrike nuk përfshihet në ndonjë humbje jo-teknike.

b. Nëse ndodh kështu, cili është impakti i Klientëve fiktivë në rezultatet e studimit?

Deloitte: Ju lutem referoju përgjigjes më sipër.

6.Referencë faqe 23 / pika 1

a. Ju lutem na jepni një arsyetim përse shuma që lidhet me subvencionin e 80% konsiderohet si Borxh i Keq.

Deloitte: Duke u bazuar në diskutimet tona me CEZ Shpërndarje ne kuptojmë që ka një mosmarrëveshje të pazgjidhur mes CEZ Shpërndarje dhe autoriteteve tatimore shqiptare. Duke qene se deri në fund të analizës tonë nuk ka patur asnjë vendim detyruës ne i trajtojmë shumat respektive si të lëshuara dhe të pa-arkëtuara plotësisht dhe i përfshijmë në llogaritje. Gjithashtu, ne nuk kemi aplikuar skontim mbi këto llogari të arkëtueshme në llogaritjen tonë, gjë që do ta rriste me rreth 50% vlerën e të arkëtueshmeve në FY2008, nëse përdorim normën e skontimit të Deklaratës Rregullatore.

Përgjigje ndaj komenteve të ERE në lidhje me Studimin mbi Borxhin e Keq siç është dorëzuar më 25 korrik 2011

6. "Referencë faqe 23 / pika 1"

b. "A ka kërkuar Deloitte një opinion ligjor për të mbështetur supozimet që këto të ardhura janë të pa-arkëtueshme?"

Deloitte: Ne e diskutuam këtë çështje me CEZ Shpërndarje, asnjë opinion ligjori i jashtëm nuk është përdorur në analizën tonë, ju lutem kini parasysh se këshillimi ligjor është jashtë fushës së shërbimeve tona. Sidoqoftë fakti është që kjo shumë është akoma një llogari e arkëtueshme në librat e CEZ Shpërndarje.

c. Ju lutem kuantifikoni ndikimin e subvencionit të personave me aftësi të kufizuara mbi rezultatet e studimit për 2008, 2009 dhe 2010.

Deloitte: Ne e kuantifikuam ndikimin e subvencionit për personat me aftësi të kufizuara mbi nivelin e Borxhit të Keq në nivelin 1.3% në FY 2008, 1.47% në FY 2009 dhe 1.42% në FY 2010.

7. "Referenca faqja 23 / Pika 2 / nën-pika e dytë"

a. Ju lutem kuantifikoni impaktin në Studimin mbi Borxhin e Keq për anulimin e disa faturave që kanë të bëjnë me "Dëmin Ekonomik".

Deloitte: Shuma totale kredituar është 1.724 milion Lek. Ne i eliminuam faturat e anuluar nga faturimet dhe arkëtimet prandaj nuk ka asnjë impakt mbi normën e Borxhit Keq nga ky anulim. Nëse faturat e anuluar nuk do ishin hequr, niveli i Borxhit të Keq do rritej me 0.73%.

8. "Referencë faqe 23 / Pika 3"

a. Ju lutem jepni një shpjgim të detajuar dhe llogaritjet mbështetëse që shpjegojnë se si korigjimet në shitjet e brendshme do të ndiknin Studimin mbi Borxhin e Keq.

Deloitte: Duke qenë se shitjet e brendshme futen në sistem vetëm për efekt TVSH, në të njëjtën mënyrë si shitjet e rregullta, dhe pastaj duhen netuar si të paguara, këto duhet të përjashtohen për efekt raportimi si në faturim ashtu dhe në arkëtim sepse këto shitje bëhen brenda kompanisë. Meqë shitjet e brendshme nuk janë trajtuar në të gjithë zonat në të njëjtën mënyrë (nuk janë regjistruara si të paguara në të gjitha zonat), mund të ndodhë që në disa zona, shuma e përjashtuar në faturim është më e madhe se shuma e përjashtuar në arkëtim. Sidoqoftë ky hap është vetëm një axhustim për të dhënat kryesore (bërë për të rakorduar të dhënat nga databaza e faturim&arkëtimit me pasqyrat financiare) dhe nuk ka ndikim te niveli i Borxhit të Keq. Shuma e hequr nga faturimet ishte 0.2%-0.43% dhe në arkëtime 0.16%-0.25% të të ardhurave.

9. Referencë faqe 24 / Pika 1"

a. "Ju lutem kuantifikoni ndikimin e pagesave të anuluar në Studimin mbi Borxhin e Keq"

Deloitte: Ne eliminuam faturat e anuluar nga llogaritja jonë meqë sistemi nuk lejon kreditimin e faturave. Ne e kuantifikuam ndikimin e faturave të anuluar në një nivel prej 0.01% – 0.19% në faturim. Duke qenë se kryesisht e njëjta shumë duhet të përjashtohet nga Arkëtimet, ky hap është një axhustim i të dhënave kryesore (për të bërë rakordimin mes databazës dhe pasqyrave financiare) dhe nuk duhet të ketë ndikim në Borxhin e Keq.

Përgjigje ndaj komenteve të ERE në lidhje me Studimin mbi Borxhin e Keq siç është dorëzuar më 25 korrik 2011

9. Referencë faqe 24 / Pika 1”

b. “Ju lutem kuantifikoni ndikimin e pagesave të pjeshme në Studimin mbi Borxhin e Keq.”

Deloitte: Pagesat e pjeshme nuk mund të futen në sistem (ato mbahen veçasi) prandaj këto pagesa i duhen shtuar arkëtimeve. Ne e kuantifikojmë ndikimin e pagesave të pjeshme mbi nivelin e Borxhit të Keq në rreth 0.1% deri në 0.63% (duke e ulur nivelin e Borxhit të Keq).

10. “Referencë faqe 24 / Pika 2”

a. “ A përfshin Studimi mbi Borxhin e Keq nivelin e vlerësuar të energjisë së marrë nga rrjeti i shpërndarjes nëpërmjet lidhjeve të paligjshme si një Borxh të Keq?”

Deloitte: Transaksionet në lidhje me Policinë Elektrike janë regjistruar kur janë arkëtuar, jashtë sistemit, në 2008 dhe një pjesë e 2009. Prandaj ne i shtuam për qëllim të analizës, dhe duke qenë se regjistrimi bëhej në momentin e arkëtimit (*cash basis*) kjo e ul nivelin në Borxhit të Keq.

b. “Nëse kështu, a ka përfshirë studimi shitjet dhe të ardhurat e faturuara nga energjia e vjedhur në bazë e llogaritjes së përqindjeve?”

Deloitte: Ju lutem referoju përgjigjes më sipër.

c. Nëse energjia e vjedhur është përfshirë si shitje dhe e ardhur, a duhet të zbritet nga humbjet fizike të kompanisë?”

Deloitte: Kjo çështje (analiza e bilancit të energjisë elektrike) është jashtë fushës së shërbimeve tona, ne kemi llogaritur vetëm Borxhin e Keq. Nëse ju po i referoheni energjisë së vjedhur që për shkak të politikave përforcuese i është faturuar klientëve, kjo është raportuar si shitje dhe nuk është vjedhur më. Pjesa e vjedhur dhe e paidentifikuar është pjesë e humbjeve fizike të CEZ.

11. “Reference faqe 24 / Pika 3”

a. “ Ju lutem na jepni një shpjegim të detajuar për ndikimin e faturimit reaktiv mbi Borxhet e Këqia”

Deloitte: Në FY2008 dhe FY2009 energjia reaktive për disa klientë faturon jashtë databazës së faturimit dhe arkëtimit. Në FY2010 energjia reaktive ishte përfshirë plotësisht në databazën e Faturimit dhe Arkëtimit. Prandaj ne i shtojmë shumat respektive në llogaritjen tonë. Arkëtimet janë përfshirë kryesisht në pagesat e papërputhura me faturat dhe në kuptojmë që norma e arkëtimit është më e mirë se mesatarja për kompaninë. Prandaj ne nuk mund të kuantifikojmë ndikimin e saktë. Sidoqoftë si faturimi dhe arkëtimi në total janë pjesë e llogaritjes. Energjia reaktive përfaqson vetëm 0.01% - 0.03% të të ardhurave të faturuara në vitet respektive.

Përgjigje ndaj komenteve të ERE në lidhje me Studimin mbi Borxhin e Keq siç është dorëzuar më 25 korrik 2011

12. "Reference faqe 25 / Pika 1

- a. " Ju lutem sqaroni që klientët në Gjirokastrë që ishin faturuar megjithëse nuk ka asnjë kontratë i kanë të përfshira të ardhurat në librat e kompanisë, rrjedhimisht e ulin borxhin e keq.

Deloitte: Sistemi i faturimit në Gjirokastrë u zbatua në Prill 2009, për këtë të gjitha të dhënat për faturimin dhe arkëtimin mbaheshin veçasi deri në atë kohë. Të gjitha këto të dhëna u përfshinë siç duhet në të ardhurat e njohura për 2008 dhe 2009, si dhe u prezantuan në pasqyrat financiare. Ky veprim e ul nivelin e Borxhit të Keq meqë norma e arkëtimit këtu është më e mirë se mesatarja për kompaninë (e ul nivelin e borxhit të Keq me 0.7% në FY2008).

- b. " A janë rishprehur librat dhe regjistrimet e kompanisë për të rritur shitjet në lidhje me këto klientë?"

Deloitte: Nuk ka patur nevojë për ri-shprehje meqë shumat respektive ishin përfshirë në të dhënat kryesore. Ne i përfshijmë këto të dhënat për llogaritjen e nivelit të Borxhit të Keq. Ju lutem, shihni më sipër.

13. "Referencë faqe 25/ Pika 2

- a. " Ju lutem shpjegoni përse bëhet ky axhustim dhe impaktin e tij mbi Studimin mbi Borxhin e Keq."

Deloitte: Shitjet midis zonave bëhen për të mbuluar një diferencë midis konsumit dhe energjisë disponibël për zona të veçanta (vetëm në 2008 dhe 2009). Këto transaksione procesohen si shitje normale në databazën e Faturimit dhe Arkëtimit dhe prandaj duhet të përjashtohen si nga databaza e faturimit dhe arkëtimit ashtu dhe nga shitjet e brendshme. Këto shitje regjistrohen në një llogari të veçantë në bilancin vërtetues (trial balance), që pastaj përjashtohet nga pasqyrat financiare si një axhustim për veprime brenda kompanisë. Ne e kemi kuantifikuar impaktin e shitjeve brenda zonave në 0.01% - 0.04% të shitjeve (prandaj eliminimi i saj do të thotë ulje në nivelin e Borxhit të Keq).

14. "Referenca faqe 26 / Pika 2"

- a. " Ju lutem kuantifikoni ndikimin mbi Studimin mbi Borxhin e Keq të diferencave të pashpjeguara mes databazës F&A dhe raporteve të sistemit të faturimit të CEZ"

Deloitte: Në Faturime diferenca kumulative përfaqson 0.02% nga energjia e faturuar, për të tre vitet, po pa tejkalar 0.05% në një vit. Në Arkëtime ky volum përfaqson 0.02% nga arkëtimet kumulative për tre vite, po pa tejkalar 0.04% në një vit. Si rrjedhojë, nuk ka gati asnjë impakt mbi normën e Borxhit të Keq.

Nën-seksionet	Faqe
Metodologjia e propozuar	63
Metoda e pasqyimit të Bilancit	66
Metoda e Pasqyrës së të Ardhurave	67
Kalimi mes metodës së pasqyimit të Bilancit dhe Pasqyrës së të Ardhurave	68
Llogaritja e raporteve të arkëtimit	69

Hyrje në metodologjinë e propozuar për llogaritjen e Borxhit të Keq

- Duke lexuar dokumentat rregullatore dhe parimet përgjithësisht të pranura të kontabilitetit, Borxhi i Keq përmendet specifikisht në Manualin e Kontabilitetit dhe në SNK/SNRF.

Manuali i Kontabilitetit

Kategoritë dhe struktura e Llogarive të Arkëtueshme

- „Kërkesat për arkëtim ndaj klientëve do të raportohen me vlerën e faturës, nga e cila është zbritur një provizion për zhvlerësim. Provizioni për zhvlerësim do të llogaritet nëse ka një farë sigurie që kompania nuk do të jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë sasinë sipas kushteve fillestare në lidhje me vlerësimin respektiv. Humbja nga zhvlerësimi është shuma me të cilën vlera e mbartur tejkalon vlerën e rikuperueshme që përfaqëson vlerën aktuale të flukseve të parasë, e skontuar me një normë interesi tregu e aplikueshme për klientë të ngjashëm..“

SNK/SNRF:

Kuadri për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare

„(85) Koncepti i mundësisë përdoret në kriteret e njohjes për t’ju referuar shkallës së pasigurisë që përfitimet ekonomike në të ardhmen që shoqërojnë elementin do të rrjedhin tek ose nga njësi ekonomike. Koncepti i përmbahet pasigurisë që karakterizon mjedisin në të cilin vepron një njësi ekonomike. Vlerësimet e shkallës së pasigurisë që i bashkëngjiten rrjedhjes së përfitimeve ekonomike në të ardhmen bëhen mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën kur përgatiten pasqyrat financiare. Për shembull, kur është e mundur që një llogari e arkëtueshme e zotëruar nga njësi ekonomike do të paguhet, atëherë është e justifikuar, në mungesë të ndonjë evidence kundërshtuese, të njihet llogaria e arkëtueshme si aktive. Megjithatë, për një popullatë të madhe llogarish të arkëtueshme, një farë shkalle për mos-pagesë normalisht konsiderohet e mundur; kështu që njihet një shpenzim që paraqet uljen e pritshme të përfitimeve ekonomike..“


SNK 36

„(9) Një njësi ekonomike duhet të vlerësojë në çdo datë raportimi nëse ka apo jo ndonjë indikacion që ndonjë aktiv të jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston një indikacion i tillë, atëherë njësi ekonomike duhet të çmojë shumën e rikuperueshme të aktivitetit. Një aktiv quhet i zhvlerësuar atëherë kur vlera kontabël neto e tij tejkalon vlerën e rikuperueshme..“



Parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara kundrejt flukseve të parasë – arkëtimet e ardhshme

Diferenca kohore ndërmjet Faturimit dhe Arkëtimit dhe disponueshmëria e të dhënave.

- Të ardhurat e vitit mund të arkëtohen përgjatë disa periudhave. Arkëtimet i korespondojnë faturave respektive të lëshuara. Prandaj, disa arkëtime të marra në vitin 2010 vazhdojnë të korespondojnë me fatura të viteve 2008 ose 2009.



Shënim:

-  Para të arkëtuara nga të ardhurat e vitit FYxx
-  Arkëtimet e parashikuara për të ardhurat e vitit FYxx

Metodologjia e propozuar për llogaritjen e Borxheve të Këqija

- Bazuar mbi përshkrimet në Manualin e Kontabilitetit dhe SNK/SNRF, provizioni mbi Borxhin e Keq duhet të përfaqësojë diferencën midis faturës së lëshuar dhe vlerës aktuale neto të shumës së arkëtuar. Në terma praktikë, ne propozojmë të përdorim përkufizimin e mëposhtëm mbi Borxhin e Keq:

Diferenca mes të ardhurave të faturuara dhe arkëtuara duke përfshirë parashikimet për arkëtime në të ardhmen.

- Përqindja që rezulton për përcaktimin e tarifës do të llogaritet si:

Të ardhurat e Pambledhura nga Familjet / Të Ardhurat Totale	+	
Të ardhurat e Pambledhura nga Buxhetoret / Të Ardhurat Totale	+	
Të ardhurat e Pambledhura nga jo-Buxhetorët/ Të Ardhurat Totale	+	
Të ardhurat e Pambledhura nga Privatët / Të Ardhurat Totale	=	
Të ardhurat e Pambledhura / Të Ardhurat Totale		

në secilin vit.

Shënim: Të ardhurat totale përfaqësojnë shumën e faturuar konsumatorëve fundorë lidhur me shitjen e energjisë elektrike. Duke iu referuar nenit 5.2 të Deklaratës Rregullatore, të Ardhurat Totale përfaqësojnë "Të Ardhurat e FPP", duke shtuar zbritjen për Borxhin Keq pa përfshirë TVSH-në.

Çështje të tjera për t'u marrë në konsideratë

- Për thjeshtësi ne nuk do e konsiderojmë që skontimi reflekton diferencat kohore të arkëtimeve. Një skontim i tillë duhet t'i vendoset shumave të paguara pas më shumë se 6 muaj. Meqënëse pjesa mbizotëruese e arkëtimeve (95% në 2008, 94.7% në 2009, dhe 98.8% në 2010) ndodhin brenda 6 muajve të parë, ne nuk e skontojmë parandë e arkëtuar pasi niveli i borxhit nuk do ndryshonte në mënyrë domethënëse si pasojë e kësaj.
- Për shkak të historikut të ndryshëm në pagesa të klientëve të ndryshëm (kryesisht klientët buxhetorë dhe jo-buxhetorë ku dhe pas periudhave të gjata arkëtohen pagesa) ne propozojmë të bejmë llogaritjen e provizionit për borxhin e keq sipas secilës kategori klienti, në mënyrë të ndarë. Më pas, përqindja e borxhit të keq do të llogaritet mbi të gjithë popullatën duke përdorur mesataren e ponderuar.

Shembull teorik

Faturime (fatura të lëshuara për një periudhë të rregullt)

100	+	20	=	120
Të ardhura të faturuara pa TVSH		TVSH		Totali faturimeve

Mbledhja e faturave të lëshuara

86	+	17.2	=	103.2
Të ardhura të mbledhura pa TVSH		TVSH		Totali të mbledhura

= Të Pambledhura (Borxh i Keq)

14	+	2.8	=	16.8
Borxh i Keq		TVSH Borxh i Keq*		Totali Borxhit të Keq

Shënim : * Kjo nuk është në rregullorë

Metoda e pasqyrimt të Bilancit

- Metoda e pasqyrimt të Bilancit përdoret më shumë në praktikë dhe përshkruhet më mirë në teorinë e kontabilitetit.
- Kjo metodë prezumon vlerësimin e arkëtimeve të ardhshme të llogarive të arkëtueshme të pambyllura në fund të vitit duke u bazuar në:
 - përvojen e shkuar me arkëtimet,
 - përvojen me çregjistrimet dhe
 - parashikimet për të ardhmen.
- Në terma praktikë, ne propozojmë të aplikojmë sa më sipër mbi vitin dhe strukturën e moshës së llogarive të arkëtueshme:
 - Arkëtimet e mëparshme duke u bazuar në mesataren e ponderuar të arkëtimeve të ndodhura gjatë vitit të dhënë
 - Përvoja në çregjistrimin e debitorëve bazuar në çregjistrimet aktualisht të ndodhura.
 - Parashikimet për të ardhmen – duke qënë se ne e bëjmë llogaritjen shumë kohë pas periudhave respektive (për 2008 dhe 2009) dhe disa muaj pas 2010, ne propozojmë të përdorim arkëtimin aktual të mbledhur pas fundit të vitit (per 2010 në parashikojmë të përdorim historinë e arkëtimeve deri në 18 maj 2011).

Shembull mbi llogaritjen me metodën e pasqyrimt të Bilancit (bazuar mbi përvojen historike)

Arkëtuar brenda afatit	50%
Arkëtuar me 0-30 ditë vonesë	20%
Arkëtuar me 31-60 ditë vonesë	5%
Arkëtuar me 61-90 ditë vonesë	3%
Arkëtuar me 91-120 ditë vonesë	2%
Arkëtuar me 121-180 ditë vonesë	2%
Arkëtuar me 181-360 ditë vonesë	1%
Arkëtuar me 361-720 ditë vonesë	1%

Teprica e llogarive të arkëtueshme më 31.12. 20XX	Me vonesë									Total
	brenda afatit	0-30	31-60	61-90	91-120	121-180	181-360	360-720	mbi 720	
Llogaritë e arkëtueshme, bruto	10,000	800	600	400	200	100	50	30	20	12,200
Përqindja e provizionit	50%	80%	95%	97%	98%	98%	99%	99%	100%	
Provizioni	5,000	640	570	388	196	98	50	30	20	<u>6,991.2</u>
Llogaritë e arkëtueshme, neto										<u><u>5,209</u></u>

Impakti në PASH:

Teprica hapëse e Provizionit

Minus: arkëtimet e llogarive të arkëtueshme të dhëna

Plus: provizionet e reja

Minus: çregjistrimet

Teprica mbyllëse e Provizionit

$$\frac{\sum \text{Shpenzimi për Borxhin e Keq}}{\sum \text{Totali të ardhurave}} = x \%$$

Σ = ndryshimi mes tepricës hapëse dhe mbyllëse të provizionit për borxhin e keq.

Metoda e Pasqyrës së të Ardhurave

- Përqindja e shitjeve bazohet në historinë e kompanisë, dhe në standartet e industrisë për humbjet. Nëse biznesi ka qenë stabil kjo është e thjeshtë për t'u parashikuar duke u bazuar në historinë e llogarive të paarkëtueshme.
- Në rastin e CEZ Shpërndarje:
 - Ne nuk kemi një histori të gjatë dhe të qëndrueshme,
 - Ne nuk kemi kompani të krahasueshme.
- Prandaj, në propozojmë ta bazojmë metodën e pasqyrës të të ardhurave mbi trendin dhe karakteristikat e arkëtimeve. Për vitin 2008, ne do të përdorim arkëtimet aktuale sepse nuk mendohet të ketë arkëtime të tjera pas një kohe kaq të gjatë. Për vitet 2009 dhe 2010 ne do të parashikojmë ose përlllogarisim arkëtimet në periudhën pas 18 maj 2010 bazuar në trendin e arkëtimeve të viteve 2008 dhe 2009.

Shembull i llogaritjes

-SHITJET x përqindja= BORXHI I KEQ

Si shembull po prezumojmë që shitjet me kredi për periudhën janë 100,000 dhe përqindja e llogarive të pa-arkëtueshme është 14% (bazuar në trendin historik të arkëtimit).

- 100,000 x14% = 14,000.

Debi-Shpenzime të Borxhit të Keq / Kredi-Provizion për Llogari të Dyshimta për \$14,000.

Për thjeshtim nuk po i konsiderojmë çregjistrimet në këtë shembull.

Kalimi mes metodës së pasqyrimit të Bilancit dhe Pasqyrës së të Ardhurave – shembull i llogaritjes

Më poshtë ne po përshkruajmë hapat e marrë për të arrirë nga një trend arkëtimi në norma provizionit sipas metodës e pasqyrimit të Bilancit.

Komente/Hapa:

- 1) kollona A – ne përcaktuam kategoritë e moshës
- 2) kollona B – bazuar në përvojën historike u përcaktua një normë arkëtimi brenda një kategorie të dhënë moshe
- 3) shuma origjinale e faturuar në periudhën e dhënë jepet në fillimin e kolonës D
- 4) kollona C – pjesa e tepricës së mbledhur nga fatura origjinale u llogarit duke shumëzuar normën te kollona B me shumën origjinale të faturuar.
- 5) kollona D – teprica e mbetur e pambledhur është përcaktuar si një diferencë mes tepricës së pambledhur të shumës totale të faturuar në fillim zvogëluar me shumën e arkëtuar në periudhën e dhënë.
- 6) norma e provizionit llogaritet për kategorinë e dhënë të moshës si një raport mes tepricës së konsideruar si të pa-arkëtuar dhe tepricës së mbetur të pa-arkëtuar.

A	B	C	D	E
Mosha - deri në	Arkëtuar nga cfarë është faturuar nominalisht	Arkëtuar	Teprica e mbetur e parkëtuar	Përqindja e provizionit (kumulative)
Shuma				100
Brenda afatit		45.0%	45	= (100-45) = 55
30 ditë		17.0%	17	= (55-17) = 38
30-60		13.0%	13	25
60-90		5.0%	5	20
90-120		3.0%	3	17
120-180		1.0%	1	16
180-360		1.0%	1	15
360-720		0.5%	0.5	14.5
mbi 720		0.5%	0.5	14
Nëntotali		86.0%	86	100%
Të parkëtuara		14%	14	
Metoda e të ardhurave	provizion		= (100 x 14%) = 14	
Metoda e bilancit	TH e provizionit për kategorinë e moshës mbi 180 ditë outstanding uncollected balance at y/e TM e provizionit		0	
			16	= (16 x 88%) = 14

Llogaritja e normave të arkëtimit

Ndikimi në llogaritje

- Arkëtimet për faturat e lëshuara në vitet e mëparshme duhet të përfshihen siç duhet në llogaritje
- Arkëtimet shtesë për periudhat për të cilat nuk ka të dhëna të mjaftueshme duhet të vlerësohen siç paraqitet më poshtë:

Raporti i arkëtimit për vitin financiar 2008

Arkëtimet në 08, 09, 10 në lidhje me 2008

Të ardhurat 2008

Raporti i arkëtimit për vitin financiar 2009

Arkëtimet në 09, 10 që lidhen me 2009 + Arkëtimet e pritshme në 11 që lidhen me 2009 (bazuar mbi trendin e arkëtimit në 2008)

Të ardhurat 2009

Raporti i arkëtimit për vitin financiar 2010

Arkëtimet në 10 që lidhen me 2010 + Arkëtimet e pritshme në 11, 12 që lidhen me 2010 (bazuar në trendin mesatar të arkëtimit në 2008 dhe 2009)


Të ardhurat 2010

Nën-seksionet	Faqe
Panoramë e shitjeve	71
Arkëtimi i shitjeve	72
Analiza e pa-arkëtueshmërisë	73


Ndarja e shitjeve sipas rajoneve dhe konsumatorëve

- CEZ Shpërndarje është e organizuar në 10 zona (Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Burrel, Korçë, Gjirokastër, Shkodër dhe Kukës).
- Dy zonat më të mëdha, Tirana dhe Durrësi, përfaqësojnë 37% dhe 14% te shitjeve totale për FY10.
- Konsumatorët familjarë mbeten grupi më i madh i cili përfaqëson rreth 50% të shitjeve totale .


Shitjet sipas zonës (FY10, ALLM)



Shitjet sipas tipit të klientit (FY08, ALLM)






Shitjet sipas tipit të klientit (FY10, ALLM)



Arkëtimi i shitjeve – ecuria historike

- Përqindja e arkëtimit është në rënie gjatë periudhës FY08-FY10
- Grafikët e arkëtimeve kumulative tregojnë se arkëtimet kryesore mbliidhen brenda 3 muajve të parë dhe pastaj ulen ndjeshmërisht
- Konsumatorët privatë janë më të besueshmit përsa i përket arkëtimeve me një përqindje arkëtimi prej rreth 87%. Nga ana tjetër, konsumatorët jo-buxhetorë kanë përqindjen më të ulët të arkëtimeve prej rreth 68% në FY10.




NB: FY08 – historiku i arkëtimeve është i disponueshëm për periudhën 2008 – 18 Maj 2011; FY10 – historiku i arkëtimeve është i disponueshëm për periudhën 2010 – 18 Maj 2011


Përqindja e pa-arkëtueshmërisë - sipas zonave

- Norma e pa-arkëtueshmërisë ndryshon shumë mes zonave, me normën më të lartë në Kukës (83%) dhe normën më të ulët në Elbasan dhe Gjirokastrë (5%) në FY10.
- Norma e pa-arkëtueshmërisë është rritur në të gjitha zonat gjatë periudhës FY08-FY10.


Norma e pa-arkëtueshmërisë per zonat per 2010





Norma e pa-arkëtueshmërisë per zonat per 2008



Norma e pa-arkëtueshmërisë per zonat per 2009




Përqindja e pa-arkëtueshmërisë - sipas zonave dhe kategorisë së konsumatorëve



Nën-seksionet	Faqe
Panorama e menyrës së përlllogaritjes	76
Furnizimi me të dhënat kryesore	77
Përlllogaritja me metodën e pasqyrës së të ardhurave	78
Përlllogaritja me metodën e pasqyrimit të bilancit	82
Krahasimi i metodave	86
Përlllogaritja finale e borxhit të keq	87

Hapat kryesore te ndjekura



Pajisja me të dhënat kryesore

Databaza e faturimeve dhe arkëtimeve

- Për analizën e llogarive të arkëtueshme ne morëm të dhënat nga sistemi i faturimit i CEZ Shpërndarje. Të dhënat u morën në formën e databazave MS SQL të konsoliduara në një (databazat kopje) të cilat konsistojnë në 20 databazave sipas zonave dhe qendrave të shitjes për periudhën 2008 – Prill 2011. Kjo databazë u analizua nga Deloitte dhe u përmbledh duke u bazuar në kategoritë e konsumatorëve dhe zonave duke përdorur këto databaza kryesore:
 - „**Kontrata**“ që përfshin të dhëna rreth kontratave të konsumatorëve
 - „**Konsumi i abonentëve**“ që përfshin informacion rreth konsumit të konsumatorëve dhe faturave të lëshuara
 - „**Code_rates1**“ që përfshin të dhëna rreth tarifave të konsumatorëve
- Proçesi mund të përmbledhet në hapat e mëposhtëm:



- Shembull i të dhënave origjinale nga databazat e faturimeve dhe arkëtimeve:

Kategoria klientit	Zona	Tarifa	Data faturës	Data pagesës	Totali faturuar	Kabina (pika e kalimit)	Numri i kontratës
Buxhetor	Elbasan	ANO	12.1.2009	15.2.2009	243,132	5,238	38925
Familjarë	Fieri	AC	23.1.2009	17.1.2011	39,552	5,246	50254
Jo-buxhetor	Fieri	Aë1	25.1.2009		9,970	1,682	57829
Privat	Tirana	BB	27.1.2009	28.1.2011	2,040	5,934	93249

- Sistemi i faturimit nuk përmban disa të dhëna që janë regjistruar jashtë këtij sistemi, p.sh. pagesa të marra që nuk janë akoma të çiftuara me faturat, apo pagesa të pjeshme si dhe të tjera të përshkruara në seksionin “Rakordimi i të Dhënave”. Për këtë arsye u përgatit Ura e Rakordimeve si dhe axhustimet që mund të kenë ndikim në Borxhin e Keq u shtuan apo hoqën nga llogaritjet.

Metoda e Pasqyrës së të Ardhurave

Metoda e pasqyrës së të ardhurave bazohet në trendin e pagesave. Përlllogaritja mund të përmblihet në hapat e mëposhtëm:

Hapi 1

Të dhënat nga databaza e faturimeve dhe arkëtimeve u përmbledhën në tabela sipas zonave dhe kategorive të konsumatorëve në baza mujore për të treguar kur ishin arkëtuar faturat e lëshuara gjatë vitit.

Data e faturimit / Arkëtimi	1.1.2009	1.2.2009	1.3.2009	1.4.2009
1.1.2009	17 580	82 213 708	17 487 922	5 560 417
1.2.2009		5 292	65 109 902	23 569 371
1.3.2009			15 222	71 715 845
1.4.2009				24 000

Hapi 2

Ne përmbledhëm të dhënat rreth arkëtimeve të marra brenda një intrvali të caktuar moshe

(p.sh. 0-30, 31-60, 61-90, 91-120, 121-180, 181-360, 361-720 dhe më shumë se 721 ditë) nga lëshimi i një fature të përcaktuar. Trendi i pagesave tregon se arkëtimet kryesore ndodhin brenda 3 muajve të parë dhe më pas ulen ndjeshm (ka një përjashtim në FY10 kur u bë një pagesë e rëndësishme për konsumatorët jo-buxhetorë, pagesë e cila shleu faturat e viteve 2008 dhe 2009).

Hapi 3

Ne përlllogaritëm trendin e pagesave si % ndaj shumave të faturuara për intervale të caktuara moshe ndaj shitjeve totale për vitin.

Hapi 4

Ne reflektoam ndikimin e axhustimeve të tabelës së rakordimeve ndaj faturimeve dhe/ose arkëtimeve.

Hapi 5

Ne i pjesëtuam shumat e paarkëtuara (nga hapat 3 dhe 4) me shitjet totale për të arritur tek shpenzimi për borxhin e keq, pra % e shitjeve të paarkëtuara e identifikuar nga trendi i pagesave përbën % e shpenzimit për borxhin e keq.

Përsa i përket disponueshmërisë së të dhënave:

- Për FY 2008 borxhi i keq u përcaktua në bazë të arkëtimeve aktuale duke qenë se ne nuk priten arkëtime të mëtejshme pas 28 muajsh (deri në 18 maj 2011)
- Për FY 2009, 2010 ne vlerësojmë arkëtimet pas 18 maj 2011 bazuar mbi trendet historike të arkëtimeve të llogaritura si mesatare të viteve 2008 dhe 2009.

mosha	të arkëtuara brenda	% e të arkëtueshmeve
brenda afatit	1 355 456 994	61%
0-30 ditë	326 238 627	15%
31-60 ditë	68 192 384	3%
61-90 ditë	48 444 636	2%
91-120 ditë	27 532 503	2%
121-180 ditë	26 947 263	2%
181-360 ditë	69 936 526	4%
361-720 ditë	11 038 071	1%
mbi 720 ditë	0	0%

Metoda e Pasqyrës së të Ardhurave – llogaritja e faturimit

ALL Faturimet	FY 2008	% mbi shitjet	FY 2009	% mbi shitjet	FY 2010 (bazuar mbi trendin e 2009)	% mbi shitjet	FY 2010 (bazuar mbi trendin e 2008)	% mbi shitjet
sipas databazës F&A (ALL)	36,958,486,302	94.53%	42,195,256,355	97.95%	51,515,009,186	98.32%	51,515,009,186	98.32%
Axh 1 - Persona me aftësi të kufizuar 80%	505,453,554	1.29%	635,367,598	1.47%	742,752,851	1.42%	742,752,851	1.42%
Axh 2A - Rezultatet e grupit NTL								
Axh 2B - Ngjarje pas datës së bilancit (fatura të anulhuara)					-1,724,220,336	-3.29%	-1,724,220,336	-3.29%
Axh 3 - Shitje të brendshme	-150,470,235	-0.38%	-183,463,088	-0.43%	-98,223,254	-0.19%	-98,223,254	-0.19%
Axh 4 - Fatura të anulhuara	-74,504,885	-0.19%	-14,803,779	-0.03%	-7,542,302	-0.01%	-7,542,302	-0.01%
Axh 5 - Policia elektrike	16,216,520	0.04%						
Axh 6 - Energjia reaktive	10,971,847	0.03%	22,159,864	0.05%	0	0.00%	0	0.00%
Axh 7 - Klientë pa kontratë	118,522,680	0.30%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%
Axh 8 - Shitjet midis zonave	-16,759,470	-0.04%	-5,827,869	-0.01%	0	0.00%	0	0.00%
Axh 9 - KESH								
Axh 10 - Pagesa të pjesshme								
Axh 11 - Arkëtime nga viti i kaluar								
Axh 12 - Diferenca mes databazës F&A dhe raporteve nga sistemi i faturimit të CEZ	-9,297	0.00%	-20,071,086	-0.05%	-369,558	0.00%	-369,558	0.00%
Axh 13 - Tarifa e lidhjes								
Axh 14 - Tarifa e shpërndarjes								
Axh 15 - Të dhëna nga Gjirokastra	1,725,584,215	4.41%	447,743,840	1.04%				
Axh 16 - Energjia e pafaturuar (2010)					1,966,776,000	3.75%	1,966,776,000	3.75%
Axh 17 - Pagesa që nuk janë identifikuar akoma								
Axh 18 - Axhustime të tjera të vogla	0		0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%
Axh 19 - Diferenca të tjera	3,074,665	0.01%	1,571,628	0.00%	2,285,098	0.00%	2,285,098	0.00%
Totali i axhustimeve (duke përfshirë TVSH)	2,138,079,594	5.47%	882,677,108	2.05%	881,458,499	1.68%	881,458,499	1.68%
Faturimet e AXHUSTUARA (përfshirë TVSH)	39,096,565,896		43,077,933,463		52,396,467,684		52,396,467,684	

Metoda e Pasqyrës së të Ardhurave – llogaritja e arkëtimit

	FY 2008	% mbi shitjet	FY 2009	% mbi shitjet	FY 2010 (bazuar mbi trendin e 2009)	% mbi shitjet	FY 2010 (bazuar mbi trendin e 2008)	% mbi shitjet
ALL								
Arkëtimet								
sipas databazës F&A	30,330,167,963	-77.58%	33,699,467,764	-78.23%	38,053,806,291	-72.63%	38,053,806,291	-72.63%
Axh 1 - Persona me aftësi të kufizuar 80%	0		0		0	0.00%	0	
Axh 2A - Rezultatet e grupit NTL								
Axh 2B - Ngjarje pas datës së bilancit (fatura të anulnuara)					-1,724,220,336	3.29%	-1,724,220,336	3.29%
Axh 3 - Shitje të brendshme	-97,464,874	0.25%	-89,723,239	0.21%	-81,956,092	0.16%	-81,956,092	0.16%
Axh 4 - Fatura të anulnuara	-74,504,885	0.19%	-64,452,917	0.15%	-52,153,109	0.10%	-52,153,109	0.10%
Axh 5 - Policia elektrike	16,216,520	-0.04%						
Axh 6 - Energjia reaktive	10,971,847	-0.03%	3,054,675	-0.01%	0	0.00%	0	0.00%
Axh 7 - Klientë pa kontratë	97,266,234	-0.25%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%
Axh 8 - Shitjet midis zonave								
Axh 9 - KESH								
Axh 10 - Pagesa të pjesshme	4,509,767	-0.01%	17,705,737	-0.04%	328,240,842	-0.63%	328,240,842	-0.63%
Axh 11 - Arkëtime nga viti i kaluar	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%
Axh 12 - Diferenca mes databazës F&A dhe raporteve nga sistemi i faturimit të CEZ	-17,592,002	0.04%	-1,646,925	0.00%	-3,999,337	0.01%	-3,999,337	0.01%
Axh 13 - Tarifa e lidhjes								
Axh 14 - Tarifa e shpërndarjes								
Axh 15 - Të dhëna nga Gjyrokastra	1,675,485,101	-4.29%	434,744,434	-1.01%				
Axh 16 - Energjia e pafaturuar (2010)					1,565,773,256	-2.99%	1,607,364,179	-3.07%
Axh 17 - Pagesa që nuk janë identifikuar akoma	6,940,655	-0.02%	120,347,704	-0.28%	437,542,566	-0.84%	437,542,566	-0.84%
Axh 18 - Axhustime të tjera të vogla	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%
Axh 19 - Diferenca të tjera	0	0.00%	0	0.00%	87,405,982	-0.17%	87,405,982	-0.17%
Totali i axhustimeve	1,621,828,363	-4.15%	420,029,469	-0.98%	556,633,772	-1.06%	598,224,695	-1.14%
Arkëtimet shtesë të vlerësuara bazuar mbi trendin e 2008/2009 (N/A për 2008)			175,346,796	-0.41%	1,703,450,563	-3.25%	1,067,345,865	-2.04%
Arkëtimet e AXHUSTUARA (përfshirë TVSH)	31,951,996,325		34,294,844,029		40,313,890,626		39,719,376,850	

Metoda e Pasqyrës së të Ardhurave – Llogaritja e Borxhit të Keq

ALL	FY 2008	% mbi shitjet	FY 2009	% mbi shitjet	FY 2010 (bazuar mbi trendin e 2009)	% mbi shitjet	FY 2010 (bazuar mbi trendin e 2008)	% mbi shitjet
Faturimet e AXHUSTUARA (përfshirë TVSH)	39,096,565,896		43,077,933,463		52,396,467,684		52,396,467,684	
Arkëtimet e AXHUSTUARA (përfshirë TVSH)	31,951,996,325		34,294,844,029		40,313,890,626		39,719,376,850	
Borxhi i keq i AXHUSTUAR (përfshirë TVSH)	7,144,569,570		8,783,089,434		12,082,577,058		12,677,090,834	
Sipas databazes F&A	6,628,318,339		8,495,788,591		13,461,202,895		13,461,202,895	
axhustimet totale	516,251,231	1.32%	287,300,843	0.67%	-1,378,625,836	-2.63%	-784,112,060	-1.50%
Provizioni për borxhin e keq si % e shitjeve	18.27%		20.39%		23.06%		24.19%	
AXHUSTUAR (pa TVSH)								
Faturimet e AXHUSTUARA (pa TVSH)	32,580,471,580		35,898,277,886		43,663,723,070		43,663,723,070	
Borxhi i KEQ i AXHUSTUAR (pa TVSH)	5,953,807,975		7,319,241,195		10,068,814,215		10,564,242,362	
Provizioni për borxhin e keq si % e shitjeve	18.27%		20.39%		23.06%		24.19%	

Metoda e pasqyrim të Bilancit

Metoda e pasqyrim të Bilancit vlerëson arkëtimet e ardhshme të llogarive të arkëtueshme të mbetura në fund të vitit duke u bazuar në përvojën e shkuar të arkëtimit, përvojën në çregjistrime dhe parashikimet. Llogaritjet mund të përmbliidhen në hapat e mëposhtëm:

- Hapi 1**

Ne përdorëm të njëjtat të dhëna si për metodën e Pasqyrës së të Ardhurave, ku duke u bazuar në arkëtimet egzistuese ne morëm informacion për trendin e arkëtimit duke u bazuar në tipin e klientit dhe zonën specifike (siç është shpjeguar në Hapin 1 dhe 2 në metodën e Pasqyrim të të Ardhurave).

- Hapi 2**

Duke përdorur formulën në vijim ne llogaritim norma për secilin interval moshe për llogaritë e arkëtueshme (0-30, 31-60, 61-90, 91-120, 121-180, 181-360, 360-720, 721 dhe më shumë ditë) për provizionimin e llogarive të arkëtueshme.

$$\% = \text{Të pa-arkëtueshme} / \text{Pjesa e mbetur për t'u mbledhur në çdo interval}$$

p.sh nëse norma e pa-arkëtueshmërisë për një tip të caktuar klienti është 25% dhe ne e dimë që duke u bazuar në të dhëna historike, zakonisht 46% mbliidhet brenda periudhës së afatit dhe 16% në 30 ditë pas afatit, atëherë borxhi i keq për llogaritë e arkëtueshme në kategorinë e moshës 1-30 ditë llogaritet si vijon =>

$$25\% / (1-46\%-16\%) = 66\%$$

- Hapi 3**

Ne gjeneruam një strukturë moshe nga databaza e Faturimit & Arkëtimit për llogaritë e arkëtueshme në fund të periudhës (31.12.2008, 31.12. 2009 dhe 31.12. 2010).

- Hapi 4**

Ne aplikuar normat e llogaritura në Hapin 2 ndaj strukturës së moshës së llogarive të arkëtueshme dhe llogaritim Borxhin e Keq në fund të periudhës.

- Hapi 5**

Ne pasqyruam ndikimin e axhustimeve respektive nga tabela e rakordimit ndaj llogarive të arkëtueshme dhe provizioneve.

- Hapi 6**

Duke krahasuar tepricat hapëse dhe mbyllëse të Borxhit të Keq, ne llogaritim impaktin ndaj pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve (shpenzimi për Borxhin e Keq). Kur u krahasua % e shpenzimit të Borxhit të Keq (llogaritur në Hapin 5) të Shitjeve, u vu re që kjo % është afërsisht e njëjta me % e llogaritur në metodën e Pasqyrës së të Ardhurave (Hapi 4).

Shënim: Duke qene se nuk ka patur çregjistrime të rëndësishme gjatë 2008 – 2010, ne nuk I përfshimë ato në llogaritje

Metoda e pasqyrimit të Bilancit – llogaritja e llogarive të arkëtueshme bruto

ALL	FY 2008	% mbi shitjet	FY 2009	% mbi shitjet	FY 2010 (bazuar mbi)	% mbi shitjet	FY 2010 (bazuar mbi)	% mbi shitjet
Llogari të arkëtueshme bruto								
sipas llogaritjeve të databazës F&A	17,370,568,228		27,663,295,163		40,225,965,811		40,225,965,811	
Axh 1 - Persona me aftësi të kufizuar 80%	505,453,554	2.80%	635,367,598	2.27%	742,752,851	1.85%	742,752,851	1.85%
Axh 2A - Rezultatet e grupit NTL								
Axh 2B - Ngjarje pas datës së bilancit (fatura të anuluar)					-1,724,220,336	-4.29%	-1,724,220,336	-4.29%
Axh 3 - Shitje të brendshme	-53,005,361	-0.29%	-93,739,849	-0.34%	-16,267,162	-0.04%	-16,267,162	-0.04%
Axh 4 - Fatura të anuluar	0	0.00%	49,649,138	0.18%	44,610,807	0.11%	44,610,807	0.11%
Axh 5 - Policia elektrike	0							
Axh 6 - Energjia reaktive	0	0.00%	19,105,189	0.07%	0	0.00%	0	0.00%
Axh 7 - Klientë pa kontratë	118,522,680	0.66%	0	0.00%	0	0.00%	0	0.00%
Axh 8 - Shitjet midis zonave	-16,759,470	-0.09%	-5,827,869	-0.02%	0	0.00%	0	0.00%
Axh 9 - KESH								
Axh 10 - Pagesa të pjesshme	-4,509,767	-0.03%	-17,705,737	-0.06%	-328,240,842	-0.82%	-328,240,842	-0.82%
Axh 11 - Arkëtime nga viti i kaluar	0		-88,951,495	-0.32%				
Axh 12 - Diferenca mes databazës F&A dhe raporteve nga sistemi i faturimit të CEZ	17,582,705	0.10%	-18,424,161	-0.07%	3,629,779	0.01%	3,629,779	0.01%
Axh 13 - Tarifa e lidhjes								
Axh 14 - Tarifa e shpërndarjes								
Axh 15 - Të dhëna nga Gjirokastra	99,197,020	0.55%	-86,915,144	-0.31%				
Axh 16 - Energjia e pafaturuar (2010)					1,638,980,000	4.07%	1,638,980,000	4.07%
Axh 17 - Pagesa që nuk janë identifikuar akoma	-6,940,655	-0.04%	-120,347,704	-0.43%	401,002,744	1.00%	359,411,821	0.89%
Axh 18 - Axhustime të tjera të vogla	0	0.00%			0	0.00%	0	0.00%
Axh 19 - Diferenca të tjera	3,074,665	0.02%	1,571,628	0.01%	-85,120,884	-0.21%	-85,120,884	-0.21%
totali i axhustimeve	662,615,371	3.67%	273,781,594	0.98%	677,126,956	1.68%	635,536,034	1.58%
Llogaritë të arkëtueshme të AXHUSTUARA	18,033,183,599		27,937,076,757		40,903,092,767		40,861,501,845	

Metoda e pasqyrimit të Bilancit – llogaritja e provizionit

	FY 2008	% mbi shitjet	FY 2009	% mbi shitjet	FY 2010 (bazuar mbi trendin e 2009)	% mbi shitjet	FY 2010 (bazuar mbi trendin e 2008)	% mbi shitjet
ALL								
Provizion								
sipas llogaritjeve të databazës F&A	13,208,097,304		22,826,862,382		36,095,800,079		36,095,800,079	
Axh 1 - Persona me aftësi të kufizuar 80%	505,453,554		635,367,598		742,752,851		742,752,851	
Axh 2A - Rezultatet e grupit NTL					0		0	
Axh 2B - Ngjarje pas datës së bilancit (fatura të anulhuara)					0		0	
Axh 3 - Shitje të brendshme	-40,303,803		-77,351,112		-14,596,945		-14,596,945	
Axh 4 - Fatura të anulhuara	0		40,968,874		40,030,432		40,030,432	
Axh 5 - Policia elektrike	0							
Axh 6 - Energjia reaktive	0		0		0		0	
Axh 7 - Klientë pa kontratë	90,121,352		0		0		0	
Axh 8 - Shitjet midis zonave	-12,743,435		-4,808,970		0		0	
Axh 9 - KESH								
Axh 10 - Paguesa të pjesshme	-4,509,767		-17,705,737		-328,240,842		-328,240,842	
Axh 11 - Arkëtime nga viti i kaluar	0		0		0		0	
Axh 12 - Diferenca mes databazës F&A dhe raporteve nga sistemi i faturimit të CEZ	17,582,705		-18,424,161		3,629,779		3,629,779	
Axh 13 - Tarifa e lidhjes								
Axh 14 - Tarifa e shpërndarjes								
Axh 15 - Të dhëna nga Gjirokastra	50,099,115		12,999,406					
Axh 16 - Energjia e pafaturuar (2010)					401,002,744		359,411,821	
Axh 17 - Paguesa që nuk janë identifikuar akoma	-6,940,655		-120,347,704		-437,542,566		-437,542,566	
Axh 18 - Axhustime të tjera të vogla	0				0		0	
Axh 19 - Diferenca të tjera	3,074,665		1,571,628		-85,120,884		-85,120,884	
totali i axhustimeve	601,833,730		452,269,822		321,914,567		280,323,645	
vlerësimet mbi arkëtimet bazuar në trendin e 2008/2009 (jo për 2008)								
provizion i AXHUSTUAR	13,809,931,034		22,867,355,519		34,702,527,434		35,048,448,763	

Metoda e pasqyrimit të Bilancit – Llogaritja e Borxhit të Keq

ALL	FY 2008	FY 2009	FY 2010 (bazuar mbi trendin e 2009)	FY 2010 (bazuar mbi trendin e 2008)
Llogaritë e arkëtueshme të AXHUSTUARA (bruto)	18,033,183,599	27,937,076,757	40,903,092,767	40,861,501,845
Provizioni i AXHUSTUAR	13,809,931,034	22,867,355,519	34,702,527,434	35,048,448,763
Llogaritë e arkëtueshme, neto	4,223,252,565	5,069,721,238	6,200,565,333	5,813,053,081
Teprica hapëse e provizionit (pa axhustimet)	6,577,574,756	13,809,931,034	22,867,355,519	22,867,355,519
Çregjistrimet	0	0	0	0
Ndryshimi në provizionin për vitin	7,232,356,277	9,057,424,485	11,835,171,915	12,181,093,245
Shitjet	39,096,565,896	43,077,933,463	52,396,467,684	52,396,467,684
Provizioni për borxhin e keq si % e shitjeve	18.50%	21.03%	22.59%	23.25%

Krahasimi i metodës së pasqyrimit të Bilancit me metodën e Pasqyrës së të Ardhurave

- **Arsyet kryesore për diferencat në llogaritjen e Borxhit të Keq mes metodës së Pasqyrës së të ardhurave dhe metodës së pasqyrimit të Bilancit janë si më poshtë:**
 - Pagesa të çrregullta nga klientë jo-buxhetorë ndikuan në shpërndarjen e periudhave të monitoruara, veçanërisht për periudhën 2008 dhe 2009, e cila pjesërisht futet në llogaritë e arkëtimeve të vlerësuara në periudhën për të cilat të dhënat nuk janë disponibël
 - Ne nuk kemi informacionin e detajuar për shpërndarjen gjatë vitit të axhustimeve të veçanta

ALL	FY 2008	FY 2009	FY 2010 (bazuar mbi trendin e 2009)	FY 2010 (bazuar mbi trendin e 2008)
Provizioni për borxhin e keq si % e shitjeve - Metoda e pasqyrës së të ardhurave	18.27%	20.39%	23.06%	24.19%
Provizioni për borxhin e keq si % e shitjeve - Metoda e pasqyrimit të bilancit	18.50%	21.03%	22.59%	23.25%
Diferenca	0.22%	0.64%	-0.47%	-0.95%

Konkluzion mbi llogaritjen e Borxhit të Keq

Për përcaktimin final të % së Borxhit të Keq ne propozojmë të përdorim mesataren e metodës së Pasqyrës së të Ardhurave dhe pasqyrimit të Bilancit

ALL	FY 2008	FY 2009	FY 2010 (*trendi i 2009)	FY 2010 (*trendi i 2008)
Provizioni për borxhin e keq si % e shitjeve - Metoda e pasqyrës së të ardhurave	18.27%	20.39%	23.06%	24.19%
Provizioni për borxhin e keq si % e shitjeve - Metoda e pasqyrimit të bilancit	18.50%	21.03%	22.59%	23.25%
Provizioni mesatar për borxhin e keq	18.39%	20.71%		23.27%

Shënim: * arkëtimet e vlerësuara për të ardhmen duke u bazuar në trendin 2008/2009

Shtojcat	Nr.
Deklarata Rregullatore	1
Manuali i kontabilitetit	2
Vështrim i përgjithshëm mbi sistemet e faturimit, arkëtimit dhe kontabilitetit	3
Trendi i arkëtueshmërisë	4
Borxhi i Keq sipas tipit të klientit	5
Personeli kryesor i Deloitte	6

DEKLARATA RREGULLATORE

1. Qellimi dhe afatet

1.1. Qellimi i përgjithshëm i Deklaratës Rregullatore

Miratimi i kësaj deklarate rregullatore synon të mundesoje llogaritjen e tarifave të prodhimit publik të zotëruar nga shteti, të furnizimit me shumicë, të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjise elektrike në përputhje me metodologjite përkatëse të miratuara nga ERE.

1.2. Periudhat e Rregullimit

ERE ka vendosur që periudha 1 Janar 2009 - 31 Dhjetor 2009 të jetë një periudhë tranzitore gjatë së cilës nuk do të ketë ndryshim në tarifën ekzistuese, të përcaktuara me Vendimin e saj Nr.21, datë 14 Shkurt 2008. Në këtë mënyrë do të jepet mundësia investitorit të vlerësojë situatën brenda OSSH¹ dhe të përgatitë aplikimin për rishikimin e ketyre tarifave të reja jo më vonë se 30 Shtator 2009. Tarifat e reja do të jenë efektive duke filluar nga data 01 Janar 2010.

Periudha e parë e rregullimit do të jetë 1 Janar – 31 Dhjetor 2010;

Periudha e dytë e rregullimit do të jetë 1 Janar - 31 Dhjetor 2011;

Periudha e tretë e rregullimit do të jetë 1 Janar 2012 – 31 Dhjetor 2014.

Periudhat vijuese të rregullimit do të jenë nga 3 deri në 5 vjet.

1.3. Programi i Tarifave

Në përputhje me afatet e përcaktuara më lart, deri më 30 Shtator 2009 DSO dhe FPP do të dorëzojnë aplikimin e tarifave për vitin kalendarik 2009 ("Aplikimi i Rishikimit të Tarifave për vitin 2009") dhe për periudhën e parë të

¹ Për qëllimin e kësaj Deklarate Rregullatore termi OSSH nënkupton Shoqërinë Akcionerë OSSH sh.a. të licensuar nga ERE për të kryer dy funksione: atë të operatorit të sistemit të shpërndarjes për operim, mirëmbajtje dhe zhvillimin e rrjetit (në tekstin e kësaj deklarate referuar si DSO) dhe funksionin e furnizimit publik me pakicë për klientët tariforë (në tekstin e kësaj deklarate referuar si FPP).

rregullimit 2010, në përputhje me metodologjite e tarifave të përkrahura në këtë Deklaratë Rregullatore të miratuar, si dhe në vendimet e mëposhtme të ERE-s:

Vendimi Nr. 18, datë 14.02.2008;

Vendimi Nr. 75, datë 26.06.2008;

Vendimi Nr. 19, datë 14.02.2008;

Vendimi Nr. 20, datë 14.02.2008;

Vendimi Nr. 21, datë 14.02.2008.

ERE do të rishikojë dhe miratojë tarifën për vitin 2009 sipas Aplikimit për Rishikimin e Tarifave për vitin 2009 ("Tarifat e Rishikuara për vitin 2009") jo më vonë se 15 Dhjetor 2009. Ndryshimet ndërmjet Tarifave të Rishikuara për vitin 2009 dhe tarifave të miratuara fillimisht sipas Vendimit Nr. 21, datë 14.02.2008, të shumezuar me sasine të energjise të parashikuara për t'u furnizuar gjatë gjithë vitit 2009 të vlerësuar nga OSSH në momentin e përgatitjes së aplikimit për rishikimin e tarifave për vitin 2009, do të shërbejë për të llogaritur shumën e të Ardhurave të Përcaktuara të OSSH në funksionin e saj si Furnizuesi Publik me Pakicë (FPP), objekt i Mekanizmit të Kompensimit, të përcaktuar në pikat 5.1 dhe 6 me poshtë.

Për vitet në vazhdim OSSH do të paraqesë aplikimin e saj për tarifë për një periudhë të dhënë rregullatore në rastin e DSO-së dhe për një vit të dhënë kalendarik në rastin e FPP-së, jo më vonë se 1 Shtatori i vitit kalendarik që paraprin atë periudhë rregullatore apo atë vit. ERE do të aprovojë këtë tarifë jo më vonë se data 7 Dhjetor i të njëjtit vit kalendarik; tarifën e aprovuar do të behen efektive në 1 Janar të vitit në vazhdim. Në mënyrë të pavarur nga aplikimet për rishikimin e tarifave, OSSH jo më vonë se 2 muaj pas Mbylljes së privatizimit, do të paraqesë një plan investimesh për vitet 2009 dhe 2010 ("Plani i investimeve 2009 dhe 2010"), i cili do të shqyrtohet dhe miratohet nga ERE jo më vonë se 2 muaj nga paraqitja e tij.

1.4. Miratimi i Deklaratave Rregullatore vijuese

Jo më vonë se 30 Qershor 2014, ERE do të miratojë një Deklaratë Rregullatore për periudhat e rregullimit që vijojnë pas vitit 2014, e cila nuk do të ndryshojë ndjeshëm në metodologji nga kjo Deklaratë Rregullatore. Për të menjanuar çdo dyshim, Deklarata Rregullatore e re do të vazhdojë të

permbaje Mekanizmin e Kompensimit, ashtu si pershkruhet ne piken 6 me poshte.

2. Per tarifen e prodhimit te energjise elektrike nga Shoqeria Publike e Prodhimit (PGC):

2.1 Percaktimi i Bazes se Aktiveve te Rregulluara (RAB) per Shoqerine Publike te Prodhimit per vitin 2009

Ne perputhje me metollogjine e llogaritjes se tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga PGC, RAB-i per vitin 2009 do te jete i barabarte me vleren kontabel te aktiveve afatgjata sipas bilancit te audituar te PGC sipas Standarteve Nderkombetare te Raportimit Financiar (IFRS) me 31 Dhjetor 2007, plus investimet e vena ne pune gjate vitit 2008, plus investimet e parashikuara nga shoqeria per vitin 2009 dhe te pranuar nga ERE, minus amortizimin per vitet 2008 dhe 2009, plus kapitalin e punes.

2.2 Percaktimi i Normes se Kthimit mbi Kapitalin e vet (RoE) per Shoqerine Publike te Prodhimit (PGC)

Per arsye se shoqeria publike e prodhimit te energjise elektrike do te mbetet prone e shtetit shqiptar, ajo do te kete nje profil risku financiar te ulet. Per me teper, Qeveria Shqiptare nuk kerkon kthime te larta mbi kapitalin e saj. Per rrjedhoje, Norma e Kthimit mbi Kapitalin e vet per shoqerine publike te prodhimit perben nje norme kthimi "jo te bazuar ne treg", qe percaktohet si norma e kthimit mbi Bonot e Thesarit afatshkurtra te emetura nga Banka Qendrore e Shqiperise.

2.3 Raporti i synuar i Borxhit (si perqindje e borxhit ndaj totalit te kapitalit) per Shoqerine Publike te Prodhimit

Per qellim te llogaritjes se tarifes se sherbimit te prodhimit te energjise elektrike, raporti i pranuar i Borxhit do te jete 60% borxh dhe 40% kapital.

2.4 Kapitali i Punes

Kapitali i Punes i lejuar do te jete i barabarte me 1/12 e Shpenzimeve Operative te lejuara per PGC sipas metodologjise perkatese te llogaritjes se tarifes.

3

2.5 Niveli vjetor i prodhimit publik me ane te burimeve hidrike

Prodhimi mesatar vjetor me burime hidrike per 10 vitet e kaluara (1999-2008) eshte 4,400 GWh, dhe per 5 vitet e kaluara (2004 – 2008) eshte 4,600 GWh. Meqenese KESH sh.a. perdor nivelin e prodhimit me hidro prej 4,200 GWh per te bere parashikimet vjetore, ka te ngjare qe prodhimi qe do te realizohet per 6 vitet e ardhshme (2009 – 2014) te tejkaloje me rreth 2,500 GWh prodhimin e parashikuar nga KESH, duke siguruar keshtu nje mundesi per minimizimin e riskut hidrologjik dhe mbajtjes relativisht te qendrueshme te tarifave te ardhshme te prodhimit te energjise elektrike. Niveli i pergjithshem vjetor i prodhimit te energjise elektrike nga burimet hidrike per kompanine publike te prodhimit te pranuar per periudhat rregullatore te percaktuara ne kete deklarate per qellim te llogaritjes se tarifes se shitjes me shumice nga FPSH tek FPP dhe OST, si dhe per qellim te aplikimit per rishikim te tarifave nga OSSH dhe aprovimin e tarifes nga ERE, eshte 4,200 GWh ne vit – prodhim neto.

3. Per Tarifen e Furnizimit me Shumice nga FPSH

3.1 Marzhi i Fitimit

- Per FPSH eshte i barabarte me 0.5% mbi blerjet vjetore te energjise elektrike.
- Me qellim qe te ulet risku i FPSH, per shkak te riskut hidrologjik qe shoqeron veprimtarine e Shoqerise Publike te Prodhimit, do te behen korrigjimet e meposhtme mbi baza vjetore:
 - (i) Pagesa per FPSH do te pershije gjithashtu cdo kosto financimi neto qe rrjedh prej riskut te permendur me lart;
 - (ii) Korrigjimin per te mbuluar koston e interesave per mbajtjen e nje linje kredie per te mbuluar kerkesen ne vitet e thata.
 - (iii) Nje korrigjim vjetor per nivelin e te ardhurave te teperta apo te munguara te vitit te meparshem te Shoqerise Publike te Prodhimit te shkaktuara nga ndryshimet ne prodhimin aktual vjetor me parashikimin vjetor neto prej 4,200 GWh .

FPSH do te kryejte nje tender mbi baza vjetore, ne perputhje me Ligjin Nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimet Publike", per blerjen e sasise se energjise elektrike te nevojshme, pervec sasise qe parashikohet per t'u blere nga Shoqeria Publike e Prodhimit.

4

4. Per Tarifen e Sherbimit te Shperndarjes se Energjise Elektrike

4.1 Percaktimi i Bazes se Aktiveve te Rregulluara (RAB) per DSO-ne.

Vlera e RAB-it per vitin 2009, qe do te perdoret ne Aplikimin per Rishikimin e Tarifave per 2009, do te llogaritet si shuma e :

- (i) Vleres kontabel te aktiveve afatgjate sipas bilancit te audituar sipas Standarteve Nderkombetare te Raportimit Financiar (IFRS) te DSO-se te 31 Dhjetorit 2007, te publikuar;
- (ii) Vleres se investimeve per vitin 2008, e cila do te njhet ne nivelin e jo me pak se 1,900 milion Lek;
- (iii) Vleren e investimeve te parashikuara per t'u realizuar gjate vitit 2009, sipas "Planit te Investimeve 2009 – 2010" te miratuar nga ERE sipas nenit 24 te Ligjit per Sektorin e Energjise Elektrike, te amenduar, dhe pikes 1.3, Programi i Tarifave, te kesaj Deklarate Rregullatore;
- (iv) Vleren e aseteteve te ndertuara nga KESH (te financuara ekskluzivisht nepermjet borxheve dhe/ ose kapitalit te vet te METEs) per OSSH-ne dhe te transferuara ne OSSH ne vitin 2009 ashtu si konfirmohet nga Vendimi i Keshillit te Ministrave.
- (v) minus amortizimin per vitin 2008 dhe 2009;
- (vi) Vleren e kapitalit te punes te lejuar te barabarte me 1/12 e Shpenzimeve Operative te lejuara te periudhes per te cilen aplikohet.

RAB-i per vitin 2009, i llogaritur si me siper, do te sherbeje si vlere fillestare ne aplikimin per rishikimin e tarifave per periudhen rregullatore 2010. Ky aplikim per tarife do te perfshije vleren e cdo aktivi te ndertuar nga KESH (te financuara ekskluzivisht nepermjet borxheve dhe/ ose kapitalit te vet te METEs) per OSSH-ne dhe te transferuara ne OSSH ne vitin 2010 ashtu si konfirmohet nga nje Vendim i Keshillit te Ministrave.

ERE nuk ka percaktuar nje vlere fillestare per RAB-in megjithate, si nivel fillestar i vleres se aktiveve afatgjate do te sherbeje vlere kontabel e aktiveve afatgjate sipas bilancit te audituar te DSO-se ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (IFRS) te 31 Dhjetorit 2007, e cila eshte 16,329 milion leke. Aktivet afatgjate te financuara nepermjet granteve do te perjashtohen nga RAB-i. Vlera e aktiveve afatgjate te financuara nepermjet granteve per vitin 2008 (sipas aplikimit te tarifave per vitin 2008) eshte 770 milion leke.

5

Per vitet e ardhshme, RAB-i do te percaktohet sipas formule se meposhtme:

$$RAB=A-CG-D+WC+INV$$

Ku:

RAB Baza e Aktiveve te Rregulluara ;

A vlere e njohur e aktiveve afatgjate ne sherbim dhe te dobishme ;

CG vlere e aktiveve te perftuara nepermjet granteve apo te ndertuara me burimet financiare te konsumatoreve te energjise elektrike;

D amortizimi i akumuluar nga periudhat e kaluara i aktiveve te perdorura per te kryer aktivitetin e licensuar;

WC kapitali i punes i lejuar, i cili do te jete i barabarte me 1/12 e Shpenzimeve Operative te lejuara te DSO-se;

INV shuma nominale mesatare kumulative e investimeve te parashikuara dhe e miratuar nga ERE, e cila do te investohet gjate periudhes se rregullimit.

4.2 Llogaritja e Kosos Mesatare te Ponderuar te Kapitalit (WACC) per DSO-ne

Per qellim te llogaritjes se tarifave te sherbimit te shperndarjes se energjise elektrike, WACC –u i lejuar nga ERE do te llogaritet mbi baza vjetore, sic pershkruhet ne Metodologjine e Llogaritjes se Tarifave se OSSH, te miratuar me Vendimin e Bordit te ERE-s Nr.79, date 26.06.2008 (Metodologjia e Tarifave) dhe ne kete Deklarate Rregullatore.

Norma e lejuar e Kthimit mbi Kapitalin e vet (ARoE) pas tatim fitimit eshte dhe do te llogaritet sipas formule se meposhtme (Modeli CAPM):

$$R_e = r_f + \beta \times (r_m - r_f)$$

Ku,

β – beta e kapitalit kovarianca ndermjet normes se kthimit ne tregun e kapitaleve dhe normes se kthimit te aksionit individual te nje shoqerie ne te njejten linje biznesi ($\beta=1$ do te thote qe tregu i kapitaleve dhe aksioni kane te njejten ecuri dhe per rrjedhoje risk te padiversifikueshem)

6

R_m	norma e kthimit te tregun te kapitaleve si nje i tere
$R_m - R_f$	premiumi i riskut te kapitalit te vet.
$R_{fr} + CRP$	norma e kthimit te letrave me vlere me risk zero duke pefshire dhe primin e riskut te vendit, i percaktuar nga kthimi mesatar mbi Bonot e Thesarit (sovereign bonds) me afat 6-mujor te qeverive me risk te krahasueshem me Shqiperine.

Norma e lejuar e kthimit mbi Kapitalin e vet para tatim fitimit per DSO-ne do te jete i barabarte me 16.44% per tre periudhat e para te rregullimit (deri me 31 Dhjetor, 2014). Me pas, ERE do te rishikoje vleren e ARoE-se ne perputhje me Metodologjine e Tarifave, kesaj Deklarate Rregullatore dhe kushteve perkatese te tregut. ERE do te ruaje qendrueshmeri ne parimet e veta dhe ne metodologjine e llogaritjes, sikurse dhe ne burimin e te dhenave qe perdor.

Tabela me poshte paraqet llogaritjen e koston se kapitalit te vet:

Komponentet		
Norma nominale e kthimit per letrat me vlere me risk zero plus primin per riskun e vendit	$R_f + CRP$	7.43%
ERP (primi i riskut te kapitalit te vet)	$R_m - R_f$	5.60%
Pergjindja e Borxhit (per Beten)	G	60.00%
Pergjindja e Borxhit (per strukturen e kapitalit Borxh/Kapitali i vet)	G	60.00%
Beta per Kapitalin e vet (investim pa borxh)	Beta(U)	0.56
Beta per Kapitalin e vet (investimi perfshin edhe borxh)	Beta(L)	1.32
Norma e Lejuar e Kthimit mbi Kapitalin e vet pas tatim fitimit	$ARoE = R_f + CRP + Beta(L) * ERP$	14.80%
Norma e tatim fitimit	T	10%
Norma e Lejuar e Kthimit mbi Kapitalin e vet para tatim fitimit	$ARoE \text{ para taksave} = ARoE / (1-T)$	16.44%

Per percaktimin e duhur te Normes se Kthimit mbi Kapitalin e vet pas tatim fitimit per DSO-ne, ERE do te mbeshtetet ne vleresimet e parametrevave kyq do te zbatohen ne metodologjine CAPM, te cilet do te sigurohen nepermjet burimeve publike te disponueshme dhe te besueshme, sic jane: *Bloomberg-*

per vleresimin e normes se kthimit per letrat me vlere me risk zero + primin e riskut te vendit dhe Beta-n per kapitalin e vet; *Ibbotson Associates-* per vleresimin e primit te riskut te kapitalit te vet. Ne mungese te publikimeve nga keto burime, ERE do te mbeshtetet ne nje vleresim te pavarur qe rrjedh nga nje burim me besueshmeri te krahasueshme.

Per sa i perket koston se borxhit te ri ne modelin e llogaritjes se WACC-ut, ERE do te perdore vleresimin me te fundit te koston mesatare te ponderuar te borxhit te ri te perfuar nepermjet procedurave transparente te tenderimit, si norme interesi per borxhet e reja sipas percaktimit me poshte.

OSSH do te zgjedhe bankat per te siguruar borxhin e ri ne perputhje me procedurat e tenderimit, qe do te propozohen nga vete ajo jo me vone se fundi i Shkurtit 2009. ERE do te miratoje keto procedura jo me vone se Mbyllja e privatizimit te OSSH -se. Keto procedura do te jene te drejta, transparente dhe ne perputhje me ligjet dhe praktikat me te mira. Keto procedura do te jene te vlefshme per periudhen kohore qe mbulon kjo Deklarate Rregullatore.

OSSH do te kete gjithashtu te drejten te marre borxh nga huadhenes nderkombetare, duke pefshire pa kufizim EBRD dhe IFC, ne rastin ne te cilin keto procedura tenderimi nuk do te jene te zbatueshme. Kosto e borxhit te ri te marre nga OSSH ne perputhje me keto procedura (ose sipas rastit, te marre nga huadhenes nderkombetare sipas fjalise me siper) do te jete plotesisht e transferueshme ne tarifen perkatese nepermjet modelit te llogaritjes se WACC-ut te shpjeguar ne kete seksion.

Ne rast se borxh i ri nuk eshte e mundur te perftohet nepermjet ketyre procedurave te tenderimit, dhe/apo nga institucionet financiare nderkombetare, aksioneret e OSSH-se mund te sigurojne, si burim te fundit, financim shtese per te siguruar mbarevajtjen e veprimtarise se OSSH-se. Kosto e ketij financimi do te jete e njejte me normen e lejuar te kthimit mbi kapitalin e vet (ARoE), te pershkruar me siper, dhe do te jete plotesisht e transferueshme ne tarifen e miratuar si komponent borxhi nepermjet modelit te llogaritjes se WACC, sic pershkruhet ne kete seksion. OSSH do te paraqese ne ERE fakte te arsyeshme qe tregojne se ajo ka bere perpjekjet me te mira per perfimin e financimeve te tilla nepermjet ketyre procedurave.

Borxhi i ri i marre nga OSSH ne perputhje me procedurat e pershkruara me lart (ose sipas rastit, te marre nga huadhenesit nderkombetare sipas fjalise me lart), dhe/apo nga financimi i aksionereve sipas paragrafit me lart, do te konsiderohet si borxh i ri ("Borxh i Ri").

Norma e interesit e pranuar per borxhin e vjeter eshte norma aktuale e interesit te aplikueshem sipas termave te marreveshjes se nen - huase

ndermjet KESH sh.a. dhe OSSH sh.a.. "Borxhi i Vjeter" i referohet borxhit te llogaritjes per DSO-ne ne perputhje me marreveshjen per shlyerjen e borxhit afat-gjate qe do te nenshkruhet ndermjet KESH sh.a. dhe OSSH sh.a. ("Mareveshja e Shlyerjes se Borxhit Afatgjate").

Kosto Mesatare e Ponderuar e Kapitalit (WACC) llogaritet si vijon:

$$\text{CoOD\%} * \text{OldL-T}/(\text{OldL-T} + \text{NewL-T}) = \text{Y1\%}$$

$$\text{CoND\%} * \text{NewL-T}/(\text{OldL-T} + \text{NewL-T}) = \text{Y2\%}$$

$$\text{WACC} = 40\% * \text{ARoE\% para taksave} + 60\% (\text{Y1\%} + \text{Y2\%})$$

Ku:

ARoE% para tatim fitimit	= Norma e Lejuar e Kthimit mbi Kapitalin para tatim fitimit
CoOD%	= Norma aktuale mesatare e ponderuar e interesit per Borxhin e Vjeter
CoND%	= Norma aktuale mesatare e ponderuar e interesit per Borxhin e Ri
OldL-T/(OldL-T + NewL-T)	= Pjesa e Borxhit te Vjeter ne totalin e Borxhit
NewL-T/(OldL-T + NewL-T)	= Pjesa e Borxhit te Ri ne totalin e borxhit
OldL-T	= borxhi i mbetur per t'u paguar nga OSSH sipas temave te Marreveshjes se Shlyerjes se huase afatgjate, ne vleren aktuale sipas bilancit te audituar te OSSH sipas IFRS-ve per vitin perpara vitit te aplikimit per tarife.
NewL-T	= borxhi i mbetur, me norme interesi, pervec atij qe mbart Borxhi i Vjeter, te marre nga OSSH, ne vleren aktuale sipas bilancit te audituar te OSSH sipas IFRS-ve per vitin perpara vitit te aplikimit per tarife.

4.3 Raporti i synuar i Borxhit per DSO-ne

Per qellim te llogaritjes se tarifave te sherbimit te shperndarjes se energjise elektrike, raporti i pranuar i borxhit do te jete 60%, sic tregohet ne formulen me siper.

4.4 Kapitali i Punes

Kapitali i Punes i lejuar do te jete i barabarte me 1/12 e Shpenzimeve Operative te DSO-se (shpenzimet operative te lejuara), sipas metodologjise se llogaritjes se tarifave te sherbimit te shperndarjes se energjise elektrike. Vetem per qellim te llogaritjes se Kapitalit te Punes, Shpenzimet Operative perfaqesojne koston operative vjetore te lejuara per DSO-ne qe te kryejte veprimtarine per te cilen eshte licensuar, duke perjashtuar amortizimin e aktiveve afatgjate dhe shpenzimet financiare. Shpenzimet qe lidhen me blerjen e energjise elektrike per te mbuluar humbjet ne rrjetin e shperndarjes perfsi te gjitha koston e aplikueshme te transmetimit jane gjithashtu pjese e Shpenzimeve Operative te lejuara.

Niveli i Shpenzimeve Operative i miratuar ne tarifet e vitit 2008 ishte 21,000 milion Leke per DSO-ne dhe 1,800 milion Leke per FPP.

Parashikimi me i fundit i Shpenzimeve Operative per vitin 2009 sipas aplikimit perkates per rishikim te tarifave (sidoqofte jo me i ulet se niveli i Shpenzimeve Operative per vitin 2008 i pershkruar me lart) do te sherbeje si baze per llogaritjen e Tarifave te Rishikuara per vitet 2009 dhe 2010. Parashikimi i koston se energjise per te mbuluar koston e humbjeve te DSO-se per pjesen e vitit 2009 qe mbetet pas Mbylljes se privatizimit dhe per vitin 2010 nuk do te marre parasysh efektin e ndonje korigjimi ne koston e vleresuar te DSO-se dhe/ose FPP, qe ka lidhje me vendimin e Qeverise No. 143, date 11.02.2009 (Per Nje Shtese ne Vendimin Nr. 338, Date 19.03.2008, te Keshillit te Ministrave, "Per Miratimin e Modelit te Tregut te Energjise Elektrike", Te Ndryshuar). Per te menjanuar cdo dyshim, shpenzimet qe lidhen me Auditimin e Humbjeve dhe Studimin e Humbjeve, Studimin e Nivelit te Borxhit te Keq dhe te Garancise e Pjesshme te Riskut (PRG) qe do te merret nga Banka Boterore, do te pranohen dhe njihen nga ERE si te arsyeshme per t'u perfshire ne Shpenzimet Operative.

4.5 Objektivat per uljen e humbjeve

Per vendosjen e objektivate te uljes se humbjeve ne shperndarje pergjate periudhave te rregullimit, per vitin 2008 do te supozohet nje nivel i pritshem i

humbjeve prej 32% te energjise se injektuar ne rrjetin e shperndarjes. Perqindja e humbjeve te energjise elektrike ne shperndarje do te kuptohet si diference ndermjet energjise qe injektohet ne rrjetin e shperndarjes dhe energjise se faturuar konsumatoreve tarife, e treguar si perqindje ndaj energjise se injektuar ne sistemin e shperndarjes

Deri me sot nuk eshte kryer ndonje studim i vecante per humbjet ne sistemin e shperndarjes, por per qellim te vendosjes se tarifave, sipas vleresimeve te OSSH-se, ERE pranon qe niveli total i humbjeve ne shperndarje (teknike dhe jo-teknike) te arrije ne 15 % ne fund te periudhes se trete te rregullimit (viti 2014), me supozimin qe niveli fillestar ne vitin 2008, per t'u konfirmuar nga Auditimi i Humbjeve sipas pershkrimit me poshte, eshte ne nivelin prej 32%.

ERE pret nje permiresim te shpejte ne nivelin e humbjeve jo – teknike, dhe nje ulje me te ngadalshme por te vazhdueshme te humbjeve teknike ne rrjetin e shperndarjes. ERE parashikon uljen e humbjeve totale ne sistemin e shperndarjes sipas skenarit ne vijim:

4% (pike perqindje) ulje per periudhen e pare te rregullimit;

4% (pike perqindje) ulje per periudhen e dyte te rregullimit;

9% (pike perqindje) ulje per periudhen e trete te rregullimit (3*3%).

Jo me vonese 31 Korrik 2009, DSO do te kryeje nje auditim te detajuar te humbjeve ("Auditimi i Humbjeve") per te percaktuar metodologjine per llogaritjen e humbjeve te pergjithshme dhe per te verifikuar nivelin aktual te humbjeve per vitin 2008 ("Humbjet Aktuale te vitit 2008").

Jo me vonese 31 Korrik 2010, DSO do te kryeje nje studim te detajuar per humbjet ("Studimi i Humbjeve") per te percaktuar humbjet teknike dhe jo teknike te realizuara per vitin 2009.

Auditimi i Humbjeve dhe Studimi i Humbjeve do te pergatiten nga nje ekspert teknik i pavarur qe do te zgjidhet nga lista e meposhtme:

- Arthur D.Little
- Deloitte
- Ernst & Young
- KPMG
- PricewaterhouseCoopers

Studimi i Humbjeve dhe Auditimi i Humbjeve do te miratohen nga ERE perkatesisht brenda 2 muajve dhe 1 muaji nga data e paraqitjes se tyre.

Humbjet Aktuale per vitin 2008 te verifikuara sipas Auditimit te Humbjeve do te sherbejne si baze per llogaritjen e Tarifave te Rishikuara per vitet 2009 dhe 2010. Ne te njejten kohe, niveli i Humbjeve Aktuale per vitin 2009 do te pranohet i barabarte me nivelin aktual te vitit 2008 dhe do te jete plotesisht i transferueshem ne tarifat e DSO-se ne perputhje me Mekanizmin e Kompensimit te pershkruar ne piken 6, dhe do te sherbeje si nivel fillestar per programin e uljes se humbjeve ne periudhat e percaktuara me sipër.²

Duke u bazuar ne Studimin e Humbjeve, DSO do te propozojte ne ERE programin e uljes se humbjeve totale per te tre periudhat e rregullimit te permdura me lart, te ndara ne vite, te shoqeruara me planin perkates te investimeve te nevojshme per uljen e humbjeve sipas ketij programi, nese skenari i propozuar nga ERE nuk eshte i pershtatshem. Per te menjanuar cdo dyshim niveli i humbjeve totale nuk mund te jete me i ulet se 15% ne fund te periudhes se trete rregullatore (2014).

Niveli i investimeve te nevojshme per uljen e humbjeve sipas programit te paraqitur nga DSO do te miratohet nga ERE ne perputhje me nenin 24 te Ligjit per Sektorin e Energjise Elektrike, te ndryshuar.

ERE eshte e vetedijshme qe DSO nuk duhet te perballtet me riskun qe rrjedh nga prokurimi i energjise elektrike ne tregun e hapur. Kosto e humbjeve te njohura per qellim te llogaritjes se tarifave se sherbimit te shperndarjes se energjise elektrike per vitin e ardhshem do te percaktohet si kosto mesatare e ponderuar e blerjes nje vit ne avancë të energjise nga DSO shumezuar me sasine e prishme te energjise elektrike te nevojshme per mbulimin e humbjeve.

Per te menjanuar cdo dyshim, OSSH cdo vit kalendarik do te shpalle tendera per blerjen e energjise elektrike ne perputhje me procedurat e tenderimit qe do te propozohen nga DSO, jo me vonese fundi i muajit Shkurt 2009, dhe do te miratohen nga ERE jo me vonese Mbyllja e privatizimit te OSSH. Keto procedura do te jene te drejta, transparente dhe ne perputhje me ligjet ne fuqi dhe praktiket me te mira. Keto procedura do te jene te vlefshme per periudhen qe do te jete e vlefshme kjo Deklarate Rregullatore. Kosto e humbjeve e percaktuar ne perputhje me keto procedura do te jete plotesisht e transferueshme ne tarifat e shperndarjes te miratuara per vitin pasardhes.

4.6. Faktori - X

4.6.1 Faktori X per tre periudhat e para te rregullimit do te jete zero,

4.6.2 ERE do te njohet cdo perfitim qe vjen si rezultat i uljes se shpenzimeve operative (perjashtuar humbjet) i cili do t'i lihet investitorit per nje

² (p.sh. nese Humbjet Aktuale te vitit 2009 jane 33%, niveli perfundimtar i humbjeve ne 31.12.2014 do te jete 16%.)

periudhe rregullimi. Korigjimi i Shpenzimeve Operative per periudhen pasardhese te rregullimit do te jete objekt rishikimi nga ERE.

5. Per Tarifen e Furnizuesit Publik me Pakice

5.1 Tarifa e Furnizuesit Publik me Pakice

Te Ardhurat e Kerkuara Furnizuesit Publik me Pakice (tarifa e konsumatoreve fundore) do te llogaritet duke u bazuar ne metodologjine e pershkruar me poshte, duke njohur gjithashtu sasine e te ardhurave te llogaritur per t'u kompensuar sipas mekanizmit te kompensimit te pershkruar ne Piken 6.:

$$RR_{act\ n} = (WPS_{tariff\ n} + OST_{tariff\ n}) \times V_n + DSO_{tariff\ n} \times V_{dn} + PSO_{costs\ n} + RPS_{costs\ n} - \Delta COMPB_n$$

Ku:

$$\Delta COMPB_n = RR_{cal\ n} - RR_{max\ n}$$

$$RR_{max\ n} = T_{act\ n-1} \times (1+g) \times (1+CPI_{n-1}) \times V_n$$

$$COMPB_n = COMPB_{n-1} + RoC_n + \Delta COMPB_n$$

$$RoC_n = [COMPB_{n-1} + \max(RR_{cal\ n} - RR_{max\ n}; 0)] \times WACC_Comp_n$$

$$nese \quad COMPB_{n-1} + RoC_n + \Delta COMPB_n \leq 0,$$

$$atehere \quad \Delta COMPB_n = -(COMPB_{n-1} + RoC_n)$$

Variablat e mesiperm percaktohen si vijon:

- $RR_{act\ n}$ – kerkesa aktuale per te ardhura e OSSH e njohur nga ERE ne vitin n, ne funksion te veprimtarise se shitjes me pakice qe ajo kryen
- $RR_{max\ n}$ – niveli i te ardhurave maksimale te OSSH te lejuar nga ERE ne vitin n, ne funksion te veprimtarise se shitjes me pakice qe ajo kryen, ne kuptimin e normes maksimale reale te rritjes se tarifave mesatare te FPP.
- $RR_{cal\ n}$ – kerkesa per te ardhura e OSSH e njohur ne funksion te veprimtarise se shitjes me pakice, sipas aplikimit per rishikim te tarifave (pa ndikimin e balances se kompensimit)

13

- $COMPB_n$ – gjendja e llogarise se kompensimit per fundin e vitit n. Per vitin 2008 kjo shume eshte e barabarte me zero.
- $\Delta COMPB_n$ – ndryshimi i gjendjes se akumuluar te llogarise se kompesimit – gjate vitit n.
- g – rritja vjetore mesatare e ponderuar e tarifave te konsumatoreve fundore ne terma reale (duke perjashtuar CPI) e pranuar nga ERE, g do te jete e barabarte me /ose me e larte se 15 %,per aq kohe sa ka akoma shuma pozitive te mbetura per tu kompesuar ne llogarine e kompesimit
- $|\Delta COMPB_n|$ – vlera absolute e $\Delta COMPB_n$ ne vitin n
- WACC_Comp_n – norma e lejuar e kthimit mbi balancen e llogarise se kompesimit – per vitin n; sipas Pikes 6 WACC_Comp_n do te jete e barabarte me Koston Mesatare te Ponderuar te Kapitalit (WACC) te llogaritur per DSO –ne per vitin n, sipas Pikes 4.2.
- RoC_n – kthimi i perftuar ne vitin n mbi balancen e llogarise se kompensimit
- $T_{act\ n}$ – tarifa mesatare totale e ponderuar per FPP e miratuar nga ERE ne vitin n
- V_n – sasia totale e energjise elektrike per konsumatoret tarife e pranuar nga ERE dhe OSSH per vitin n
- V_{dn} – sasia totale e shitjeve te energjise tek konsumatoret tarife te lidhur ne sistemin e shperdarjes ne vitin n, te pranuar nga ERE dhe OSSH per vitin n.
- CPI_n – Indeksi i Cmimeve te Konsumit i fund vitit ne vitin n i publikuar ne buletin e Institutit te Statistikes ne Shqiperi (INSTAT)³
- WPS_{tariff n} – Tarifa e kerkuar e furnizuesit publik me shumice te energjise elektrike e miratuar nga ERE ne vitin n

³ Per te menjanuar cdo dyshim, CPI ne vitin 2007 ishte 3.1% dhe ne vitin 2008 ishte 2.2% te publikuara nga INSTAT ne Dhjetor 2008.

14

OST _{tariff n}	– Tarifa e kerkuar e operatorit te sistemit te transmetimit te energjise elektrike e miratuar nga ERE ne vitin n
DSO _{tariff n}	– tarifa e sherbimit te shperndarjes se energjise elektrike e miratuar nga ERE ne vitin <u>n</u>
PSO _{costs n}	– kostot qe lidhen me detyrimet e sherbimit publik e miratuar nga ERE ne vitin n
RPS _{costs n}	– kostot e furnizuesit publik me pakice te miratuara nga ERE ne vitin n. Kjo kosto do te perfshije marzhin e fitimit ashtu si specifikohet ne piken 5.3 me poshte

Nese per ndonje arsye tarifa e FPP nuk do te jete me e rregulluar (sipas rastit, nese realizohet ndarja e veprimtarise se furnizimit me pakice nga ajo e shperndarjes se energjise elektrike), dhe gjendja e llogarise se kompensimit nuk eshte realizuar plotesisht tek te ardhurat e OSSH –se, atehere kjo shume e mbetur ne llogarine e kompensimit do te transferohet tek DSO dhe do te rimbursohet/shlyhet ne perputhje me metodologjine e pershkruar me lart nepermjet tarifes se DSO-se.

5.2 Borxhi i Keq

ERE eshte e vetedijshme se nje nivel i caktuar i borxhit te keq eshte pjese e pandare e biznesit te shitjes me pakice te energjise elektrike dhe si e tille duhet reflektuar ne tarifa. Borxhi i Keq i Lejuar do te llogaritet si nje perqindje mbi shumen e te ardhurave totale te OSSH ne funksionin e saj si FPP perfshire te gjitha perberesit e tarifave te FPSH (perfshire ate te prodhimit), te OST, DSO, PSO, FPP dhe pagesa te tjera sipas rastit duke perjashtuar tatimin mbi vleren e shtuar („Te Ardhurat e FPP“). Per vendosjen e objektivave per uljen e Borxhit te Keq (pergjate periudhave te rregullimit, do te pranohet per vitin 2008 nje nivel i Borxhit te Keq prej 14 % mbi te Ardhurat e FPP.

Per 2009 pranohet i njejti nivel i Borxhit te Keq me ate te vitit 2008 (si % ndaj te Ardhurave te FPP). Ne 2010, niveli i Borxhit te Keq (si % ndaj te Ardhurave te FPP) do te ulet me 1 pike perqindje krahasuar me nivelin e vitit 2009.

Deri me 31 Korrik 2011, OSSH, ne funksion te veprimtarise se shitjes me pakice qe ajo kryen, do te kryeje nje studim te detajuar per Borxhin e Keq (“Studimi mbi Borxhin e Keq”) per te percaktuar (i) metodologjine e llogaritjes se Borxhit te Keq dhe (ii) Nivelet Aktuale te Borxhit te Keq per 2008, 2009 dhe 2010 („Nivelet Aktuale

te Borxhit te keq per vitet 2008, 2009 dhe 2010⁴). Studimi mbi Borxhin e Keq do te pergatitet nga nje ekspert financiar i pavarur i zgjedhur nga lista e meposhtme:

- Deloitte
- Ernst & Young
- KPMG
- PricewaterhouseCoopers

Studimi mbi Borxhin e Keq do te miratohet nga ERE Brenda 2 muajve nga paraqitja e tij.

Gjithashtu, niveli aktual i Borxhit te Keq per vitin 2010 do te sherbeje si nje nivel fillestar per programin ne vazhdim te uljes se tij sipas pershkrimet me poshte ne rast se ai nuk eshte me i larte se niveli aktual i borxhit te keq te vitit 2009, permdrshye do te perdoret borxhi i keq aktual i vitit 2009.

1% (pike perqindje) ulje per vitin 2011;

1% (pike perqindje) ulje per vitin 2012;

1% (pike perqindje) ulje per vitin 2013.

1% (pike perqindje) ulje per vitin 2014.

Ne rast se Niveli Aktual i Borxhit te Keq per 2009 dhe/apo 2010 dhe/apo 2011⁴ eshte perkatesisht me i larte se 14 % dhe /apo 13% dhe/apo 12%, diferenca do te shtohet ne shumen e te ardhurave per t'u kompensuar sipas Pikes 6.

Ne rast se Niveli Aktual i Borxhit te Keq per 2009 dhe/apo 2010 dhe/apo 2011 eshte perkatesisht me i ulet se 14 % dhe /apo 13% dhe/apo 12%, diferenca do t'i zbritet shumen se te ardhurave per t'u kompensuar sipas Pikes 6.

5.3. Te tjera

- Tarifa e sherbimit te furnizimit me shumice do te jete kosto e transferueshme per Furnizuesin Publik me Pakice.
- Marzhi i Fitimit per Furnizuesin Publik me Pakice eshte i barabarte me 2.2 % mbi shpenzimet vjetore per blerjen e energjise elektrike nga FPSH-ja me cmime te rregulluara. Marzhi i Fitimit per FPP –ne bazohet vetem ne blerjet e energjise elektrike nga FPSH dhe nuk llogaritet bazuar ne kostot e

⁴ Niveli Aktual i Borxhit te Keq per vitin 2011 percaktohet si Niveli aktual i Borxhit te Keq per vitin 2010 minus 1 pike perqindje.

sherbimeve te transmetimit, shperndarjes apo atyre te sherbimeve ndihmese, madje as ne kostot qe lidhen me blerjen e energjise elektrike nga DSO –ja per mbulimin e humbjeve.

- Lidhur me strukturen e tarifave te konsumatoreve familjare, ERE ka filluar nje studim per percaktimin e nivelit minimal te konsumit mesatar mujor. ERE do te beje te mundur venien ne dispozicion te DSO-se se rezultateve te ketij studimi perpara se OSSH te pregatise aplikimin per rishikimin e tarifave, pra jo me vonese se 30 Qershor, 2009. Rezultatet e ketij studimi do te perdoren per rishikimin e nivelit te konsumit per konsumatore familjare, ne aplikimin per rishikimin e tarifave qe do te hyjne ne fuqi me 01 Janar, 2010.
- Tarifa e FPP-se per konsumatore tarifore do te perfshije nje korrigjim per te kompensuar FPP-ne per ndryshimet ndermjet te ardhurave te parashikuara dhe atyre te realizuara si rezultat i ndryshimeve ne kerkesen e parashikuuar per cdo kategori te konsumatoreve, kur keto te fundit jane te krijuar rishitase ose kur ka ndryshime ne tarifat, te cilat nuk jane ne te njejtin proporcion tek te gjitha kategorite e konsumatoreve.

6. Mekanizmi i Kompensimit per Tarifen e Sherbimit te Shperndarjes dhe te Shitjes me Pakice te Energjise Elektrike

Ne rast se ERE nuk lejon ne tarife nje pjese te te Ardhurave te Kerkuara te njohura per DSO-ne dhe FPP-ne, te llogaritura sipas metodologjive perkatese te miratuara nga Bordi i Komisionereve te EREs me vendimet Nr. 79 dhe 80 te dates 26.06.2008, atehere kjo pjese e te ardhurave do te jete objekt i mekanizmit te kompensimit te pershkruar me poshte ashtu si eshte percaktuar ne piken 5.1.

Ne rast se kerkesa per te ardhura e OSSH-se ne funksionin e saj si FPP per nje vit te dhene rezulton me nje rritje te tarifes totale mesatare te ponderuar per konsumatore tarifore (shuma e te ardhurave te kerkuara te OSSH-se ne funksionin e saj si FPP pjestuar me volumin vjetor te parashikuuar te shitjeve ne nje vit te dhene) me te larte se 15 % ne terma reale (mbi CPI)⁵, atehere rritja minimale e tarifes mesatare e njohur nga ERE do te jete 15 % ne terma reale. Per te menjanuar cdo dyshim, kjo tarife do te sjelle rritjen minimale ne te ardhurat e kerkuara te OSSH-se ne funksionin e saj si FPP prej 15 % ne terma reale.

Nese rritja e kerkuar e tarifes fundore totale mesatare te ponderuar per vitin e ardhshem (perpara aplikimit te ndonje sasie te ardhurash per tu kompensuar me mekanizmin e kompensimit) eshte me e ulet se 15 % ne terma reale, ERE do te miratoje nje rritje te tille dhe nuk do te rrise shumen e te ardhurave per

t'u kompensuar. Per me teper, nese ka gjendje te mbetur ne llogarine e kompesimit, ERE do te rrise tarifen mesatare te ponderuar te konsumatoreve fundore ne nivelin e duhur per te bere zero llogarine e kompesimit, mjaft qe kjo rritje tarife nuk eshte me e madhe 15 % ne terma reale, sipas formuleve ne piken 5.1. me siper. Cdo pjese e mbetur ne llogarine e kompensimit do te mbarret per vitin tjetër.

Pjesa e te ardhurave qe nuk eshte marre parasysht ne llogaritjen e tarifes, do te perbeje llogarine e kompensimit qe nga viti kur kjo ndodh deri ne vitin (duke perfshire edhe kete vit) kur kjo sasi kompensohet plotesisht sipas formuleve se pershkruar ne Piken 5.1. Gjate periudhes se kompensimit OSSH ka te drejte te fitoje kthimin e rregulluar mbi kete shume – objekt i mekanizmit te kompensimit. Norma e lejuar e kthimit per t'u perftuar mbi shumen e kompensimit do te jete e barabarte me Koston Mesatare te Ponderuar te Kapitalit (WACC) te llogaritur per DSO-ne, sipas pikes 4.2, per vitin paraardhës te vitit kur behet aplikimi per tarife.

Mekanizmi i kompensimit do te zbatohet pergjate periudhes qe mbulon kjo Deklarate Rregullatore dhe do te ruhet gjithashtu per periudhat e ardhshme te rregullimit.

Ndryshimi ne kerkesen e pergjithshme per te ardhura qe rrjedh nga ndryshimi i tarifave te miratuara per vitin 2009 sipas Vendimit Nr. 21, date 14.02.2008 dhe tarifave sipas "Aplikimit per Rishikimin e Tarifave per 2009", do te jete objekt i Mekanizmit te Kompensimit.

Ne rast se humbjet aktuale per vitin 2008 jane me te larta se sa niveli i supozuar prej 32 %, dhe per rrjedhoje Humbjet Aktuale per vitin 2009 jane gjithashtu me te larta se 32%, atehere ndryshimi ndermjet kerkeses per te ardhura te llogaritur sipas programit te ri te uljes se humbjeve dhe kerkeses per te ardhura te llogaritur sipas programit fillestar te uljes se humbjeve (bazuar ne nivelin e pranuar te humbjeve prej 32%), sic pershkruhet ne kete dokument, do te jete gjithashtu objekt i mekanizmit te kompensimit.

Ne rast se Niveli Aktual i Borxhit te Keq per 2009 dhe/apo per 2010 dhe/apo Niveli aktual i Borxhit te Keq per 2011 eshte perkatesisht me i larte se 14 % , 13 % dhe/ apo 12% atehere ndryshimi ndermjet kerkeses per te ardhura te llogaritur sipas programit te ri te uljes se Borxhit te Keq dhe kerkeses per te ardhura te llogaritur sipas programit fillestar te uljes se Borxhit te Keq (bazuar ne nivelin e Borxhit te Keq perkatesisht 14 %, 13 % dhe 12%), si pershkruhet ne kete dokument, do te jete gjithashtu objekt i mekanizmit te kompensimit.

⁵ Rritja ne terma reale do te llogaritet duke perdorur formulen $(1+g) \times (1+CPI_{t-1})$

7. Cilesia e Sherbimit te Furnizimit me Energji Elektrike

- ERE ka percaktuar vetem dy tregues te cilesise se sherbimit derisa te pergatiten standartet per cilesine e sherbimit:
 - Nderprerjet e furnizimit me energji elektrike (shpeshtesia dhe kohezgjatja) qe do te kryhen nga DSO-ja ne raste riparimesh dhe remontesh. DSO-ja duhet t'i paraqese ERE-se programin e remonteve mbi baza vjetore.
 - Saktesia e faturimit 99 %. Saktesia e faturimit eshte kritike per te reduktuar humbjet dhe per te qene te drejte ndaj konsumatoreve. Per me teper ERE-ja dhe DSO-ja/FPP-ja, duhet te punojne se bashku per te vendosur rregulla per shpeshtesine e leximit te matesave dhe se si do te ndahet konsumi i energjise elektrike per cdo muaj ne rastet kur nje mates lexohet me rralle se nje here ne muaj.

Standartet per cilesine e sherbimit te furnizimit do t'i propozohen ERE-s nga investitori ne bashkepunim me te licensuar te tjere. Standartet do trajtojne cilesine dhe gjithashtu edhe sigurine e furnizimit me energji elektrike. ERE parashikon qe ky proces te zgjase rreth 1 vit per FPP dhe DSO, derisa ata te analizojne sistemin, te zhvillojne nivelet e krahasimit per cdo standart te cilesise dhe sigurise se furnizimit, dhe te zhvillojne programet per te arritur keto objektiva.

8. Dispozita perfundimtare

Sikurse ne te gjitha dokumentat zyrtare te miratuara nga ERE, versioni shqip i ketij dokumenti eshte versioni zyrtar.

Ne rastin e ndonje mosperuthjeje ndermjet Deklarates Rregullatore dhe ndonje vendimi tjetër te ERE-s, kjo Deklarate Rregullatore do te prevaloje.

9. Miratimi

Kjo Deklarate Rregullatore u miratua nga Bordi i Komisionereve me Vendimin Nr. 12, date 03.03.2009.

Miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionereve Nr. 76, datë 26.06.2008

**MANUALI I KONTABILITETIT PËR QËLLIME TË RREGULLIT TË KOMPANIVE
TË LICENSUARA NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Qershor 2008

Pregatitur nga : Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike

Autoriteti

“Sistemi Uniform i Llogarive” për Kompaninë e e licencuara është hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 21 ,23 të Ligjit Nr.9072, datë 23.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të amenduar, si dhe kërkesave të Standartëve Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit

Qëllimi :

Sistemi Uniform i Llogarive do të ofrojë rregullat për mbajtjen e llogarive të ndara nga kompanitë e licencuara në sektorin e energjisë elektrike, përfshirë llogaritë e aktiveve, kapitalit, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, për qëllim të llogaritjes së omimeve dhe tarifave, sipas metodologjive përcaktuara, si dhe për qëllime të monitorimit të veprimtarisë së tyre.

Zbatueshmëria e Sistemit Uniform të Llogarive

Sistemi i kontabilitetit i specifikuar në Sistemin Uniform të Llogarive do të jetë i zbatueshem për të gjitha Shoqëritë e licencuara të sektorit të energjisë elektrike, të cilat janë të detyruara të plotësojnë kërkesat rregullatore për mbajtjen e llogarive në përputhje me Ligjin e sipërcituar të Sektorit të Energjisë Elektrike.

I UDHEZIME

A. Udhezime të Përgjithshme

1. Periudha Kontabel

Kompanitë e licencuara do të mbajnë llogaritë mbi baza mujore, kështu që të gjitha transaksionet e realizuara për secilin muaj do të regjistrohen në librat e tyre për atë muaj. Sasitë e transaksioneve sipas veprimtarisë të kompanive të licencuara do të regjistrohen edo muaj të ndara sipas veprimtarisë që kryejnë. Kompanitë e licencuara do të mbyllin llogaritë e mbajtura për qëllime rregullatore në fund të edo viti kalendrik, deri në një udhëzimin për të vepruar ndryshe nga ERE.

2. Regjistrimet Kontabel

a) Kompanitë e licencuara do të regjistrojnë në librat e tyre llogaritë dhe do të ruajnë të gjithë dokumentacionin justifikues (mbështetës) të regjistrimeve të llogarive, me qëllim që të mundësojnë në çdo rast kontrollin për edo regjistrim në librin e kontabilitetit. Edo

1

regjistrim do te mbeshitet nga informacion i detajuar, me qellim qe te lejoje identifikimin te shpejte, analiza dhe verifikim per cdo transakcion te kryer.

- b) Kompanite e licencuara do te ruajne librat e kontabilitetit per nje periudhe 10 vjecare
- c) Kompanite e licencuara mund te mbajne gjithashtu dhe dokumenta te regjistrimit te pershkruara ne Sistemin Uniform te Llogarive per llogari te perkohshme, si dhe per nen ndarje te llogarive te pershkruara ne Sistemin Uniform te Llogarive, me qellim qe te sigurohet integriteti i informacionit, dhe mos cenimi i tij i cili eshte shume i rëndësishem per qellime rregullatore
- d) Organizimi i llogarive ne sistemin Uniform te Llogarive do te shërbeje si bazim te dhenash per te plotesuar formatin e raportimeve te hartuar nga ERE

B Politika te Kontabilitetit per qellime Rregullatore

1. Financat

Fondet e kompanive te licencuara do te klasifikohen si Fonde qe lidhen me Aktivet ose si Fonde qe lidhen me te Ardhuarat.

Fondet qe lidhen me aktivet e kompanive jane buçimet e transferuara kompanive me kushtin qe kjo e fundit do t'i perdoze per te blere, ndertuar ose marre ne pronesi aktive fikse. Kushte te tjera shpesh mund te perfshihen lidhur me vend ndodhjen e aktiveve ose me periudhat gjate te cilave keto aktive do te merren ne pronesi apo do te perdozen.

Fondet, te cilat nuk jane te lidhura me Aktivet, do te konsiderohen si fonde te lidhura me te Ardhuarat.

Fondet e lidhura me Aktivet do te pasqyrohen ne bilanc si te ardhura te pritshme per t'u arketuar, te cilat do te njihen si te ardhura ne perputhje me nje sistem racional dhe te vazhdueshem qe do te zbatohet per periudhen e jetegjatesise se aktivitetit (useful life of the asset). Ne kete menyre, ardhura nga fondet qe lidhen me aktivet eshte alokuar se bashku me amortizimin e aktivitetit te blere /perftuar.

Fondet qe lidhen me te Ardhuarat do te pasqyrohen si detyrime/huamarije ne llogarite e te ardhurave, nen emertimin e pergjithshem "Te ardhura te tjera financiare".

Te gjitha fondet jane pershkruar te ndara ne anekset e Pasqyrave financiare te kompanise.

Aktivitet e ndertuara per qellime te lidhjes se nje Konsumentit ne zryt dhe i cili eshte paguar plotesisht nga Konsumentit, do te trajtohen si fonde qe lidhen me aktivet. Ato do te regjistrohen dhe pasqyrohen ne llogari te vecanta

C Kategorite dhe struktura e aktiveve

Nje aktiv do te konsiderohet qarikullues kur:

- 1. Pritet te realizohet shitja ose mbahet per qellime shitjeje ose perdorimi ne ciklin operimit normal te kompanise;

- 2. Mbahet kryesisht per qellime komerciale per nje periudhe te shkurter kohe dhe pritet te realizohet brenda nje periudhe 12 muajore nga dita e pasqyres se bilancit; ose
- 3. Aktivi ne fjale eshte ne para apo ekuivalente te parase per te cilat nuk ka kufizime per sa i perket perdorimit te tyre.

Te gjitha aktivet e tjera do te klasifikohen si jo qarikulluese.

Aktivitet qarikulluese perfshijne inventarin dhe kerkesa te arketueshmet per mallrat dhe sherbimet qe jane shitur, perdorur apo realizuar si pjese e ciklit normal te operimit te ndermarrjes, edhe ne raste kur nuk pritet qe aktivet ne fjale te realizohen brenda 12 muajve te ardhshem nga dita e pasqyres se Bilancit financiar. Letrat me vlera te tregueshme do te përkufizohen si aktive korrente nese pritet qe letrat me vlera ne fjale do te realizohen brenda 12 muajve te ardhshem nga dita e pasqyres se Bilancit financiar; ne te kundert, ato do te konsiderohen si aktive te qendrueshme

1. Aktivitet e Mbjajnura per Perdorim ne te Ardhen

Aktivitet e mbajtura per perdorim te ardhshem eshte sasia (ne vlera monetare) e aktiveve qe nuk perdozen aktualisht nga i Licencuari per kryesjen e sherbimit. Ne parim aktivet qe klasifikohen ne kete kategori jane toka, dhe te drejtat e ndertimit te kerkuara nga i licencuari. Aspektet kohor i blerjes luon nje rol te rëndësishem kur merret vendimi nese nje prone mund te klasifikohet si aktivitet i mbajtur per perdorim te ardhshem. Aktivitet qe mbahen per perdorim ne te ardhmen, do te perfshihen ne Bazen e Aktiveve te Rregulluara vetem me miratimin e Rregullatorit.

2. Inventaret

a. Kosto e Inventareve

Perkufizime:

Vlera neto e e realizueshme eshte cmimi i vleresuar shites ne rrethelben normale te njesise ekonomike raportuese minus koston e vleresuar te kompletimit dhe koston e nevojshme per te realizuar shitjen.

Kosto e inventarit perfqeson shumen e te gjitha shpenzimeve qe kane lidhje me blerjen dhe perpunimin, se bashku me shpenzimet e tjera te kryera ne lidhje me dergimin e tyre ne piken e destinacionit dhe gjendjen e tyre.

Kosto e blerjes se inventarit perfshin shumen e cmimit te blerjes, taksave doganore te importit dhe taksat e tjera (ndryshe nga ato te cilat ndermarrja mund ti rimarri me vone nga autoritetet doganore), koston e transportit dhe te tjera kosto qe mund tu ngarkohen direkt (blerjes) perfundim te mallrave, materialleve dhe sherbimeve.

Zbritjet (skontot) tregtare dhe komponentet e tjere te ngjashem do te zbriten gjate llogaritjes se cmimit te blerjes.

i. Metodot:

Kosto e atyre mallrave që nuk janë të këmbëshme në tregje të zakonshme apo që janë të vecanta për projekte specifike, kostoja duhet të përcaktohet mbi bazën e metodës së identifikimit specifike.

Metoda e identifikimit specifik, do të thotë që kosto të vecanta tu atribuohen njëjete të caktuara (identifikuara) të inventarit. Ky është një trajtim i përshtrahshëm për njëjete të inventarit që janë alokuar në një projekt të caktuar, parazisiht nëse këto njëji janë prodhuar apo blerë. Megjithatë, identifikimi specifik i kostove është i pa përshtrahshëm kur behet fjale për një numër të madh të njëjete të inventarit, të cilat janë zakonisht të ngjashme mes tyre (mund të shërbejnë zëvendësues të njëri-tjetrit). Në rrethanat të tilla, duhet të përdoret metoda e zgjedhjes së atyre njëjete që ngelen në inventare për të përfunduar efektet e pritshme mbi fitimin/humbjen neto të vitit.

Kosto e inventareve, përfesë e atyre që kanë të bëjnë me paragrafin e mësipërm, duhet të alokohet duke përdorur formulat e kostos mesatare të ponderuar. Sipas formulës së kostos mesatare të ponderuar, kosto e odë njëjete të inventarit përcaktohet nga mesatarja e ponderuar e kostos së njëjete të ngjashme në fillim të periudhës dhe mesatarja e ponderuar e kostos së njëjete të ngjashme të blera/prodhura gjatë periudhës. Në varesi të rrethanave të kompanisë, kosto mesatare mund të llogaritet periodikisht, ose sipas odë dergese të marrë.

Kosto e inventareve mund të mos jete e këmbëshme nëse inventari është i demtuar, nëse inventari është tërësisht apo pjesërisht jashtë përdorimit, ose nëse emimi i tyre i shitjes është shumë i ulët. Kosto e inventareve gjithashtu mund të mos këmbëhet nëse koston e vlerësuar të kompletimit (të cilit të prodhimt të realizuar) apo koston e vlerësuar për realizimin e shitjeve janë zminur. Kosto e rregulluar e inventareve nuk mund të jete më e lartë se sa vlera neto të realizueshme e tyre.

Inventari zakonisht rregullohet bazuar në vlerën neto të realizueshme njëji për njëji. Megjithatë, në disa rrethanat, mund të jete e këmbëshme grupimi i njëjete ngjashme, apo njëjete që kanë lidhje me njëra tjetër. Ky mund të jete rasti kur njëjete të inventarit që lidhen me të njëjten linjë produkti apo kanë qëllime të njëjta përdorimi, janë prodhuar dhe shitur në të njëjten zonë gjeografike. Nuk është e përshtrahshme rregullimi i atyre njëjete të inventareve bazuar në klasifikimin e inventarit, por: mallrat, ose të gjithë inventaret në një industri të vecantë apo në një segment gjeografik të vecantë. Si rregull, kompanitë e shërbimeve akumulojnë koston, në përputhje që odë shërbimi, ti aplikohet një emim shitjeje të vecantë. Kjo është arsyeja se pse odë shërbimi trajtohet si njëji të vecantë.

3. Shpenzimet e shlyra sipas klasifikimit të Rregullatorit

Për qëllime të vendosjes së çmimit/tarifave Rregullatori mund t'u kërkojë të Licencuarve të trajtojnë (regjistrojnë dhe raportojnë) disa kategori të shpenzimeve në një mënyrë të tillë që ndryshon nga praktika e zakonshme kontabel. Në këtë rast shpenzime të tilla do të regjistrohen dhe raportohen si shpenzime të shlyra rregullatore (të vendosura në llogari të vecanta) dhe do të amortizohen / regjistrohen gjatë një periudhe të caktuar kohë. (Keto kategori specifike të llogarive të shpenzimeve zakonisht përshtrahen nga Baza e Rregulluar). Shembuj të shpenzimeve të tilla janë, shpenzime të caktuara studimi/kërkimi dhe humbje që lidhen me situata rastesore për atyre të rrethanave të pa parashikuara si, shtabite, përmblytjet, etj. Në parim shpenzimet e shlyra rregullatore janë të parakohshme ose ndodhin vetëm një herë.

4. Testi i Aktivit të përdorshëm dhe i Dobishëm. Testi i Investimeve të Kujdesshme.

Të licencuarit kanë detyrimin që të sigurojnë se vetëm aktivet e përdorshëm, dhe të blerë në mënyrë të arsyeshme, janë përfitshme në Bazën e Aktivëve të Rregulluar. Rregullatori ka të drejtën të përcaktojë nëse është vënë në përdorim një asset, për odë periudhe ka qënë ai i dobishëm dhe nëse ka qënë i dobishëm për sigurimin e shërbimit për të cilin është ndërtuar. Nëse provohet që,

aktivit nuk kënaq kërkesat, Rregullatori mund të vendosë të përshtrahet atë (plotësisht apo pjesërisht) nga Baza e Aktivëve të Rregulluar. Kjo kërkesë vendoset, me qëllim që të diferencohet grupi i aktivëve të nevojshme për realizimin e aktivitetëve, nga kapacitetet e teperta, dhe për t'ridhjetje të plotësoje standartet e investimeve të kujdesshme/arsyeshme.

Testi i Aktivit të Përdorshëm dhe i Dobishëm & Testi i Investimeve të Kujdesshme, përdoren për të përcaktuar nëse i licencuari ka blerë apo ndërtuar me përgjegjësi dhe rigorozitet një asset të caktuar bazuar në rrethanat dhe informacionin e kohës që është marrë vendimi për realizimin e investimit. Nëse aktivit nuk e kalon kërkesat e testit, Rregullatori mund të vendosë të përshtrahet atë (plotësisht ose pjesërisht) nga Baza e Aktivëve të Rregulluar.

D Vlerësimet Kontabel për qëllime Rregullatore

5. Vlerësimi i Aktivëve për qëllime të vendosjes së çmimit / tarifave.

Baza e Aktivëve në parim përfaqëson vlerën e aktivëve të përdorura nga kompania energjetike për sigurimin e shërbimit peskates. Të licencuarve u jepet mundësia të marrin një normë fitimi të caktuar (e vendosur nga komisioni rregullator) mbi bazën e emimit.

Aktivët e trapezuar do të raportohen me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe vlerën e zhvlerësimit / demtimit të tyre, ndërsa toka dhe ndërtesat me vlerën e emuar drejtësisht.

Baza e emimit mund të llogaritet nëpërmjet një ose disa kombinimeve të standartëve të kontabilitetit në vijim: kosto historike, vlera e tregut, kosto e riprodhimit, ose investimit të kujdesshëm. Sipas Sistemit të Njëjete të Llogarive, kompanitë e licencuara do të zbatojnë metodën e miratuar nga ERE për vlerësimin e aktivëve të tyre. Të licencuarit do të propozojnë plane Rregullatorit metodën e vlerësimit që do të përdoret për odë aktiv. Vlerësimet e aktivëve bazuar në koston historike të tyre do të konsiderohen përgjithësisht të pranueshme nga Rregullatori. Aty ku vlerësimet e aktivëve janë bazuar në koston e zëvendësimit apo të Vlerës së Tregut, ajo pjesë të vlerës mbi koston historike, nëse diktohet nga Rregullatori, mund të jete subjekt amortizimi mbi një bazë kohore të ndryshme nga ajo e përdorur për vlerën historike të aktivit.

6. Amortizimi dhe Jetegjatesia e Aktivëve Afatgjatë Materiale

Amortizimi dhe jeta e dobishme e Aktivëve Afatgjatë Materiale rregullohet nga Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS) dhe vecanësisht të adresuara në IAS 16, ku jepen përfundimet në vijim:

Amortizimi është shpenzimi i sistematike e vlerës së amortizueshme të Aktivit Afatgjatë përgjatë jetës së tij të dobishme.

Vlera e amortizueshme është kostoja e një Aktivit, ose një vlerë tjetër që zëvendëson koston, minus vlerën e rikuperueshme të aktivit.

Jeta e dobishme është

- (a) Periudha e kohës gjatë të cilës një aktiv përdoret nga kompania; ose
- (b) Numri i produkteve (ose njësi të ngjashme) që përdoret përfaqësojnë kompaninë nga periudha e aktivitetit.

Kosto Historike (numri i blerjes) është shuma e parave ose ekuivalenteve të parave të paguara ose vlerë të drejtë të aseteve të tjera, të dhëna për të blerë një aktiv në kohën e blerjes apo të prodhimit të tij.

Vlera e Rikuperueshme është shuma e vlerësuar që njësi pret të përfitojë nga një aktiv në fund të jetës së dobishme, pas zbritjes së kostos së amvizimit nga periudha.

Vlera e Drejtë është shuma, me të cilën mund të shkëmbehet një aktiv ndërmjet paleve të mirëinformuara, të vullnetshme dhe të palidhura me njëra tjetrën.

Humbja nga Zhvlerësimi është shuma, me të cilën vlera kontabel e një aktivi të rregulluar shpesh e tij të rikuperueshme. Cila përfaqëson vlerën e aktuale neto të fitimeve të parave, të shprehur me një normë interesi të tregut të aplikueshme për klientin të ngjashëm.

Vlera kontabel neto është shuma, me të cilën një aktiv njihet në bilancë (pas zbritjes së amortizimit të akumuluar dhe humbjet e muadshme nga zhvlerësimi).

IAS 16 jep gjithashtu disa rekomandime mbi përcaktimin e vendodhjes së pronës: "statutit të pronës dhe vlerësimin e jetës së dobishme të aktivitetit.

Vlerësimi i jetës së dobishme të aktivitetit:

- a) Disa elemente të pasurisë, impianti (plant) dhe pajisjet duhen rishikuar në intervale të caktuara. Këta elemente (komponente) do të llogariten për aktive të vecanta sepse ata kanë jetë të dobishme të ndryshme nga ato të elementeve të pronësive, impiantit dhe pajisjeve të cilëve ato ju përkatën. Për shkak të kësaj, nëse përbushen kushtet e njohjes, shpenzimet që behen për rishikimin ose rinovimin e elementit llogariten si rishikim ose blerje e një aktivi të ri dhe aktiviteti rishikohet rregullisht;
- b) Shuma e amortizuar e një elementi të pasurisë, impiantit dhe pajisjeve do të shprehë mbi bazë sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Metoda e perdorur e amortizimit do të reflektojë modelin me të cilin perfizimi ekonomik i ardhshëm nga aktiviteti do të realizohet nga kompania. Pjesa e amortizimit për çdo periudhë do të njihet si shpenzim.
- c) Jeta e dobishme e një aktivi përcaktohet si periudha gjatë të cilës një aktivitet përdoret nga ndërmarrja. Faktoret në vijim do të merren në konsideratë për përcaktimin e jetës së dobishme të aktivitetit:
 - Masa në të cilën kapaciteti i aktivitetit përdoret;
 - Vjetërimi i përbërës fizik, i cili varet nga faktore operacionale të tilla si numri i cikleve që aktiviteti përdoret dhe programi i riparimit dhe mirëmbajtjes së ndërmarrjes së aseteve të blerjes dhe mirëmbajtjes së aktivitetit gjatë kohës kur nuk punon;
 - Vjetërimi teknik që vjen nga ndryshimet ose përmirësimet në prodhim, ose nga një ndryshim në treg për produktin apo shërbimin që siguron aktiviteti;

- Faktore ligjore ose të tjera që pengojnë përdorimin e aktivitetit, të tilla si data e skadencës që lidhet me qirarë, licencë, etj.
- d) Jeta e dobishme e një aktivi përcaktohet si periudha gjatë të cilës një aktivitet përdoret nga kompania. Vlerësimi i jetës së dobishme të një pronë, impiantit dhe pajisjeve bazohet në eksperiencën e ndërmarrjes për aktive të ngjashme.
- e) Jeta e dobishme e një elementi të pronës, impiantit dhe pajisjeve do të rishikohet periodikisht (të paktën një herë çdo tre vjet) dhe, nëse parashikimi për jetën e dobishme të aktivitetit është shumë i të ndryshëm nga vlerësimet e mëparshme, vlerësimi dhe ngarkesa e amortizimit për periudhën korrente dhe të ardhshme duhet të rishikohet.
- f) Vec kërkesave të përcaktuara në seksionin e mëparshëm, zbulimet do të behen në çdo moment të jetës së aktivitetit nëse behet e qartë që vlerësimi i jetës së dobishme të aktivitetit është i pavend. Për shembull, jeta e dobishme mund të zgjatet nga shpenzimet në vijim mbi aktivitetin, ose në vazhdim të politikës së kompanisë për mirëmbajtje e riparim, të cilat përmirësojnë gjendjen e aktivitetit përtej standartit të tij të performancës të vlerësuar fillimisht. Dhe në të kundërt, ndryshimet teknologjike ose ndryshimet në treg për produktet mund të ulin jetën e dobishme të aktivitetit. Në të tilla raste, jeta e dobishme, dhe si rrjedhim edhe norma e amortizimit do të rishikohet për periudhën korrente dhe të ardhshme.
- g) Politika e ndërmarrjes për riparimin dhe mirëmbajtjen mundet gjithashtu që të ndikojë në jetën e dobishme të aktivitetit. Ajo mund të çojë në zgjatje të jetës së dobishme të aktivitetit ose në vjetërimin me të shpejtë të tij. Në të tilla politika mund të inkurajohen nga ERE nëpërmjet metodës "revenue cap regulation" apo "price cap regulation". Adopsioni i politikave të tilla nuk e përjashton nevojën për të ngarkuar amortizimin e përkatshëm.

Metodat e amortizimit, për t'u përdorur nga të licencuarit sipas sistemit të njejtë të llogaritjes, do të jenë në përputhje me sistemin Ndërkombëtar të Llogaritjes. Të licencuarit do t'i vertetojnë ERE-s që amortizimi i llogaritjes është në përputhje me parimet e IAS-it. ERE mund të kërkojë justifikime të detajuara lidhur me vlerësimin e jetës së dobishme të aktiveve, duke përfshirë analiza statistikore që mbështesin vlerësimin, "benchmarking", apo analiza të metodave përjashtuese.

Në vlerësimin e jetës së dobishme kompanitë e licencuara mund të përdorin (a) porositë e përgjithshme të siguruar (marra) nga prodhuesit, shitësit, ndërmjetësit dhe organizatat profesionale dhe industriale, (b) informacion nga aktive të krahasueshme të kompanive të tjera të shpenzuesve, ose (c) informacion të brendshëm. Në përcaktimin e jetës së dobishme, të licencuarit gjithashtu duhet të marrin në shqyrtim gjendjen aktuale të aktivitetit dhe për sa kohë mendohet që do të plotësojë kërkesat e shërbimit. Është e rëndësishme, që ky informacion i përgjithshëm të përshkruhet për kushtet specifike të të licencuarve. Faktoret e mëposhtëm duhet të merren parasysh:

- Specifikimet e cilësive dhe teknike: Aktive të ngjashme mund të ndryshojnë në mënyrë thelbësore në cilësi e si rrjedhim në jetën e tyre të dobishme, për shkak të diferencave në materiale, dizajn dhe mjeshtri. Për shembull, një lloj SF6 110 kV thikë ndarëse nuk do të ketë të njëjtën jetë të dobishme si një thikë ndarëse e rregullit pneumatike (air-filled) 110 kV. Në të njëjtën mënyrë si materialet e perdorura për qelime shtririmi, baza dhe shtrëza e poshteme, do të ndikojnë në jetën e dobishme të një autostrade.
- Aplikimi (jeta e përbërës dhe përdorimit): Jeta e dobishme e një lloji të dhënë aktivi mund të ndryshojë në mënyrë sinjifikative në varesi të përdorimit të paramenduar. Për shembull, jeta e një pajisje motorike që përdoret në shërbimin e klientit mund të ndryshojë nga jeta e të njëjtës lloj pajisjeje të perdorur për qëllime të përgjithshme dhe administrative.
- Mjedisi: Ndryshimet mjedisore midis territoreve të shërbimit të të licencuarve mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në jetën e dobishme të aktiveve të tyre. Për shembull, jeta e

dobishme e aktiveve ne zone malore eshte ndryshe nga ajo e aktiveve te ngjashme te vendosura ne nje zone me klime te bute.

Ndikimi i mundshem i secilit prej ketre faktorëve mund te zbutet ose te keqesohet si rezultat i politikës se kompanive te licensuara per mirembajtjen, riparimin dhe zevendesimin. Per shembull, mundesia per demtim te transformatorit zritet nese vaji i transformatorit nuk zevendesohet rregullisht.

Vleresimi i jetes se dobishme te nje aktivi nuk eshte nje ushtrim qe behet nje here. Te licensuazit duhet te monitorojne experiencat e tyre aktuale me jetegjatesine e AAM –ve dhe te bejne ndryshimet e duhura per te matur jeten e dobishme duke u bazuar mbi ate eksperience.

Ne kushtet praktike te Licensuazit duhet te dorezojne ne ERE raporte te vecanta te titulluar "Studim i Amortizimit" te cilet permbajne vleresimet mbi parametrat e projektuar te jetes se dobishme dhe normat e amortizimit te aktiveve se bashka me raportet vjetore. ERE do te shqyrtojte dhe aprovojte vleresimet (logaritjet) duke perdorur si reference jeten e dobishme te mundshme dhe ate te mbetur te perdorur nga pjesmarresit e tjere ne industri. Parametrat e aprovuar do te perdoren nga te Licensuazit gjate jetes se dobishme te secilit aktivi.

Jeta e dobishme e mundshme dhe e mbetur per cdo asset e paraqitur nga aplikantet do te konsiderohet e pasakte nga ERE nese:

1. Vleresimet nuk i korrespondojne standardeve te industrise;
2. Vleresimet ndryshojne ne menyre thelbesore nga ndihesimet nderkombetare, ose
3. Vleresimet jane ne kundërshtim me vendimet e meparshme te ERE-s per raste te ngjashme.

ERE mund te konsidrojte si te pershtatshme propozimin e paraqitur nga aplikantet, edhe nese nje ose me shume nga rrethanat e siperpermendura jane prezente, per sa kohë qe parametrat e propozuar justifikohen dhe mbrohen plotesisht.

Ne kontekstin e procedure per miratimin e tarifave, ERE mund te rishikojte jeten e mundshme dhe te mbetur te dera aktiveve, dhe, nese eshte e zbatueshme, te rishikojte normat e amortizimit.

7. Kategorite dhe struktura e Aktiveve Afatgjata Jomateriale

Kategorite dhe struktura e aktiveve te qendrueshme te patruperuara jane hartuar ne perputhje me IFRS 38 – Aktivitet e Afatgjata Jomateriale - dhe jane detajuar me tej per qellime te llogaritve rregullatore.

Aktiveve Afatgjata Jomateriale - AAJM jane aktive te identifikueshme jomonetare qe nuk kane permbajtje fizike , te mbajtura per tu perdorur per prodhimin ose furnizimin e mallrave dhe sherbimeve .per tu dhene me qera te treteve apo per qellime administrative .

Shpenzimet per perfundimin e licenses do te kapitalizohen dhe amortizohen sipas metode lineare per perioden e licenses, dhe aktivet e tjera te patruperuara per pese vjet. Vlera kontabel(kosto historike

8

minus amortizimin e akumuluar) e cdo aktivi te patruperuara do te rishikohet cdo vit, dhe nese eshte e nevojshme do te regjistrohet si nje provizion per zhirleresimin e aktiveve. ne librat e llogaritve.

Aktivitet e reportuara ne llogaritve e siperpermendura duhet te pembeushin kriteret ne vijim:

1. Natyre jo monetare.
2. Te verifikueshme.
3. Aktivi eshte i identifikueshem dhe mund te dallohet nga emri i mire.
4. Mund te shiten, shkembehen, jepen me qera etj per qellim te marrjes se perfitimëve ekonomike nga zoterimi i tyre.
5. Perdoren per qellime prodhimi, sherbimi, administrimi etj.

Kostot qe kane lidhje me nje aktivi te jomaterial si pasoje e blerjes apo krijimit te tyre do te raportohen si shpenzime ne momentin e kryerjes se tyre, me pershtatim te rasteve ne vijim:

1. Kur ka te ngjare qe shpenzimet do te ndihmojne aktivitet qe te gjenerojne me shume perfitime te ardhshme ekonomike krahasuar me ato te planifikuara fillimisht.
2. Kur keto kosto mund te vleresohen ne menyre te besueshme dhe t'i ngarkohen aktivitet.

Mbas kontabilizimit fillestar, AAJM –te do te raportohen me koston fillestare minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga renia e vleres .

Shuma e amortizueshme e nje aktivi jo material do te shpërndahet mbi baze sistematike gjate gjithë jetes se dobishme te perkaktuara sipas caktuarjes me te mire .

Amortizimi do te filloje ne momentin e marrjes se aktivitet ne periodin, pra kur ai eshte i gatshem te perdoret

Duke pasur parasysh qe perfimet e ardhshme ekonomike te materializuara ne aktivet e patruperuara konsumohen me kalimin e kohes, vlera kontabel e aktivitet do te pakësohet ne menyre qe te reflektojte kete lloje konsumi. Kjo mund te azihet nepermjet nje shpenzuarje sistematike te koston fillestare(historike) te aktivitet ose shumës se zivleresuar nga e cila eshte zbritur vlera e mbetur, si nje shpenzim gjate jetes se dobishme te aktivitet.

Amortizimi do te njihet pavaresisht nese ka apo nuk ka rritje te vleres se tij te perkaktuara drejtesisht apo apo te vleres se rikuperueshme.

Gjate perkaktimit te jetes se dobishme te nje AAJQ ,nevoiten te merren ne konsiderate nje numer faktoresh si:

1. Fitimi i llogaritur per kompanine nga aktivi dhe nese ky aktivi mund te menaxhohet ne menyre efektive nga nje grup tjetër menaxhimi.
2. Ciklet e jetes se nje produkti tipik per aktivin dhe informacioni publikisht i disponueshem per vleresimet e jetes se dobishme te aktiveve te ngjashme te perdorura per qellime te ngjashme.
3. Vjetedimi teknik, teknologjik etj.
4. Stabiliteti i sferes brenda te cilit aktivi funksionon dhe ndryshimet ne kerkesen e tregut per produktin apo sherbimin e gjeneruar nga aktivi ne fjale.

9

5. Veprimet e mundshme te konkurrenteve ose te konkurrenteve potenciale.
6. Niveli i shpenzimeve per mirembajtjen e nevojshme me qellim qe te merzen perfitimet te ardhshme ekonomike nga aktiviteti dhe aftesia e qellimi i kompanise per te arizuar kete nivel;
7. Periudha e kontrollit mbi aktivitetin dhe kufizimet ligjore, dhe te tjera, te perdorimit te aktivitetit, (si data e mbarimit te afatit te kontrates se qirase).
8. Vazesia ose mos-vazesia e jetes se dobishme te aktivitetit nga aktive te tjera te ndermarrjes.

Jeta e dobishme e aktivitetit do paraqitet ne planin e amortizimit te ndermarrjes e cila hartohet per te gjitha aktivitetet e patrupazuara dhe e aprovuar nga menaxhimi.

Organizimi i llogarive sintetike te AAJM ka lidhje direkte me pambajtjen e odo objekti.

Per qellim te llogarive rregullatore, AAJM-te do te raportohen ne llogarit e zakonshme te Grupit 20 Aktivitet e Afatgjata Jomateriale mund te paraqiten ne kode tre-shifrore.

8 Kategorite dhe struktura e Kerkesave per Arzetim

Kerkesat per arzetim ndaj klienteve do te raportohen me vleren e fatures, nga e cila eshte zbritur nje provizion per rrenie vlere. Provizioni per rrenie vlere do te llogaritet nese ka nje fare sigurie qe kompania nuk do te jete ne gjendje te arketoje te gjitha sasine sipas kushteve fillestare ne lidhje me vleresimin respektiv.

Per qellime te llogarive rregullatore kerkesat per arzetim do te raportohen ne llogarit e Grupit 41 Kliente, te shenuara me nje kod tre-shifror.

8.1 Llogarit e pambledhshme "Borshi i keq"

Perkufizimi i llogarive te pambledhshme

Llogarit e pambledhshme do te trajtohen si shpenzime te shitjes me kredi. Arsyeja per kete eshte se dhenia e kredive konsiderohet nje ngjarje qe rrit shitjet dhe te ardhurat. Kompanite jane shpesh te gatshme te pesojne humbje nga debitoret e keqin qe do te rezultojne i pa-arketueshem nese efekti neto per biznesin eshte rritja e shitjeve dhe fitimeve. Nga ana tjetere te licencuarit ne pergjithesi "detyrohen" te shesin me kredi per shkak te karakterit teknik te operacionit, prandaj ato i konsiderojne "Llogarit e pambledhshme" si kosto te nevojshme.

Rregjistrimi i shpenzimeve per borshin e keq kerkon qe shpenzimet per borshin e keq te raportohen per periudhen kontabile ne te cilen eshte realizuar shitja me kredi.

Metoda e perdorur per te rregjistruar shpenzime nga "Borshi i keq" quhet "metoda e shumtes se lejuar" per kontabilizimin e borshit te keq. Pervec se kenaq kerkesat e padimit te akumulimit/rregjistrimit, kjo metode, e cila perfshin nje vleresim te borshit te keq, siguron gjithashtu qe kerkesat per arzetim te raportohen ne pasqyren e bilancit me vleren e tyre neto te realizueshme. Pra rregjistrimi dhe raportimi i borshit te keq mund te konsiderohet si nje llogari e kundert rregulluese e llogarive te arketueshme.

8.2 Rregjistrimi/kontabilizimi i "borshit te keq"

Provizionimi i llogarive te arketueshme sipas "metodes e shumtes se lejuar" perfshin nje llogari te kundert rregulluese te quajtur "Zbritje nga llogaria e arketueshme(Shitje)". Rregjistrimi kryhet me nje debitim te llogarise "Shpenzime Borshi i Keq" dhe me nje kreditim te llogarise "Zbritje nga llogari te arketueshme(Shitje)". Duhet shenuar qe llogaria e kundert rregulluese "Zbritje nga llogari te arketueshme(Shitje)" perdoret jo vetem sepse eshte gjithnje mire te evidentohet shumta neto e llogarive te arketueshme, por gjithashtu edhe se ne kohen e regjistrimit te rregullimit nuk specifikohe llogarit dhe sasite e papaguara te klienteve te vecante. Llogarit e klienteve te vecante nuk mund te hiqen nga llogarit e arketueshme ne librin e llogarive te arketueshme, dhe llogaria kontrollohese per llogarit e arketueshme ne librin e pergjithshem te llogarive(balanca e se ciles tregon shumen totale te llogarive te arketueshme ne librin e llogarive te arketueshme) nuk mund te kreditohet me totalin e borshit te keq. Ne vend te saj kreditohet llogaria "Zbritje nga llogari te arketueshme(Shitje)". Balanca kreditore e ketaj llogarie ka efektin e zvogelimit te llogarise "Llogari te Arketueshme(Shitje)" ne vleren e perilogarit neto te realizueshme te tyre.

Ne pasqyren e Bilancit llogarit e arketueshme paraqiten si	
Llogari te Arketueshme (Shitje)	xxxx,xx
Minus: Zbritje nga llogari te Arketueshme(Shitje)	xxx,xx
Llogari te Arketueshme(Shitje) me vleren neto te realizueshme	xxxx,xx
Menyrat e ndryshme per te marre nje vleresim(parashikim) te borshit te keq para shikohen ne seksionin D. poshte.	

8.3 Identifikimi dhe rregjistrimi e nje llogarie te vecante nga llogarit e arketueshme (Shitje).

Kur llogaria e arketueshme (shitje) e nje klienti te vecante identifikohet si e pa-arketueshme ajo kreditohet perkundrejt debitimit te llogarise "Zbritje nga llogari te arketueshme(shitje)". Kreditimi i llogarise "Llogari te arketueshme(shitje)" te klientit te vecante, menjanon sasine e borshit te keq (eregjistrohet llogarine) nga Libri i Llogarive te Arketueshme (Ditari i Shitjes), e si pasoje e cregjistrohet ate nga llogarit kontrollohese te Librit te Madh. Fazat e ketyre regjistrimeve jane: Se pari, megjithese cregjistrimi i llogarise se nje klienti te caktuar trajtohet si nje shpenzim, eshte "zbritje nga llogari te arketueshme (shitje)" qe debitohet. Kjo per arsye se shpenzimi i llogarit i borshit te keq ishte regjistruar fillimisht si nje shpenzim nga rregullimi i llogarive te arketueshme ne fund te periudhes ne te cilen ato ndodhen. Se dyti, megjithese cregjistrimi elementar sasine e llogarive te arketueshme nga Libri i Llogarive, si nuk ndryshon sasine e vleres neto te realizueshme nga llogarit e arketueshme (sepse "Zbritje nga llogari te arketueshme(shitje)" reduktohet per te njejten shume).

Ne rastet kur kompania e licencuar mbledh nje shume qe me perpara ishte cregjistruar, ajo duhet te beje dy hyrje kontabile. E para do te jete e kundert me cregjistrimin e shpejgaur me lart dhe qe rikthen ne pozitën e meparshme llogarine e klientit. E dyta do te regjistroje arketimin ne llogarine e rikthyer.

8.4 Vlerësimi (llogaritja) i Borzhit të Keq

Metoda e Pasqyrës së të Ardhurave (Pergjindja e shijëve)

Metoda presupozon që ka një marrëdhënie të rregullt midis shijëve të periudhëve të mëparshme dhe sasise të borzhit të keq. Kjo marrëdhënie konvertohet në një pergjindje dhe përdoret për të përcaktuar shpenzimet për borzhin e keq të vitit.

Metoda e pasqyrimit të Bilancit (Pergjindja mbi llogaritë të arketueshme)

Kjo metoda presupozon që ka një marrëdhënie të qëndrueshme midis vjetërsisë së llogaritë të arketueshme të jashtëzakonshme dhe borzhit të keq. Kjo marrëdhënie konvertohet në një seri pergjindjesh për grupe të ndryshme vjetërsie (30, 60, 90 dhe 180-dite), dhe përdoret për të përcaktuar shpenzimin për borzhin e keq të periudhës së shumeve të pa-arketuara, që llogariten duke përdorur këto pergjindje. Pergjindja për secilin grup do të bazohet mbi informacionin statistikor. Në pergjithësi pergjindja e shumave të kërkesave të pa-arketuara rritet me vjetërsinë e kërkesave për arketim.

Kjo metoda përdoret gjërnjësit dhe konsiderohet si më e sakta. Duhet të vëhet në dukje, megjithatë, se ajo cenon parimin e të ardhurave të konstatuara, prandaj nuk rekomandohet për raportime/pasqyra mujore dhe tregujore.

Kompania e licencuar duhet të tregojë në mënyrë të qartë se çfarë metode ka përdorur për regjistrimin e borzhit të keq në llogari. ERE mund t'i kërkojë kompanisë që të përdorë metode tjeter të ndryshme për llogaritjen e borzhit të keq.

9 Kapitulli i Punes

Në pergjithësi kapitali i punës përfaqëson investimet kapitale të dhëna nga pronari gjatë intervalit midis kryerjes së shpenzimit për sigurimin e shërbimit dhe vjeljes së të ardhurave nga klientet.

RAB- do të përfshijë kapitalin e punës në formën e një Shume të lejuar për "Kapitalin e Punes" (WCA), që përfshin elemente të tilla si para në dorë, minimumin e balancës në banka, materiale, parapagesa, dhe pagesave të taksave. Rezerva për kapitalin e punës do të jetë e njëfishtëme që të lidhi hendekun midis kohës kur paguhen kostot që sigurojnë shërbimin dhe kohës kur kompania është paguar për atë shërbim.

I Licencuari duhet të paraqesë një studim i justifikon kërkesat e tij për kapital të punës. Rezervat për kapitalin e punës do të përcaktohen mbi sasine mesatare të kapitalit të financuar nga investitorë (kapitali i vet, borzhit ose fitimet e pasqyruara në biznese) të nevojshme për financimin e kërkesave të kompanisë për kapital të punës. Kompania e licencuar do t'i propozojë ERE-s metodën e preferuar për llogaritjen e Shumes së Lejuar të Kapitalit të Punes (WCA). ERE mund të kërkojë përdorimin e një metode të ndryshme, nëse gjykon që metoda e përdorur nga kompania nuk paraqet në mënyrë të drejtë kërkesën e saj për kapitalin e punës.

Metoda më e sakte dhe më e komplekse për përcaktimin e kapitalit të punës të kërkuar është e ashtuquajtura performanca e studimit të drejtimit të vonesave "lead/lag study". Kjo është një detyrë gjithëpërfshirëse e kryer për të krahasuar diferencën në kohën e kryerjes së kohës e vonesës midis hyrjeve dhe daljeve të parave. Studimi kërkon analizë të detajuar të shpenzimeve të kompanisë për të përcaktuar kohën në të cilën kompania faktikisht duhet të paguajë për shpenzimet e saj dhe e krahason këtë me kohën në të cilën ajo merr pagesën për këto shpenzime. Diferenca kohore sipas metodës "lead and lag" shprehëzohet pastaj me shpenzimet operative

mesatare ditore për të mbledhur në nivelin e kërkuar të kapitalit të punës që do të përfshihet në RAB.

Një alternativë e kësaj metode është matja e nivelit të dështur të kapitalit të punës duke përdorur informacionin e pasqyrës së të ardhurave dhe bilancit financiar, mbi nivelin mesatar të inventarit, nivelin mesatar ditore të shpenzimeve të kryera nga i Licencuari (duke përfshirë operimin, mirëmbajtjen, administrimin, taksat, etj.) dhe intervalin midis daljeve dhe hyrjes së parave.

Shuma e lejuar për kapitalin e punës (WCA) është shuma e dy komponenteve: Shuma për kapitalin e punës në "para" dhe shuma për kapitalin e punës në "Materiale dhe Furnizime". Shuma e lejuar për kapitalin e punës në "para" do të përfshijë para në dorë dhe shumën minimale në "Llogarine e Bankës".

Shuma e lejuar për kapitalin e punës në para (WCA) është një llogaritje e parave të siguruar nga investitori për të financuar "Rezervën" e paracaktuar për Kostot e Operimit të kompanisë (AUOC) në përzindjen në të cilën arketohen të ardhurat operative. Mënyra më e mirë për të përcaktuar Rezervën për kapitalin e punës në para është nepërmjet studimit "lead-lag". Ky studim zakonisht nëgëzohet vonesën në këhimin e shpenzimeve jo-monetare (amortizimi, etj.) taksat e shlyra në kohë etj.

Një studim lead-lag duhet të kryhet në përputhje me kriteret në vijim:

- i "Studimi lead-lag" do të përdorë metodën cash. Të gjithë elementet jo-monetare, përfshirë por jo kufizuar vetëm në amortizimin, taksat e shlyra, artikujt e parapaguar, dhe fitimin (përfshi interesat mbi borzhin afat-gjatë dhe dividendet), nuk do merren në konsideratë.
- ii Cdo metode e paanësime mund të përdoret për kryerjen e studimit lead-lag.
- iii Data e urdherit të pagesës ose data e caktuar e fatures do të përdoren për qëllime të studimit "lead-lag". Në ato raste kur ofrohen data të ndryshme të pagesës nga shitesit/furnitorët, data për pagesën e fatures është data korresponduese me termat e parumara nga kompania e licencuar.
- iv Të gjithë fondet e marra nga kompania përveç transferave elektronike do të konsiderohen në dispozicion për tu përdorur jo më vonë se dita e punës që pason marrjen e fondeve në cdo mënyrë nga i licencuari (zyrë postare, zyra të degës, etj.). Të gjitha fondet e marra me rrugë elektronike do konsiderohen në dispozicion ditën e marrjes.
- v Për kompaninë e licencuar tepisica e llogaritë "cash" "working fund" të përfshira në llogaritjen e shumës së lejuar të parave, do të përbëhet nga bilanci mesatar ditore i bankës për të gjitha depozitat pa interes dhe fondet e parave (working cash funds).
- vi Periudha për shpenzimet e tatimit mbi fitimin do të llogaritet nga matja e intervalit midis merit të periudhës së taksës dhe datës aktuale të pagimit të saj nga kompania e licencuar.
- vii Nëse llogaritja e kapitalit të punës në para rezulton në një shumë negative, shuma negative do të përfshihet në RAB.

Shuma e lejuar në Kapitalin e Punes për "mjete monetare - arke" dhe bilanci Minimal i Bankës do të shprehë shumën e përcaktuar nga studimi lead-lag.

Shuma e lejuar të Kapitalit të Punes për Materiale dhe furnizime do të përfshijë inventare të arsyshme për materiale, pajisje, dhe lëndë djegëse të mbajtura vecanërisht për garantimin e operimit eficient të të licencuarit, për sigurimin e shërbimit normal nga ana e tij. Të Licencuarit duhet të mbajne parasysh se cdo sasi e inventareve që konstatohet nga ERE si e paarsyeshme, e tepert, ose në kundërlidhje me interesat e publikut do të përjashtohet nga shuma e lejuar për kapitalin e punës për Materiale dhe furnizime.

Gjate justifikimit të sasise së inventareve, i Licencuari, duhet të marrë parasysh të gjitha kostot e inventarit (kosto e magazinimit dhe trajtimit, sigurancioni, taksat mbi pronën, amortizimi, dhe vjetërimi); koston e porositë (koston e berjes së porositë, koston e transportit dhe trajtimit); koston

e trajtimit të ndërspejreve të prodhimit/furnizimit (ndërspejre të grafikeve të prodhimit dhe ankesat e klienteve).

D. Kategoritë dhe strukturën e Detyrimeve

Një detyrim do të kategorizohet si korrent (Afatshkurter) kur:

1. Ai pritë të shlyhet brenda vitit financiar ose brenda ciklit ekonomik të biznesit.
2. Ai duhet të shlyhet brenda 12 muajve nga dita e ndërtimit të Bilancit.

Gjithë detyrimet e tjera do të klasifikohen si jo korrente .

Detyrimet korrente do të klasifikohen në mënyrë të ngjashme me aktivet qarkulluese. Detyrimet korrente të tilla si Llogaritë të pagueshme tregtare ("Furnitore") dhe "defesa të pagueshme" ("efekte për tu paguar" ose "letra tregtare") për "personelin" dhe detyrimet për shpenzime të tjera operative përfaqësojnë pjesë të kapitalit të punës të perdorur në ciklin normal të operimit. Artikuj të tilla të operimit do të klasifikohen si detyrimet korrente edhe nëse ato duhet të sistemohen brenda një periudhe me të gjatë se 12 muaj nga dita e bilancit financiar.

Detyrimet korrente janë gjithashtu edhe detyrimet që nuk janë shlyer brenda ciklit normal të operimit por që duhet të shlyhen brenda 12 muajve nga dita e bilancit financiar .

Ndërmarrja do të kategorizojë detyrimet e veta me interesa afatgjatë si jo- korrente, edhe nëse ato duhet të shlyhen brenda 12 muajve nga dita e bilancit financiar, nëse:

1. Afati fillestar i shlyerjes ishte me shumë se 12 muaj.
2. Ndërmarrja ka ndërmend të paguajë detyrimin në fjalë mbi bazën afat-gjatë.
3. Qëllimi është që të arrihet një marrëveshje pagese ose një marrëveshje për ndryshim në mënyrën e pagesës të perfunduar para datës së aprovimit për publikim të raportit financiar

Fillimisht, marrja lma do të njihet deri në shumën e të ardhurave , pa përfshirë shpenzimet për marrjen e huazës. Në vijim, huamarrjet do të raportohen me vlerën historike të amortizuar duke perdorur metodën efektive të perfundimit. Diferencat midis të ardhurave (pa shpenzimet për borxhin) dhe shumës së paguar plotësisht, nëqz egzistojnë, do të tregohen në Pasqyrën e të Ardhurave sipas planit të pagesës

Për qëllime rregullatore detyrimet do të raportohen në llogaritë e Grupit 40, të shprehura me kode tue-shifrore.

10. Kategoritë dhe strukturën e Shpenzimeve Operative

Struktura e listës së llogarive është detajuar për qëllime rregullatore dhe lejoi kur është e nevojshme që të mirren informacione plotësuese, përtej klasifikimit për raportim të përfshirë në Pasqyrën e të Ardhurave-shpenzimeve" të kompanisë për qëllime të mekanizmit rregullues.

Kompanitë duhet të përgatisin pasqyrat e tyre financiare, përveç pasqyrave që kanë të bëjnë me rrjedhjet e adkes (cash flow), në bazë të parimit të drejtave të konstatuara

Sipas parimit të drejtave të konstatuara, transaksionet dhe ngjarjet njihen në momentin që ato

ndodhin (dhe jo kur parate ose ekvivalentet me të arketohen ose paguhen), regjistruhen në regjistrat kontabile dhe raportohen në PF të periudhave të lidhura me to.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave mbi bazën të lidhjes direkte midis shpenzimeve të bëra për sigurimin e të ardhurave dhe të ardhurave. Aplikimi I parimit të kuptueshmërisë, gjithësesi, nuk lejon të njihen në fletën e bilancit ato artikuj që nuk kanë lidhje direkte me aktivet ose detyrimet; Shpenzimet nuk njihen si aktive në ato raste kur ato nga të nuk pritë të kete të ardhura në periudhat pasardhëse. Të ardhurat nuk mund të njihen si detyrimet nëqz nuk do të kete shpenzime për të siguruar keto të ardhura në periudhat pasardhëse.

Shpenzimet sipas natyrës ekonomike duhet të raportohen në llogaritë në Grupin 60 të shpenzimeve sipas natyrës ekonomike, dhe shpenzimet Operative duhet të raportohen në llogaritë në Grupin 61 të shpenzimeve Operative.

11. Elementet e pa-Audituar

Kurdo që ERE kërkon një pasqyrë financiare dhe, nëse duhet që një transaksion ka ndodhur dhe prek llogaritë por që shumën e përfshirë në transaksion dhe efektin i saj në kontabilitet nuk mund të përcaktohen me saktësi absolute, shumën do të vlerësohet dhe kjo shumë e vlerësuar do të përfshihet në llogaritë përkatëse. Kompanitë nuk do të kërkojnë të vlerësojë artikuj të përndësishëm, që nuk do të ndikojnë ndjeshëm llogaritë.


12. Alokimi i kostove

Metodologjia për klasifikimin e kostove është në përputhje me USOA/Sistemin Uniform të Llogarive). Një kërkesë e rëndësishme është diferencimi i qarte dhe ndarja financiare e aktivitetëve të rregulluara nga ato të pa-rregulluara të cdo kompanie energjinike. USOA përfshin klasifikimin e kostove si vijon:

- Sipas funksioneve
- Sipas natyrës
- Sipas grupeve të konsumatorëve
- Sipas nivelit të tensionit

Metodologjia për klasifikimin e kostove sipas funksioneve në përputhje me llogaritë e shpenzimeve sipas funksioneve të përkrahura në USOA, duhet të bazohet në analiza instrumentike, ekonomike dhe statistike. Kompania e licencuar duhet të atribuojë kostot tek klasa/nivelet të caktuara të shërbimit, në mënyrë që të sigurojë që totali i shpenzimeve ose pjesë e një shpenzimi i caktuar klasës përkatëse. Në mungesë të kësaj-shënuesve të detajuar (që ndjekin kostot e punës) i licencuar duhet të propozojë mënyrë të veçantë alokimi për kostot e punës dhe duhet të jetë i gatshëm të justifikojë tek ERE.

Përmbledhje e shkurtër dhe identifikimi i parimeve kryesore dhe ndërveprimi mes tyre



Procesi i faturimit dhe arkëtimin

Krijimi dhe mirëmbajtja e klientëve

Lidhjet e reja

- Ky proces përfshin bashkëpunimin midis disa departamenteve që ndodhen nën divizionet e shitjeve dhe shpërndarjes. Kërkesat për lidhje të reja mund të vijnë nga klientë potencial ose të vjetër. Këto kërkesa adresohen tek specialistët e kujdesit për klientin. Ata verifikojnë dokumentacionin përkatës dhe njëkohësisht verifikojnë nëse klienti është debitor ndaj kompanisë. Nëse rezulton që klienti është debitor ndaj kompanisë atëherë procesi nuk mund të vazhdojë përderisa klienti të paguajë borxhet e tij. Specialisti i kujdesit për klientin dërgon të gjithë dokumentacionin e kërkuar tek specialisti i lidhjeve të reja në departamentin e kujdesit të rrjetit. Teknikët verifikojnë vendodhjen e objektit, pikat e lidhjes, vendin e instalimit të matësit, dhe vlerësojnë mundësitë për lidhjen e objektit në rrjetin elektrik. Njëkohësisht teknikët verifikojnë tipin e ndërtesës (nëse është ndërtesë banimi, dyqan, fabrike, etj) dhe përgatisin planin e objektit që firmoset prej tyre. Specialisti i lidhjeve të reja vlerëson dhe vendos planin tarifor përkatës duke u bazuar në vendimin e ERE. Njëkohësisht një llogaritje e detajuar e tarifës së lidhjes i jepet klientit në mënyrë që ai të kryejë pagesën. Klienti e kryen pagesën në pikat e arkëtimin ose në bankë dhe paraqet një kopje të pagesës e cila dokumentohet në dosjen e klientit. Nëse kushtet teknike plotësohen, specialisti i lidhjeve të reja përgatit një urdhër pune që i dërgohet shefit të departamentit të matjeve. Specialistët e matjeve kryejnë lidhjen teknike. Specialisti i lidhjeve të reja përgatit kartën e klientit më të gjitha të dhënat teknike dhe jo teknike. Karta me të dhënat e klientit i dërgohet njësisë së procesimit të të dhënave në departamentin e faturimit, të cilët i hedhin të dhënat në sistemin e faturimit.

Procesimi i të dhënave të klientit

- Bazuar në kartën e klientit, të dhënat e klientit janë regjistruar në sistemin e faturimit nga operatorët e njësisë së procesimit të të dhënave. Ata regjistrojnë në sistemin e faturimit, kodin e njësisë, numrin e ri të kontratës, kabinën ku klienti është i lidhur, emri dhe mbiemri i klientit, adresa, numri i regjistrimit në zyrën e tatimeve, fuqia e kërkuar, fuqia e instaluar, plani tarifor, leximi fillestar i matësit. Informacione të tjera të futura në sistemin e faturimit janë numri serial i kontatorit, numri i vulës, numri i kutisë, koeficienti i energjisë elektrike, etj. Operatori freskon kartën e klientit me numrin të kontratës së gjeneruar nga sistemi i faturimit dhe e dërgon tek specialistët e kujdesit për klientin të cilët përgatisin kontratën. Kontrata nënshkruhet nga specialisti i kujdesit për klientin dhe klienti. Me nënshkrimin e kontratës klienti i jepet një librezë ku regjistrohet konsumi mujori i energjisë elektrike.

Përmiresimet kryesore të kryera që nga 1 qershor, 2009

- Riorganizimi dhe centralizimi i procesimit të të dhënave të klientit në sistemin e faturimit.

Procesi i faturimit dhe arkëtimin

Raporti midis leximit dhe faturimit (shpeshtësia, mënyrat e kryerjes, etj)

Procesi aktual i leximit dhe dhe kalimit të të dhënave të konsumit të energjisë elektrike tek sistemi i faturimit kryhet nëpërmjet tre metodave:

- Hedhje e matjes në letër – përpara fillimit të aktiviteve të leximit, secili nga lexuesit merr një listë të printuar të klientëve (e printuar nga sistemi i arkëtimin) bazuar në nivel kabine, dhe lexon matësit e klientëve në një ditë të paracaktuar. Ciklet e leximit janë të vazhdueshëm për cdo zonë dhe variojnë nga zona në zonë. Listat e plotësuara dërgohen në departamentin e arkëtimeve dhe të dhënat e leximeve regjistrohen manualisht nga operatorët në sistemin e faturimit.
